

LEOM KOLMNELA  
**PORTA E FATKEQËSISË**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



LEOM KOLMNELA

# Porta e fatkeqësisë

*- Histori e vërtetë -*

Roman

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2015

Botuese: Irena Toçi

Redaktor: Kujtim Dashi  
Korrektore letrare: Majlinda Bami  
Përkujdesja grafike: Arlinda Rrushi  
Kopertina: Albana Kuraj

ISBN 978-9928-4291-5-5

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

Botimet TOENA  
Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë  
Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893  
Fax: +355 4 22 40 117  
E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)  
[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)  
[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Për njerëzit e mirë,  
Për njerëzit e këqij,  
Për njerëzit kafshë.*



## INTERVISTA

Zëri i saj ishte i ndjeshëm. Fytyra e purpurt. Sytë e çelur që fshihnin një hije trishtimi, ata sy mund t'i fshiheshin gjithkujt, por jo vështrimit zhbirues të një gazetari hulumtues që di t'i lexojë dhe t'i përshkruajë sytë dhe shpirtrat njerëzorë.

Dy policët e çliruan nga prangat ndërsa e shoqëruan për te zyra e doktorit. Mes meje dhe saj ish një takim i paligjshëm që mund të ndëshkohej kushedi se në ç'mënyrë. Komploti ishte thurur enkas që unë të kisha mundësinë të shkëmbeja me të një intervistë pyetje-përgjigjesh. Këmisha e bardhë, që ma kishte veshur shoku im dr. Majk M., bënte gjithkë të besonte se isha një mjek dhe jo një shkrimtar.

Ajo u çlirua pranë meje. Mori dorën time dhe e shtrëngoi me forcë. Dalloja gjithnjë tek ai shtrëngim i sinqertë besimin e saj që ma dhuronte bashkë me të vërtetën. Ajo e dinte që gjithçka do e tregojë siç mund ta tregonte ajo vetë. E ndjeu porsa pa sytë e mi hulumtues. Arrita t'i buzëqesh. Iu luta të ulej pranë meje ndërsa shoku im dr. M. mbylli portën duke lënë jashtë dy policët.

- Operacioni do të zgjasë dyzet e pesë minuta, - tha dr. M. dhe kaloi në dhomëzën e aneksuar duke na lënë vetëm.

Përgjigjet e saj të para ishin disi të tkurrura e hezituese. Pastaj më vonë, kur ma hodhi tërë besimin filloi të zhdrivillohej. E kuptova që gjithnjë e më tepër ndihej më e qetë dhe e sigurt.

Kur mbarova intervistën iu dha të më hidhej në qafë.

- Jam munduar shumë ta shkruaj vetë këtë histori timen, por kurrë s'arrita, - pëshpëriti ndërsa lotët e saj të ngrohtë pikonin në qafën

time. - Kërkoj falje, - u shkëput dhe u mundua të më fshinte duke zgjatur dorën e djathtë. - Më falni, - më tha, - s'mund ta përmbajë veten.

- Ju kuptoj përsosmërisht, - ia ktheva dhe ia zura dorën me dy duart e mia.

- Do bëni të pamundurën? - më pyeti me të njëjtën kureshtje të ndezur.

- Sigurisht. Ju premtoj që do të jetoni brenda qenies sime për sa kohë të zgjasë përshkrimi i historisë suaj. Kini besim tek unë.

- Shpresoj. Dua të them... do kem besim te ju si te vetja. Kam lexuar disa nga shkrimet tuaja. Më kanë pëlqyer. Më shumë se njëherë më është dukur sikur kam jetuar vetë brenda tyre. Dua të them kjo histori a mund të shkruhet në formën e një romani? Më falni! - arriti të shfajësohej.

- Diçka e tillë, - i shpjegova, - por ju mos e humbni besimin.

S'arritëm të shkëmbejmë më asnjë fjalë sepse porta trokiti. Miku im dr. M. u dha në derë dhe u hapi portën dy policëve që po prisnin me prangat e gatshme.

Ajo ua shtriu duart, ndërsa gjithnjë shikimin e mbante drejt meje sikur donte të më transmetonte më shumë, më shumë, gjithçka, gjithçka kish përjetuar gjatë jetës së saj.

Besoj që s'është më e nevojshme të zgjatem se si u organizua ai takim, në ç'rrethana dhe me ndihmën e kujt sepse edhe ne shkrimtarët (megjithëse na njohin për të shenjtë) kemi diku të strehuara të fshehtat tona. E rëndësishme është që kjo histori është e vërtetë dhe ka ekzistuar, ashtu siç është e vërtetë që te njeriu ekziston e keqja dhe e mira, gëzimi dhe dhimbja.



## MONOLOG

Gjurmët e jetës janë shtretër të kulluar të cilët lundrojnë mes forcash të djallëzuara. Unë kisha një të tillë që e quajtën jetë. Unë isha ajo që do të tregoja dikur për një histori timen, kur muret e dhembshurisë oshtinin dhe kur oxhaqet e ndjesisë përkisnin një qiell që qante dhe dërsinte nga mërzitë. Unë isha natyra e një të miture dhe modeli i një skaji paqësor. E bindur dhe e rritur mes një intrige të shtyrë nga qenie njerëzore që njerëzinë e shohin me shumë si të përdorshme, si një vegël pune me të cilën ke të drejtë të vetëveprosh me të, si me një send të çmuar të cilin me forcën e dhuntisë mund ta përçmosh. Si një fasadë të cilën mund t'ia ndërrosh ngjyrën sipas dëshirës. Është dhimbje t'i hapësh rrugë tragjedisë dhe të bindesh më vonë se kush ke qenë e kush je, por dhe kush mund të kishe qenë dhe kush mund të jesh. Pastaj, gjithsesi, e kupton se s'ka më rëndësi se kush do të jesh. Meqë, të paktën, s'mund ta besosh që je akoma njeri.

Për t'i shpëtuar ndoshta një legjende ose për të demonstruar pafajësinë e një hijeje vërtet të pafajshme, që më ndiqte, siç ishte figura e nënës sime, unë do të ndrydhesha brenda emocioneve të mia dhe vuajtja do më brente gjer në atë shkallë ku rrënimi i shpirtit tim, që hiqte e merrte me kujtimet më të tmerrshme do bëhej i brishtë gjer në atë pikë saqë s'do arrinte të përmbante më as fijen më të imët të gëzimit.

Ngjyrat do ishin të njëjtat, nata, dita dhe ëndrrat do të visheshin me ngjyrën e errët të kujtimit, ndërsa imagjinatat do ishin të ndrydhura në një zgafellë, ku sa herë që të mundohesha ta hapja do gjeja brenda saj hidhërimin e atyre momenteve më të hidhura të jetës sime.

Hija e saj do më ndiqte, pafajësia e saj s'do arrinte të më shëronte. Dashuria ndaj çdo ekzistence, s'arrinte të krijonte asnjë ndryshim mes meje dhe qenies sime.

Bisedat e tëra të shoqërive dhe historitë ekzemplare të emocioneve, sipas sugjerimeve, lindin dukë parë me sy të vërtetë dashurinë dhe ngjyrat e saj, që tek unë për një kohë të gjatë s'arritën kurrë të shiheshin. Gjithçka vinte si një rrëqethje e tkurrur që pastaj e merrte me vete një frikë që kish të bënte drejtpërdrejt me personin e tij dhe fëmijërinë time.

# 1

**K**ur je më pranë vdekjes kupton se përse jeta është një lojë e ndërtuar prej gënjeshtrash.

Një zhurmë e tmerrshme rrethoi ambientin. Dukej sikur bota po përmbysesj ndërsa nga kodrinat përreth vinte një jehonë ekstermizuese, e cila donte të përpinte çdo ekzistencë. Ca zëra fëmijësh klithnin. Dritat e makinave të policisë ndizeshin e shuheshin. Nga hëna me sy të plotë rridhte një ndriçim i qartë. Cirku pranë shtëpisë sapo kish zënë të çlirohej nga zërat femënorë. Netët e verës në Kaliforni janë të ngrohta dhe plot gjallëri. Shtëpia dykatëshe ishte rrethuar me policë dhe njerëz të tjerë shkisnin me kureshtje për të ditur ç'ndodhte në shtëpinë tonë. Dikush brenda saj qante,ndërsa unë dola jashtë. Isha e mbuluar me gjak gjer në atë pikë saqë zëra njerëzorë, diku nga një distancë e humbur, zunë të shpreheshin sikur dyshonin se në shtëpinë tonë po xhirohej ndonjë film horrori. Gjaku më mbulonte një pjesë të mirë të kokës, nga flokët më kullonin currila të hollëzuar duke lënë mbi asfaltin e ngrohtë stërpikje të ngjeshura. Nga shpatulla e grisur,e cila qe shqepur besova gjer në kockë, rridhte gjaku me shtëllunga, pjesa e shpinës ishte ngjyrosur me të kuqe të ndotur ndërsa në pjesën e përparme fustani i jeshiltë kishte marrë gjithandej ngjyrë të kuqe të ndezur, isha e gjakosur gjithandej në krahë, në duar dhe në gjoks. Ecja nëpër një mjegull që sa vinte e dendësohej. Ndjeva një peshë të më gjymtonte dhe diçka e fortë tek më priti më parë në fytyrë dhe pastaj në të gjithë trupin. Humba nëpër një ëndërr që më nxirrte diku pranë shtratin e vdekjes. Ishte diçka që më tërhiqte dhe, vetëm për një çast, munda të deshifroj se ndoshta ishte vdekja ajo që po

më thërriste dhe më qe afruar aq pranë. Dëgjova zëra të ndryshëm që më kërcënonin me çirret e tyre. Klithmat e fundit të sime mëje dhe disa zëra të panjohur, që shqyenin hapësirën e pragmuzgut si të çmendur. U pushtova nga një frikë e paanë dhe, për një çast mendova se s'do shihja më askënd në këtë jetë. U binda se po jetoja momentet e fundit. S'kishte kohë për lamtumirë. Ishte një dhimbje që zuri të ma rrudhte trupin dhe qeshë mekur fare saqë nuk munda të nxirrja më as fijen e zërit.

E vetmja gjë që mbaj mend ishte zëri i njohur i dikujt që më shkulte nga një pjesë e trupit. Dhe më thoshte.

- Jo, mos ik. S'duhet ta bësh, s'mund ta bësh!

Zëri i saj largohej dhe zhurma e tmerrshme ia zinte vendin

“Jeta dhe vdekja janë dy limite që bashkohen një ditë në të njëjtën pikë.” S'arrita të deshifroj nëse ishte ai një paragjykim, një mendim apo një zë magjik që turfullonte nga një largësi e pafund dhe e pashpresë...

Ndjeva ftohtë.

Një det i madh dhe i zi m'u shfaq. Një greminë e tërë dhe një dorë që më shtynte drejt saj. Një zë që më ftonte në thellësi më thosh:

- Eja, Margaret, eja!

## 2

- Më falni, por e kam të domosdoshme t'ju zgjoj, - ky zë i trashë burri më erdhi si nga një lartësi e pafundme.

U mundova të hap sytë dhe arrita të shikoj vetëm një kaltërsi që më kishte rrethuar. Mendova se ishte ngjyra e detit që zbardhej në krahët e një dielli lodrues.

- Jam investigator Majk Kollins.

Arrita të dalloj fundin e krevatit të hekurt dhe mbulesat ngjyrë blu të hapët, tubat plastike të diametrave të ndryshëm që më rrethonin dhe shishen e serumit në krahun e majtë. Aparati i matjes së zembrës ende vazhdonte të punonte me një ritëm të njëtrajtshëm.

Fytyra e tij ish e gjerë, në të vendosej një gojë e madhe, dy sy të mëdhenj që më shihnin me kujdes dhe dy vetulla të trasha që rrudheshin për të perceptuar zgjimin tim.

- Si ndiheni?

Mora mundimin të përgjigjesha. Zëri më ngeli në grykë. Infermierja më dha një lëng ta pija Kishte një shije të kripur. Munda të kaloj vetëm dy gllënjka.

- Mos u tremb! - më tha infermierja. - Jeni plotësisht jashtë rrezikut.

- Tani mund të flisni? - Prapë m'u drejtua i panjohuri.

- Po, - i thashë me gjysmë zëri.

- Mund të më tregoni për gjithçka ka ngjarë? Për rrethanat. Kushтет dhe për çfarë ndodhi diçka e tillë kaq e urryer?

Ai më tregoi dokumentin e tij dhe përsëriti.

- Quhem Majk Kollins, investigator i departamentit të shtetit të Kalifornisë. Jam i ngarkuar të di rrethanat dhe të shtjelloj çështjen

tuaj dhe, ju lutem, do ishte një ndihmë e madhe po të shprehni tek unë konfidencën tuaj duke më bërë të ditur të vërtetën dhe vetëm të vërtetën. E vërteta mund t'ju ndihmojë edhe juve dhe mua për t'u paraqitur para gjyqit të shtetit me prova të sigurta, të cilat mund të ndihmojnë edhe në mbrojtjen tuaj.

E mora me mend, se në ç'rrethana ndodheshja. Ishte e qartë se përveçse të vërtetës, për asgjë më s'do të flisja. Disa herë isha përgatitur që ta denoncoja atë të vërtetë.

Nisa të flisja. Pasi vetëm belbëzova një fillim të lodhshëm e të zvergur m'u këput zëri dhe, bardhësia aq e njohur, më mbështolli në gjirin e saj.

Kur erdha në vete, investigatori Majk Kollins s'ishte më aty, veç infermieres që më kishte në mbikëqyrje dhe një polici që rrinte ulur në një karrige plastike në fundin e dhomës.

Të nesërmen e mora veten dhe thirra doktorin. I thashë të më ndihmonte që të bija në kontakt të menjëhershëm me investigatorin e çështjes sime zotin Majk Kollins. Dhe se unë isha në gjendje të flisja me të që nga ai moment.

Me investigatorin Majk Kollins zura të bisedoj njëloj sikur të flisja me shpirtin tim. Do shpalosja me të ato të vërteta të cilat kurrë më parë s'i kisha shprehur para askujt veçse para vetes.

Në prezencën e tij do ndieja një siguri të celnikosur ku shpirti, ndjenja dhe vuajtja bashkohen duke shtruar një tryezë me të vërteta të nxira dhe të helmëta. Ka raste kur këta të vërteta, i ngjiten një zemre nga persona të tjerë, figurat e të cilëve nga të dashura kthehen në të urryera, nga njerëzore kthehen në çnjerëzore dhe marrin pamjen e frikshme të kafshës, me të cilën ne njerëzit e vërtetë s'dimë të merremi vesh.

Me investigatorin Majk Kollins do ndiheshja e lirë. Sinqeriteti im do ish aq provues sa çdo të ishin dhe lotët e mi që herë pas here lagnin me dhimbje të vërtetat e jetës sime.

Atë çka i thashë atij do ua them edhe juve. S'do jetë e nevojshme që të qani me mua. Do jetë më e nevojshme që të dini të vërtetën time ashtu siç është. Të dini atë çka është e pabesueshme dhe atë që mund të jetë e paimagjineshme. Atë histori që unë, për sa të rroj,

s'do kem mundësinë ta mbaj larg shqisave të mia, larg ndjenjave të mia. Ajo ëndërr, e cila ka ndryshkur çdo ëndërr tjetër të jetës sime. Ajo gllënjë që ka mbytur me helm çdo shpresë të jetës sime dhe ka përdhunuar dëshirën ndaj çdo dashurie. Është takti i atyre lloj gjërave, që robërojnë një femër dhe e poshtërojnë njëkohësisht ndër diktatin e dhunshëm të asaj që gjithçka mund të quhet, por kurrë njerëzore. Ku kafshëria zbret në mendjet njerëzore me maninë e ndyrë të një sëmundjeje që shndërrohet në plagë dhe që dikur e vdes çdo shpresë lumturie. Kur ekzistenca barbare e mekanizmave të tilla të egra, çojnë në fund tragjik jetën e dikujt, që ka dëshirë të jetojë e të gëzojë si njeri.

### 3

Unë linda në një ditë prilli të një viti të ngrohtë. Në një vit të lumtur, siç do më tregonte dikur ime më, kur njerëzia harenin, pas mbarimit të një lufte ku shumë nga bijtë e atdheut kishin lënë jetën brigjesh të huaja. Fitimi i luftës kishte pasur një rëndësi të madhe për kombin dhe për politikën e vendit tim. Pikërisht atë ditë gëzonte i madh dhe i vogël, ndërsa ime më hiqte dhimbjet që unë i shkaktoja.

Ishte një dëshirë e ngut për të dalë në jetë. Për nënën time do ishte dita më e shënuar e jetës rinore dhe dita e mbushur me më shumë emocione dhe ankthe, krahas frikës së lindjes, që shumë gra e mendojnë dhe pak e shprehin; ajo kish dëshirën të më njihje saora. Isha fëmija i parë pas gjithë atyre ëndrrave që ajo kish thurur.

Ishin orët e vona të natës kur ajo e shoqëruar nga një shoqe e saj, Britni Martin, do nisej për në spital.

Lindja ime do të ngjante në pamjen e parë me një lindje normale, por në orët e para të pasmesnatës, kur unë duhej të jepja dritë, gjendja e saj do ndërlikohej papritur. Dhimbjet do shtoheshin ndërsa doktori i turnit Arturo Horvell, një djalosh i ri i zeshkët dhe i njohur për gjinekologji si një mjek që kish shkëlqyer që në kohën e studimeve universitare, kishte kuptuar që diçka nuk shkonte mirë dhe kish urdhëruar kryeinfermieren që të përgatisnin menjëherë aparatën e ekografisë meqë do shikonin se në ç'pozicion ndodhesha unë ndërkohë. Pasi kishin bërë ekografinë ishin mrekulluar të gjithë sepse unë nga kokëposhtë isha kthyer me kokën lart. Koha e lindjes së rregullt kish kaluar që prej dy ditësh, sipas diagnozës, kështu që doktori Arturo Horvell kish urdhëruar urgjentisht operimin e nënës sime.



Në orët e para të mëngjesit unë do të jepja dritë. Do ishte shpagimi lodrues i një zëri të ri që kërkon të pluskojë diku mes zemrave të tjera. Ishin rrahjet e një zemre që lajmëronin se në këtë botë sapo kishte ardhur një e gjallë më shumë. Një njeri më shumë në këtë jetë që ka dëshirë të marrë frymë, të zgjohet dhe të shohë mrekullitë dhe plehurat e botës njerëzore.

Nëna me forcat e fundit ende të pashterura kishte arritur të më merrte në krahë dhe më kish puthur lehtë në kokë dhe në këmbë, pastaj kish rënë pa ndjenja gjër një ditë më vonë, kur mjekët e kishin sjellë në vete me mjekime dhe me ndihma të shpejta. Ajo kishte shpëtuar për pak pasi një hemorragji e rëndë kish kërcënuar seriozisht jetën e saj.

Kur do të më shihte për së dyti do fluturonte nga gëzimi ndërsa unë do kisha pushuar së qari me vendosjen e trupit tim mbi gjoksin e saj. Më kish dhënë sisë dhe më kish mbuluar me të puthura. Meqë kish rënë dakord që më parë me të shoqin, më kish vënë emrin e së ëmës, Margaret, së cilës i kishin zbuluar një sëmundje kanceri kur nëna ime në barkun e saj sapo kish zënë të formohej. Në ditën e njëzetentjëtë pas lindjes së nënës sime, gjyshja ime kish vdekur Kështu që nëna së bashku me motrën e saj të vetme gjashtëmbëdhjetëvjeçare ish rritur nga një teze e saj. I ati, pra gjyshi im, i kish braktisur i përndjekur nga lufta civile duke u strehuar në Meksikë, ku zëra të zinj kishin hapur fjalë sikur qeveria e kish vrarë, për të fshehur një informacion sekret me të cilin ai mund të fshikullonte nderin e kombit. Flitej gjithashtu nga dikush, këto do m'i tregonte vite më vonë teza ime e vetme, që gjyshi im kishte tentuar disa herë të kthehej në vend, për të njohur nënën time, por s'ia kish arritur. Teza do më thoshte që, për të fundit herë e kish parë të atin në kufi me Meksikën në një hotel meksikan të quajtur Noches De Oro, kur ajo sapo kish mbushur të shtatëmbëdhjetat dhe, pastaj ajo ish larguar nga Kalifornia, për në Nju-Jork, ku kishte vazhduar studimet për arkeologji dhe atje kish krijuar familjen e saj, pasi ish dashuruar dhe martuar me një mjek të njohur të kryeqytetit.

Nëna më strukte në gj. Ish dëshira e saj të më mbante pranë dhe, kur infermieret sipas rregullit të spitalit, kishin ardhur të më

merrnin asaj i ishin mbushur sytë me lot dhe i ish lutur infermieres të më linte me të pak më gjatë. Infermierja, qe ajo ia mbante mend edhe emrin, Lina, një zezake e gjatë dhe e shëndoshë, që sipas nënës duhej të kish mbi treqind libra, ia kish plotësuar dëshirën duke i thënë se mundësitë e saj ishin për një gjysmë ore më shumë. Atëherë ajo, për të përfituar nga koha, kish mbuluar me çarçafin e bardhë mua dhe veten dhe, me sy më kundronte dhe s'besonte që unë isha krijesa e saj, dalë nga mishi dhe gjaku i saj. Më kish shtrënguar lehtë dhe kish zënë të fliste me vete marrëzi që as ajo vetë kurrë s'do t'i mbante mend.

Im at do të bëhej i pranishëm, vetëm pas tri ditësh, ai krahas fitores së luftës kishte pasur edhe një gëzim tjetër. Lajmi i lindjes sime gati sa s'e kish çmendur. Ai do të festonte me shoqëri natën e lindjes sime. Im at ish ushtarak dhe kish qenë me mision të rëndësishëm kohë më parë se sa unë të dilja në jetë. Ai kish marrë vesh lajmin dhe, i tronditur siç ishte dhe i dehur nga gëzimi, do nisej menjëherë për të më njohur.

Kur nëna do të zgjohej nga një gjumë pasditeje, do gjente mbi tavolinën e drunjtë të dhomës së spitalit një tufë me trëndafila të kuq, të verdhë dhe të bardhë. Figura e ndritur e tim ati, do të shfaqej pak çaste më vonë, me duart e mbushura me dhurata, për mua dhe për atë. Ai do e merrte lehte në krahë dhe do e puthte në buzë, për të mos e zgjuar. Ajo me prezencën e ëndrrës, pas disa minutash, do hapte sytë dhe, si nëpër mjegull, do gjente veç lulet dhe do kujtohej për puthjen që e kish gënjyer çaste më parë. Por im at do të ishte i pranishëm aq sa dhe fryma e tij. Ai do dilte nga paradhoma dhe do të shfaqej me hijen e tij prej një gjiganti.

Ai s'do qante, do e mbante veten siç i ka hije një luftëtari që s'kursehet të japë as jetën, për të mbrojtur interesat e familjes dhe të tokës të cilëve u përket. Nëna do ish ajo që s'do mund të mbante lotët e gëzimit dhe ngashërimin e mungesës së tij në ditën më të rëndësishme të familjes, që ata bashkë, kishin krijuar.

Ishin përqafuar ngrohtë dhe ishin ulur duke biseduar gjithçka dhe, gjithçka ish e dedikuar vetëm për mua. Pastaj, më vonë babai i kish shprehur me ngut arsyet, për të cilat ai s'kish mundur te ishte

prezent dhe, nëna i kish treguar hollësisht për dhimbjet e lindjes dhe për gëzimin e lumturinë që ende s'dinte si t'i përballonte.

Kur më kishin sjellë mua pranë tyre, im at më kish marrë në krahët e fuqishëm dhe më kish buzëqeshur. Dhe unë, sipas tij, ia kisha kthyer buzëqeshjen çka do të thoshte se njeriut të parë në jetë që i kam buzëqeshur ka qenë im at.

- Shih, shih, që tani ka zënë të qeshë, - qe gazmuar.

Nëna s'e kish mbajtur dot gazin nga marrëzitë qe rrezonte goja e babait rreth meje.

Pas një jave, kur nëna ish plotësisht jashtë rrezikut, babai do sillte një limuzinë dhe, kështu që në orët e para të mëngjesit, do të gjendeshim në apartamentin tonë.

Apartamenti ynë ish i vogël. Komshinjtë ishin njerëz të mirë dhe të gjindshëm. Në Kaliforni është vështirë sot të gjeshe më njerëz që të të gjinden. Atje gjithkush jeton për hesapin e vet dhe s'njihen shumë rregullat e të të gjendurit atij tjetrit. Siç duket, mendohet se paraja zgjidh gjithçka. Në Kaliforni këtë kohë, gjithkush mendon për vete, për jetën e vet personale dhe të kundërtën e shohin si provincializëm. Harmonia është si të thuash diçka e dalë jashtë mode.

Ditët kishin zënë të vinin dhe të shkonin duke më shtyrë përpara edhe mua në rrjedhën e një jete të vërtetë, ku njerëzit dinë të bëjnë diçka, ku dhe unë si çdo krijese tjetër njerëzore, flija, haja dhe merrja frymë, qeshja dhe qaja, shihja dhe dëgjoja. Ishin këto stalagmitet e para që shquheshin dhe prindërit e mi i mbanin për më të çmuarat.

Kështu u bëra pesëmuajshe.

Në fotografitë e mia të miturisë, që do t'i shihja vite më vonë, do kisha qenë një engjëllushe e rrelltë dhe e qeshur, me sy që shihnin thellë dhe të zinj si Merloti i Kalifornisë. Nëna do më vishte gjithmonë bukur me një shije prej artisteje. Duart e saj prej stilisteje dhe prej parukiereje, kurrë s'do gabonin, syri i saj i sprovuar do më shikonte gjithmonë me një hollësi të veçantë. Dëshira e saj me e madhe do ishte që unë të isha për syrin e gjithkujt një fëmijë perfekt.

Ndërsa im at nga ana e tij do të ishte pranë meje me rrallë. Ai, që kur unë do mbushja një muaj do të shkonte prapë me shërbim dhe

kur do të kthehej do më gjente tremuajsh. S'do më njihje më dhe do vërente se kisha ndryshuar tërësisht me fotografinë që ai dy muaj më parë kish marrë me vete. Do i duheshin ditë të ambienteve me mua që për të isha si të thuash një fëmijë i ri.

Ai do më merrte me vete në një park që shtrihej jo larg, pas pallatit tonë. Aty edhe sot e kësaj dite është bukur. Ka pemë dhe lule plot. Lëndinat me barin e gjelbër ngjyrosen gjithnjë me ngjyra fëmijësh, ndërsa zëra të gëzuar e të qeshur derdhen gjithandej duke i dhënë gjallëri natyrës së bukur kaliforniane. Tek ai park përgjatë çdo stine do të kundroje dhe ndieje aromën e këndshme dhe, çdo pasdite, thonë, edhe sot e kësaj dite do ta shikosh të mbushur dëng me fëmijë dhe prindër.

Im at, mbrëmjeve do më afrohej dhe do më puthte lehtazi në ballë. Nëna, duke më kënduar me zërin e saj të ëmbël këngën e engjëlshes, më vinte në gjumë në krevatin tim të rrethuar me lojëra të llojllojshme dhe me një dyshek puplash, të cilin im at e kish blerë në Nju-Jork, me të marrë vesh për lindjen time.

Kur unë do të kisha mbushur pesë muaj, pikërisht natën kur po festohej 5-mujori im, do të ndodhte një skandal të cilin unë do e përjetoja skenarisht por që Lizbeth, shërbëtorja e porsaardhur në familjen tonë, vite më vonë, do ta përforconte atë histori me një retorikë të çuditshme sepse ajo kurrë s'kishte arritur të dinte diçka të saktë rreth atij skandali familjar.

Një tronditje do më bënte që të bija nga krahët e sime mëje në dysheme, do nxihesha për një çast dhe, në duart e saj që më ngritën do zija të qaja me dënesë, si kurrë ndonjëherë më parë. Nëna do të qante me mua, ndërsa babai do të dilte jashtë dhëmbështrënguar. Unë, natyrisht, s'mbaj mend asgjë nga kjo skenë e tmerrshme, por këtë gjë nëna, gjatë një mbrëmjeje, ndërsa unë do t'ia kërkoja me ngulm mungesën e babait tim të vërtetë, do të ma stërhollonte me lot në sy. Ishte nata kur sapo kisha mbushur gjashtë vjet.

Sipas nënës im at do bëhej i pranishëm atë natë, në orët e vona, ndërsa nëna ime e turpëruar s'do i dilte përballë. Shenjat në fytyrë ia kishin marrë bukurinë dhe vetja i dukej si një leckë e shëmtuar.

Ajo gjithë natën s'do flinte. Të nesërmen babai do kërkonte të sqarohet me të. Ajo duke me parë mua që flija, si një engjëll pagan, do kish pranuar përkëdheljet e tij dhe do kish kafshuar dhimbjet që i shkaktonin ato përkëdhelje. Të dy, atë natë, do ishin puthur, ndërsa unë po flija dhe do kishin bërë dashuri.

Ditën tjetër gjithçka do të lindte normale. Qetësia do gllabëronte terrorin e natës së çmendur. Të dy do merreshin me mua përsëri, do më puthnin, do qeshnin me marrëzitë dhe me gua-gautë e mia mes buzësh që skuqeshin nga harmonia që ndriçonte mes meje dhe jetës. Unë isha lidhëza e tyre, këndvështrimi i largësisë dhe i afërsisë. Unë isha e përbashkëta, unë isha njëri dhe tjetri.

Babai prapë do nisej dhe, pas dy javësh, do kthehej përsëri. Unë do i kaloja netët dhe ditët me nënën, me gjirin e saj, me puthjet e saj dhe me duart e saj që i njihja më mirë se asgjë.

Kur babai do të kthehej, për herë të parë në kthimin e tij, do e shihja dhe do i qeshja sikur të më kishin ndarë prej tij vetëm disa çaste. Ai do më sillte një kukull të madhe, e cila do të dinte të këndonte. Unë do shkërmoja me të diturinë time dhe do të bëhesha shoqe e saj e pandarë. Kukullën do e vinin të flinte me mua dhe do të zgjohesha me të. Babai prapë pasditeve do më nxirrte në parkun tonë dhe unë do të kisha rastin të gjeja atje buzëqeshjet e njerëzve, ndërkohë që ai me krenari do të më mbante të zbuluar dhe do të ma hiqte kapelën me kurorë të bardhë të qëndisur, në mënyrë që njerëzia të shihnin dhe të kënaqeshin me bukurinë time. Ndërsa nëna do i kundërshtonte për të mos i lënë vend syve të këqij të më shihnin. “Vajzën duhet ta mbajmë të mbuluar”, i thosh “që të mos na e zënë sykëqijtë.”

Nëna gjithmonë ka besuar se sytë e këqij kanë ardhur gjer në Kaliforni. Vite më pare, kur ende rronin gjyshërit e saj, gjyshja e saj gjithnjë i mërmëriste së ëmës: “Kujdes vajzën se është tepër e bukur. Ta kesh kujdes nga sytë e këqij”. Por nëna e saj, pra gjyshja ime, kurrë s’kish arritur ta ruante nga asnjë sy i keq.”sepse ajo kish vdekur shpejt. Lizbeth gjithnjë pajtohej me tezen time që asokohe thosh se “bukuria s’është për t’u fshehur; ajo është për të ngopur sytë e njerëzve”.

Gjithsesi nëna ime thoshte se kish qenë e pafat sepse kurrë s'kishte pasur se kush ta mbronte nga sytë e këqij.

Sipas Lizbeth "Gjithçka duhej të ishte fort e çuditshme sepse babai vazhdonte të bënte jetën e endacakut. Diçka kish vënë në dyshim nënën time, e cila në njëfarë mënyre kishte vërtetuar që im at jo gjithë kohën e largimit e çonte me shërbim.

Një ditë ai kish folur diçka vetëm për vetëm me nënën në dhomën e tyre dhe, që nga ky çast ai s'ishte kthyer më kurrë.

Rreth zhdukjes së babait tim si papritur e pakujtuar, shtatë vite më vonë, nëna ime do t'i përgjigjej pyetjeve të mia me një versionin të tillë.

- Një pasdite, ndërsa jashtë po binte një shi i rrëmbyer, pikërisht një javë më vonë, kur njerëzit ishin tmerruar nga lëkundjet sizmike të një tërmeti që s'bëri shumë dëme, unë u sëmura rëndë, një temperaturë e lartë më kishte troshitur, ndërsa kollitesha pa ndarë gjatë gjithë kohës. Nëna qante ndërkohë që më shërbente me ca mjekime, të cilat që një natë më parë mjeku ia kish sugjeruar nëpërmjet telefonit. Orët e vona të asaj nate nuk sollën asnjë ndryshim. Ish pikërisht nata, kur im at duhej të ishte kthyer nga shërbimi.

Një natë e errët, pa gjumë dhe plot ankth. Në të gdhirë nëna thërriti urgjencën dhe pesë minuta më vonë një ambulancë u shfaq, duke më dërguar menjëherë në spitalin më të afërt.

Mjeku i turnit, një djalosh tepër i ri, të cilin ime më do ta admironte për gjithë kusurin e jetës së saj, do më merrte në patronazh në prezencën e saj.

- Keni shpëtuar jetën e vajzës suaj zonjë me këtë urgjencë! - do i kish thënë ai pasi do më kish matur temperaturën. - Për pak vajza juaj do të ndodhej në një rrezik të paevitueshëm. Ajo fare thjesht mund të kishte pësuar një meningjit, është një sëmundje që shkakton irritimin dhe ënjtjen e membranave meninges që mbulojnë trurin, të cilat mund të shkaktojnë në këtë mënyrë dëme fatale. E gjitha kjo vjen nga temperatura e lartë që për fëmijët në këtë moshë është preokupante.

Nëna e tmerruar me sytë e skuqur dhe të frikësuar, me gojën që i dridhej, do e kish pyetur:

- Po tani ç'do të ndodhë?
- Tani çdo gjë do të normalizohet në duart tona, zonjë.
- Doktor s'di si mund t'ju falënderoj.

Fjalët e tij do rikthenin edhe njëherë jetën tek ajo që dalëngadalë po bëhej prë e të papriturave. Nëna ime ishte vetëm njëzet e pesë vjeçe dhe sapo kish ardhur nga një jetë plot harmoni studentore, megjithatë, dhuntitë moderne do ta kishin lënë dhuratë në duart e tim eti si një mit i virgjër. Ajo tregonte që, asokohe, ende s'dinte se ç'e priste më vonë dhe ende s'dinte se jeta ish një lloj masakre që nganjëherë të debulon në shpirt më shumë se vdekja.

Mes vajës dhe gëzimit, do i vinte ndër mend im at, të cilin e donte pranë më shumë se kurrë. Do të telefononte në shtëpi në orët e mëngjesit për të parë nëse ish kthyer dhe, kur nuk do kish marrë përgjigje, do kish vendosur ta thërriste në zyrën e brigadës, ku ai shërbente. Im at ish një parashutist i përkryer i një brigade speciale. Ajo thjesht kish menduar se atij do t'i kish dalë, si jo rrallëherë, ndonjë shërbim urgjent dhe ajo mund të ishte një arsye e pashmangshme. Megjithatë vendosi ta thërriste.

- Jam zonja Codington. Keni mundësinë, ju lutem, të më lidhni me qendrën tuaj. Dua të pyes për burrin tim. 234 cod, Williams Klaims.

- Vetëm një minutë, zonjë.

Nga ana tjetër linja kish humbur dhe një zë gruaje ishte bërë e gjallë.

- Zoti Klaims, s'është me shërbim zonjë. Ai është me pushimet e zakonshme. Po shfrytëzon, me sa di unë, pushimet që departamenti i ka dhuruar me shpenzimet e tij, në Miami.

- Ashtu qenka?!

Tjetra u habit dhe pyeti:

- Ju lutem, me kë kam nderin të flas, zonjë?
- Me gruan e tij. Mary Kodington.

Tjetra donte t'i thoshte diçka më shumë nënës, e cila e tronditur kish mbyllur telefonin.

Lotët e saj s'kishin të pushuar dhe, marramenthi, më kishte marrë e shpënë gjer në shtëpi.



Im at do kthehej tre ditë më vonë, kur unë do isha përmirësuar tërësisht.

Nëna s'e kish mbajtur dot me veten dhe do t'i përvishet menjëherë e zemëruar.

- Ku është shërbimi yt? Përse të më gënjesht? Shkon me pushime zotrote ndërsa vajza juaj sëmuret për vdekje. Mua më ke bërë shërbëtores. Ti nuk je më, ai që ke qenë dikur Will. S'e kuptoj ç'po ndodh?

Im at kish ngelur me gojë hapur nga ato të vërteta që ime më po ia dridhte sheshit në atë mënyrë. Ishte nxirë i tëri në fytyrë dhe e kish zënë për supesh duke e shkundur.

- Kjo është mënyra që t'i duhet të më flasësh. Nuk gjen shprehje më të buta.

- Ç'shprehje të buta! Ke mbërritur të më kërcënosh, të vësh dorë mbi mua, të flesh me mua një herë në vit. Ke përçmuar dashurinë dhe gjithçka ka qenë me vlerë mes nesh. Ndërkohë që unë vuaj, ti merr pushime për t'u çlodhur. Pse s'na ftove dhe mua me vajzën në Miami. E shikon diçka e tmerrshme po ndodh mes nesh Will. E shoh, e ndiej. E jetoj ditë e natë. Diçka e tmerrshme, e tmerrshme e tmerrshme. Prandaj dua të di ç'do bëhet me ne. Si do shkojë puna jonë?

Babai s'kish si t'i përgjigjej më vërsimit të saj. Ai vetëm kërkoi të ulte gjakrat. Atë natë ndërsa unë po qaja në dhomën tjetër.

- Ke të drejtë, e dashur, - i kish thënë. - Bëra diçka të papërkryer, ishte thjesht sepse isha i lodhur. Pas luftës, kisha nevojë për pakëz qetësim. Kjo është e gjitha...

Im at kur kish dalë në dhomën time më kish marrë në krahë, më kish puthur në qafë dhe në faqe dhe më kishte dorëzuar në duart e nënës.

- Ti e di që në luftë kam hequr mjaft. Ndiheha i stresuar dhe ish e domosdoshme për mua të gjeja çastin për të harruar ç'më kanë parë sytë në atë luftë. Kam ende para sysh zërat që çirren ndër rrënojat e ndërtesave, fëmijët që qajnë dhe nënat që heshtin si mumie. Kam ende ndër veshë klithjet e shpirtrave të tyre dhe vazhdoj të shikoj ende flamujt e bardhë që rrëzoheshin nga breshëri i plumbave. Kam

shpirtin plot me plagë, e dashur dhe, nganjëherë e vetmja gjë që dua është që të gjej një mënyrë për ta shëruar.

Diçka kishte thyer zemrën e nënës sime atë natë, por gjithsesi ajo u kish besuar fjalëve të tij dhe ish bërë edhe njëherë skllave e puthjeve e përkëdheljeve të tij plot epsh.

Sido që të ishte, ime më, gjersa të zbulonte një të vërtetë të krisur, do besonte si një e verbër në dinjitetin dhe në nderin e tij. Edhe pse ai do të abuzonte plot herë të tjera me violencën e një njeriu që brenda fytyrës njerëzore mbante mjeshtërisht një maskë me ngjyrë skëterre. Ajo do të duronte gjithçka gjer sa një ditë do të shpërthente e vërteta si një bombë që s'le më të gjallë, asnjë ndjenjë.

Kur unë do mbushja tetë muaj, ndryshimet mes tyre do kishin marrë kulmet dhe s'do kish ngelur më asgjë veçse ndjenjës së ftohtë të tim ati dhe durimit infinit të nënës sime.

Atëherë një të diel të vonë do të shkrihej si plumbi e vërteta dhe do të binte mes të dyve pa lënë as njërin e as tjetrin për të marrë asnjë rrugë të ndryshme përveçse rrugës që çon dashur pa dashur vetëm drejt ndarjes.

Atë natë im at do të kthehej i dehur. Ajo do të ngrihej dhe të përbuzte pasaktësinë e tij, dinjitetin e tij i cili kish marrë përmasa tepër të ulëta e të padurueshme. Goja e saj do të nxirrte një vrer që ish mbledhur cërkë-cërkë ndër vite gjer thellë në shpirtin e saj përherë të paqetë për shkak të tij që, nga tepër i lumtur, ishte bërë tepër i trishtë. As ekzistenca e rrita ime s'e mbushnin dot më atë boshësi të krijuar mes tyre.

Ai do ngrihej dhe, si herë të tjera më parë, qe xhindosur dhe do e godiste me grushte, do e rrëzonte dhe, kur do të afronte fytyrën e tij, të shtrembëruar nga nervat, do i kërcënohej.

- Do ta them të vërtetën?! Ta them që ç'ke me të! S'mund të jetoj më me këtë ironi të shtirë. Unë jam pjesë e tjetërkujt. Unë dashuroj një tjetër. Që kur zemra ime është bërë shërbëtore e saj, ti s'ke pasur më vend në të. Unë s'mund të jem më i yti. E kam vendosur.

Ime më ish dyndur në lot dhe kish gjetur fundin e një ëndrre që gati e çonte te vdekja.

Po të mos ish zëri im që do ta zgjonte, ajo me siguri do ish bërë prè e ndonjë marrëzie njerëzore, do më kish lënë lamtumirën.

Kur ishte ngritur e mpirë nga goditjet dhe nga makthi Babai ishte zhdukur, për të mos u kthyer më.

Më vonë nënës do i vinte lajmi sikur im at ishte larguar nga Shtetet e Bashkuara me një shërbim të përhershëm, në Afrikën e Jugut, bashkë me bashkëshorten, kolegen e tij njëfarë bukurosheje me fame zonja Anita Liksbell, me të cilën, më vonë mësuam se kish studiuar në akademinë ushtarake të Bostonit.

Kur të rritesha do zbuloja, me anën e fotografive, bukurinë burrërore të tim ati dhe hijeshinë femërore të nënës sime. Atëherë do mendoja se sikur të kishin qenë të lumtur bashkë me siguri që do kishin bërë pjesë në çiftet më të bukura të Kalifornisë.

Gjithsesi të vërtetën e ndarjes mes tyre do arrija ta zbuloja shumë vite më vonë. kur dallgët e jetës më shtynë, për të gjetur rrugë të cilat duhej t'i mësoja njëherë në këtë jetë, doja apo s'doja. E vërteta do rezultonte megjithatë në një formë krejtësisht tjetër. Atëherë kur as njëri dhe as tjetri s'do hezitonin ta fshihnin më të vërtetën. Sepse shikimet dhe mendimet e mia të ndotura me nervozizmin e një serioziteti të pjekur do e kërkonin atë të vërtetë le të ishte si të ishte. Gjithçka do meritonte gjykimin tim, sepse të tilla do vinin rrethanat e jetës sime, më tej, në skaje paragjykimesh, ku hollësitë i shkruan dhe i tregon vetë koha dhe jeta.

## 5

Unë do rritesha ndërsa ime më do e merrte veten, nga tragjedia që ia kish dobësuar zemrën dhe e kish vënë në krahët e një jetë plot sakrificë.

Ajo do të arrinte të më edukonte si një fëmijë të denjë, të lumtur dhe, do të bënte të pamundurën që të më sillte gjithnjë pranë edhe dashurinë atërore.

Ajo me punën e saj do të arrinte të plotësonte çdo dëshirë timen. Ajo do të merrte aq famë si stiliste dhe ne “beauty face” sa që do të zinte një vend të rëndësishëm në një kompani që kontraktonte direkt me Hollivudin. Fitimet e saj do të ishin të mirëfillta dhe, brenda tre vitesh, ajo do të blinte një shtëpi të re në brigjet e oqeanit, në lindje të Los Angelesit, aty ku dielli të zgjon çdo mëngjes me ëndrra të reja. Unë isha një fëmijë i lumtur në gjirin e nënës sime dhe rritesha e lirë në dallgët që më përkundnin, midis dashurisë së saj dhe ëndrrave femënore.

Ende pa mbushur pesë vitet, ajo do të më prezantonte te një muzikant i ri, por që më vonë do të merrte shumë famë edhe jashtë kufirit të vendit tim. Ai do të quhej Tomas Rokbell. Tomasi s’do të përtonte të merrej me mua për orë të tera, të më mësonte të luaja në piano dhe të më mësonte këngë të kompozuar prej tij dhe të tjera të kënduara nga këngëtarë të njohur. Ai do të dëgjonte zërin tim dhe, pa kurrfarë hezitimi do të shprehej para nënës dhe të tjerëve se unë do të bëhesha yll i famës. Unë, megjithëse s’e dija se ç’ish fama, kënaqesha me arritjet, me përgëzimet e tij dhe të tjerëve dhe dëshira për të kënduar më shtohet gjithnjë. Kështu e doja edhe më shumë nënën time dhe jetën që më rrethonte. Vetë në shtëpi këndoja duke

i rënë pianos, duke mësuar pjesë muzikore e këngë të reja dhe duke imituar këngëtarët e rinj, të talentuar.

Sapo fillova shkollën, të gjithë zunë të më dashuronin, të gjithë kërkonin që t'u këndoja dhe duartrokisnin kur mbaroja këngët poshtë një zëri deshifruës, të cilin të gjithë e merrnin si të veçantë. Shkolla ime e quajtur “The art of the music”, ish një shkollë artistike në qendër të Toluca Lake, qytet në verilindje të Los Anxhelosit. Nga ajo kanë dalë shumë artistë të tjerë dhe unë sot e kësaj dite do të isha, kushedi mes tyre, po të mos ngjante diçka e tmerrshme dhe të thyente dinjitetin tim, të gjuhëzonte krenarinë time dhe të më hapte një tjetër portë të jetës, të cilën unë, kur kuptova me të vërtetë se ç'ishte jeta, e quajta “Porta e fatkeqësisë”.

## 6

Një natë para se pranvera t'i linte shëndenë Kalifornisë, pikërisht kur qengjat dalin fushave për të lodruar dhe, kur zogjtë e shtegtímeve të largëta, marrin rrugët për te një tjetër natyrë, kur fëmijët çapkënë kthehen nëpër foletë e ëndrrave, kur njerëzit kanë mendjen vetëm të dëfrejnë, kur bota harron se ç'është, ç'ka qenë dhe ç'do të jetë, kur dashuritë ngjallen mes njerëzish me mistere të reja, kur rrugët moderne mbajnë tragjeditë e rimëkëmbura dhe shkelin mbi të vjetrat çirrije, kur çmenduria lind për t'u bërë më e çmendur dhe kur mrekullitë flenë për t'u zgjuar në praninë e një bote të paarritshme, nënën time do ta fjollëzonte një valë gëzimi, ish si një fshikje e një kamxhiku lumturues, ku nga goditjet e tij njerëzia dehen dhe humbasin mendjen, kur dashuri te reja linden dhe te vjetrat harrohen. Mes ciknës së parë të verës së ngrohtë në një liman të mbushur me marinarë të posakthyer nga udhëtimi, ku të gjithë pinin birra, uiski dhe verë kaliforniane, ku akulloret dhe çokollatat për gjithkë shiteshin më lirë, kur buçima e zërave të ngjirur e lozonjarë të marinarëve ngrohte shpirtrat e vajzave vetmitare dhe te grave të ndara nga burrat, kur pulëbardhat shoqëronin me këngët e tyre puthjet e ashpra të nofullave burrërore që shtrëngonin fuqishëm dhe kur prania e botës dhe e dashurisë bashkohej e gjitha në një pikë... Pikërisht aty, do zinte fill një tjetër histori që do linte hijen në fatin e njerëzisë dhe në fatin tim.

Nëna ime kur do të shihte hijen e tij, do të drithërohej. Ai, me forcën e tij prej përbindëshi detesh do ta ndukte nga supet si një pishtarë që shuhet nga një flad i çastit dhe, ajo, bashkë me heshtjen, do të ndrydhte të gjithë të kaluarën dhe do të ndriçonte mbi të renë.

Dashuria mes tyre do të lindte mes linjash flagrante që, më shumë se gjithçka, përçmojnë, por janë linja që njohin çmimin mbi të vërtetën që kurorëzohet dhe hidhet mbi shpirtat njerëzore si një mizori.

Ajo natë për nënën time do ishte nata e parë e mrekullive që atë, herën e fundit, kur im at do ishte larguar, për të mos u kthyer më, aty e gjashtë vite më parë, se unë të ndeshesha me dritëhijen e llahtarëve të kësaj bote.

Ajo do ta çmonte njeriun marinar që kish përkrah jo vetëm nga paraqitja e tij fisnike, jo vetëm nga sytë që i shkëlqenin me një blu të fortë, por të ndotur, jo vetëm nga zëri i thjeshtë dhe makabër, jo vetëm nga shikimi zhbirues dhe provokues, jo vetëm nga ëmbëlsia me të cilën ai i fliste, jo vetëm nga maturia që mund të çmendte çdo femër, jo vetëm nga trupi i hedhur dhe shpatullgjerrë, por ajo, do të çmonte shpirtin e tij, i cili do i thoshte se kishte vlerë.

Ajo do të dashurohej pas atij shpirti, duke marrë si bazë vetëm të rrahurat e një zemre që pulsonte ndër duhmën e gjithë shqisave të tij, trupi i saj do të dërsinte e shtyrë nga një ngrohje e brendshme që do të digjte çdo arsyë. Ajo do t'i dorëzohej atij që atë natë. Ajo do ta ftonte në shtëpi. Aty në folenë tonë të bekuar ku për më shumë se gjashtë vite s'kishte shkelur këmbë mashkulli, që të mund të përlligite karakterin e asnjërës prej të triave. Aty ku altari i dashurisë dhe lumturisë thuajse kishin zënë vend në lartësi të paprekshme. Aty ku unë për të parën herë do të flija me Lizbeth, e cila më pastaj do rezultonte një ndër personazhet më të dashura të gjithë vegjëlisë sime, të cilës gjatë gjithë jetës do t'i fshihja, të vetëm një sekret.

Kështu do ndodhte, rrjedhtas një dashuri, kurthi i një gracke mbase fshihej pas atij shndërrimi të paskrupullt.

Kur do të ngrihesha në mëngjes, do ndieja mungesën e duarve të saj, të puthjeve të saj dhe do të kurdisja një ëndërr të keqe pas një gjumi plot ankth.

Kur Lizbeth erdhi lart në dhomën time dhe më mori për të ngrënë mëngjes, nëna, fare pa hezitim do të më prezantonte me marinarin Xhek Shell. Ajo do dilte nga dhoma e saj, nga ajo dhomë ku unë çdo natë do ndieja zemrën e saj të rrihte në timpanet e veshëve të mi, ku

aroma e nënës s'dinte të shndërrohej në tjetër aromë. Ndërsa ai do dilte menjëherë pas saj. Kish një fytyrë të ndezur. Kish një shikim prej intriganti, m'u duk, ish një shenjë ballafaqimi, mbase ai ish një gjykim i gabuar, i përciptë dhe i shpejtë i imi, përqendrimi i të cilit askujt nuk i nxjerr rezultat vetëm me një të parë të syrit, vrikthi. Por isha larg, të mund të vlerësoja dikë me sy. Një vogëlushe gati shtatëvjeçare mund të vlerësojë vetëm përkëdheljet e dikujt, mund të vlerësojë buzëqeshjet e sinqerta të dikujt mbase, por jo regjistra kaq të gjerë, diagramat e mirësisë apo të djallëzisë që një i rritur mund t'i shprehë me shikimin e syve.

- Njerëzit duhet kohë e gjatë që t'i njohësh mirë. - thoshte Lizbeth më vonë, kur shumë gjëra do të bëheshin shkas e do të flisnim më gjerësisht për figurën e tij.

Atë mëngjes, një xheloz i errët, si një braktisje e thyer dhe e pabesë do të më shkulte në shpirt dhe do të shkrehesha në vaj me dënësë. S'do ish dora e saj që do të më qetësonte, as puthja e saj, as zëri i trashë i Xhekit, i cili më kot u mundua të më tregonte një histori për udhëtarin e largët marinar.

Unë do të zbrisja shkallët me të shpejtë dhe fshehurazi syve të tyre do të dilja jashtë, do të shkoja te lulet dhe do të këpusja një karafil të verdhë, do i merrja erë.

Atë çast do ndieja mungesën e aromës së dikujt, aromën e një burri. Do ekzistonte diku apo jo?! Do të ngrija sytë nga qielli. Një re e bardhë e madhe sa një kontinent do lundronte në atë kaltërsi të pafund. Ishte e pamundur ta deshifroja në gjithë atë hapësirë.

Do qaja, do qaja lehtë me ngashërim, si një e rritur, duke u munduar të kapërdija hidhërimin që më ish shfaqur pa motiv, gjer sa Lizbeth do të më afrohej duke më qetësuar me disa fjalë të ëmbla që s'ua vura veshin.



U desh kohë gjersa unë të mësoja rreth bimëve, rreth kafshëve të zoologjikut në një kodër të periferisë jugore, të mësoja disa rrugë më shume të Los Anxhelosit dhe të sodisja krenarinë e Hollivudit me kodrat përreth dhe pishinat moderne të njerëzve me famë, gjithashtu gjer sa mësova më në fund edhe notat e një melodie të Bethovenit të cilën nëna ime e fishkëllente që në miturinë time, kur bie fjala dilte në oborr për të nxjerrë qenin ose kur lante pjata në kuzhinë ose dhe kur dilte në ballkon dhe ujiste lulet. Ishte si të thuash një nga pjesët muzikore më të preferuara të saj. Këtë e kuptova dikur, shumë kohë më vonë kur edhe unë u bëra personazh i vyer duke u dashuruar pas veprave të artit të cilave kisha dëshirë t'u vidhja pakëz modesti dhe, kur tingëllimën që lënë në shpirt e përvetësoja duke shpërthyer nëpër çaste të tëra nostalgjie, apo vetmie, kur shpirti më vuante për diçka ose kur humbisja nëpër kujtesën e gjerave që më ndihmonin të harroja gjerat e urryera.

Gjera si këto do të shkonin e vinin, unë duhej t'i kapërceja dhe të zhduksha përmes hijeve të tyre, të pluskoja nëpër imagjinata dhe të dehesha me bukuritë e jetës që sapo kisha nisur t'ia jepja krahët e mi të lehtë.

Ndërkohë do të njihesha edhe më shumë me Xhekin dhe, në një mënyrë të pavetëdijshme, do të vizatoja në mendjen time mirësinë e tij, dashurinë dhe respektin e një prindi paqësor, ndërkohë që ime më do të harente mes dy dashurish dhe mbarësisë sonë. Në sytë e saj do të arrija të lexoja vetë lumturinë dhe kthimin e saj në një jetë plot virtyte, plot punë dhe gëzime, ku baza ishim tashmë që të tre.

Unë, jo vetëm që u miqësova shumë me Xhek Shellin, por një natë, teksa po hanim darkë në një restorant mjaft në zë, në qendrën më të frekuentuar të Santa Monikës, ku kish aq shume njerëz dhe aq pak fëmijë, arrita ta thërras, baba.

E gjithë kjo erdhi si një befasi, për ata të dy dhe për pafajshmërinë time engjëjllore. E shihja që nëna ime e donte aq sa më donte dhe mua, sepse sa herë preferonte të më linte në shtëpi të mbyllur me Lizbeth për orë të tëra, madje nganjëherë edhe me ditë të tëra të zhdukej me të dhe të kthehej me të e të mbylleshin në dhomën e tyre gjatë e më gjatë, duke harruar pothuajse ekzistencën time.

E shihja që Xhek Shell ishte personi që po i ndryshonte jetën nënës sime, shihja zellin e saj eksplorues, dridhjet emocionuese të saj kur ai i kërkonte diçka, qeshjen e saj të cekët, kur më parë kishte qenë aq e thellë, të folurat e saj të thara që dikur kishin qenë aq të frytshme. Vullneti i saj ishte gjallëruar në një nivel me moralin e saj fizik. Shpenzonte me shumë kohë me veten dhe më pak kohë me mua. Blinte më shumë rroba për veten dhe më pak për mua. Gjithsesi po besoja në bukurinë dhe në finesën e saj gjer në atë pikë sa që jo vetëm e admiroja por edhe e adhuroja. Ndryshimi i saj ish rrënjësor, në të gjitha drejtimet, ishte më impulsive me vetë jetën, më e gjallë, e ripërtërirë. Shihja devotshmërinë e saj që kish bërë të më harronte, por gjithsesi në qenien time s'kish asnjë hije të vogël hatërmbetje apo dhe zemërimi. Unë kundroja ato ndryshime si e struktur brenda një zgafelle, ku ajo më linte enkas aty, për të më mbrojtur nga diçka që ka të bëjë me rrezikun dhe për t'u kthyer e për të më marrë, kur të ishte më e sigurt. Unë dalloja qartazi që ajo ishte e tij dhe, unë si e saj isha e tija gjithashtu. E ndieja se më mirë se ai, askush s'do ta luante rolin e tim atë. Askush përveç tij s'do përmbushte kënaqësinë e nënës time dhe askush s'do të frenonte në një mënyrë më të paqtë e të menjëhershme brutalitetin e saj ndaj jetës, kur ajo e quante veten një nënë e ndarë.

Nëna ime ishte bërë më e dashur, kishte fituar qetësinë, mënyrën spontane të një sjelljeje plot ngrohtësi dhe të ffishme. Unë sillja ndër mend dikur ashpërsinë e saj të sinqertë, por që mua më kallte datën. Më mbështillte me një frikë aq të madhe sa që dhe kur më qeshte duhet të mendohesha gjatë para se t'ia ktheja buzëqeshjen.

Kontrasti mes qenieve të gjalla është shpotitës, atë që shihja e bëja, atë që më thoshin e përsërisja. Vetëm një natë më parë nëna ime më kishte pyetur ndërsa u bëmë gati të flinim bashkë.

- Xhek Shelli, të pëlqen për baba? Unë s'fol. Ngela e shtangur dhe vetëm arrita pas një çasti të fshij lotët që ma mjegulluan shikimin. Dhe vazhdoi: - Unë do të thosha, se mund të jetë njeriu më perfekt.

Që atë natë dhe të nesërmen m'u ngulitën në tru ato fjalë. Përsërisja rresht me vete: "Xhek Shell, babai im? Xhek Shell, babai im? Xhek Shelli babai im?..."

Që nga ajo natë u mësova dhe e thërrita Baba.

S'ishte shumë e vështirë për mua meqë kurrë s'kisha mësuar të thërrisja baba dikë tjetër edhe pse e dija që im at rronte diku larg me një grua tjetër të bukur për botën, por të shëmtuar për ne, siç më tregonte sa herë nëna.

Kështu do të fillonte një tjetër histori e ngushtë, me dallime të fiksuara drejt një të reje që zotëronte një të shkuar të gjatë. Xhek Shell do të bëhej më i preferuari i botës dhe, nëna ime, s'do pushonte së foluri për të ditë e natë. Një prani e përhershme, herë fizikisht dhe herë duke folur për të. Ajo do te me fliste sa herë haptas për dashurinë e saj në lidhje me të, sikur unë të isha një shoqe e saj dhe jo një bijë e saj vetëm gjashtëvjeçare. Unë do të arrija të dalloja dritën që ndizej në sytë e saj, kur fliste me patos për Xhek Shellin, dridhjet e buzëve të saj, kur ia shqiptonte emrin, mërzinë e tmerrshme që e pushtonte, kur ai s'do të bëhej i pranishëm në kohën e duhur dhe preukopimin e gjatë, që do të ruante ajo kur ai nisej për udhë në det dhe s'kthehej për ditë të tëra. Ishin të gjitha këto shenja që kishin të bënin me relacionin e saj.

Kur ai do të kthehej qeshte e gjithë shtëpia, do të dilnin bashkë dhe s'do të vinin gjer në mëngjesin e ditës tjetër dhe, kur do të ktheheshin do më sillnin dhurata nga më të ndryshmet. Njëherë vetë Xhek Shelli do më kujtonte me një piano nga më modernet të blerë në një ishull të Karaibeve, me të cilën do kaloja shumë kohë të çmuara.

Nëna gjithashtu do të më sillte gjithnjë gjera të ndryshme, si kukulla, fustane dhe krehra prej kristali, pasqyra që përdornin gratë dhe të kuq buzësh, për të cilët unë isha e çmendur sepse me gjera të tilla unë do të lidhja ëndrrat e mia.

Disa muaj më vonë, nëna, në një bisedë intime me mua, kur Lizbeth do kish shkuar me pushime në Dallas tek e ëma e saj dhe, kur Xhek Shelli sapo ishte nisur mëngjesin e po asaj dite për udhë, pasi kish fjetur me nënën time dhe kishin bërë gjithë natën një potere, që ish e përhershme para kohës së ndarjes, do më shprehej për diçka të tillë të verbër, të cilën unë do e miratoja në një mënyrë të menjëhershme.

- Kemi rënë dakord me Xhekin që të martohemi, - më tha dhe u ndal para shikimit tim duke m'i ngulur sytë e saj të zi që i shndrisnin aq ëmbël, duke e bërë edhe më të bukur nga ç'ishte në të vërtetë.

Unë e ktheva kokën nga ana tjetër ngaqë s'e durova dot shpimin e syve të saj, por ajo vazhdoi duke më përkëdhelur në flokë me dorën e saj të butë. - Ty si të duket kjo histori?

- Mami, - i thashë, - ti e di që unë jam e lumtur kur ti je e lumtur. Unë e di që Xhek Shelli s'është babai im i vërtetë, por unë ngaqë e shoh se ti e do njësoj siç mund të doje babanë, pranova ta quaj baba.

Nëna s'i mbajti dot lotët që i vërshuan rrëke duke ia shkoqur një pjesë të rimelit ngjyrë të kaftë.

- Të dua shumë, bijë, - dhe më shtrëngoi në krahë, - tashmë ti më je rritur dhe të kam si një shoqe.

Atë natë fjetëm bashkë, edhe të nesërmen, çdo natë, gjersa erdhi dita dhe Xhek Shelli u kthye nga udhëtimi i radhës dhe u vendos përfundimisht në shtëpinë tonë.

Ditën e parë të qëndrimit të Xhek Shellit u bënë ndryshime në shtëpi. Unë luaja me lodra në dhomën time, ndërsa nëna me Lizbeth, vinin sendet e shtëpisë nëpër vende të ndryshme siç i planifikonte Xhek Shelli, i cili sillej nëpër shtëpi sa andej-këtej, sa lart-poshtë, duke treguar me dorë se si të rregullonin shtëpinë. Ai gjithmonë kishte një dëshirë t'i fliste nënës për disa ndryshime elementare që, sipas mendimit të tij, duhej të bëheshin në mobilimin e ri të shtëpisë dhe, kur binte fjala për nënën, ajo përgjigjej:

- Kështu është kur shtëpia e ka një zot, - ndërsa mua, që me gjente gjithnjë me veshët e ngritur dhe me sytë kërkues, më thoshte më vonë. - Kemi nevojë për një mbrojtës moj bijë, dy femra të vetme kurrë s'ndihen të sigurta.

Unë gjithnjë e vrisja mendjen për ato fjalë, duke u munduar të gjeja gjithmonë se kush mund të ishin keqbërësit tanë, të cilëve në këtë botë u interesonte të merreshin me gra të pambrojtura, sidomos me një grua aq të pafajshme siç ishte nëna ime dhe me një fëmijë aq engjëllor siç isha unë.

Sido që të jetë, gjithçka më ngjeshej në tru dhe, ndërsa kërkvoja të fshehtat e atyre fjalëve, që më mbinin thellë në kokë, koha shënonte ndryshimet e saj.

Pra Xhek Shelli përveçse burri i dashur i sime meje dhe babai i dashur i imi do ish që nga ajo kohë edhe mbrojtësi i familjes sonë femërore.

Gjithçka do të shkonte për mrekulli, një jetë e re do të fillonte të shpërdridhej bëhej mes haresë dhe të mirave plot shije. Unë do të vazhdoja shkollën, njëkohësisht nëna do më kontraktonte një mësues muzike, i cili do ish një tjetër personazh me rëndësi të madhe në

historinë e jetës sime. Vite më vonë, kur do të analizoja figurën dhe mirësinë e tij, do e kuptoja më mirë rëndësinë e ndikimit të madh të atij personi. Mësues Xhakelini, ky do ish emri i tij, - me një zell të veçantë do më mësonte kitarën; ai do ish gjithnjë i palodhur dhe me durimin e spikatur të një profesionisti pasionant, që nga notat më të holla e gjer tek akordet më të ndërlikuara. Pastaj, krahas kitarës do punoja edhe në piano. Aty do të shkrihej vullneti im. Ndërsa ai do te habitej për talentin tim, të cilin ai arrinte ta zbulonte pas çdo orë mësimi.

Mësues Xhakelini, jo vetëm do të më mësonte me pasion, por do të shprehej hapur para nënës dhe Xhek Shellit se unë isha me të vërtetë një fëmijë me perspektivë, se ishte i sigurt, se do të çaja përpara dhe, mbi të gjitha, ia kish enda të shprehej rreth bukurisë sime, me të cilën kur të rritesha do të magjepsja meshkujt e botës, duke rrezikuar t'i dërgoja drejt një çmendurie të sigurt.

- Është e shkathët dhe inteligjente, - do të shprehej ai ndërsa nënës do t'i shkëlqenin sytë me po atë forcë sa të më bënin të kuptoja lirisht se ish tejet e lumtur me arritjet e mia.

Një mëngjes, pas një nate të ftohtë, Xhek Shelli sapo ish kthyer nga një udhëtim njëjavor dhe kish kaluar me nënën time, një natë aq të bujshme, saqë nga zhurmat dhe bisedat më kishin lënë pa fjetur gjer sa sytë më ishin mekur nga pagjumësia dhe lodhja më kish skërmitur, pikërisht atë natë do të ndodhte një fatkeqësi që do të kish lidhje të drejtëpërdrejtë me Lizbeth, tragjedi për të cilën unë do të qaja ditë me rrallë.

Unë, thuajse çdo natë, pasi kundroja qëndrimin e Lizbeth gjersa ajo të flinte, isha mësuar të dëgjoja bisedimet e nënës dhe të Xhek Shellit në dhomën e tyre. Në këtë mënyrë, unë çdo natë pasi Lizbeth flinte, ngrihesha hapja portën me ngadalë dhe afrohesha tek porta e tyre me të cilën na ndante vetëm banja. Afroja kokën gjer tek porta dhe, nganjëherë, shihja nga vrima e çelësit.

Meqë atë natë kishin bërë potere si radhë ndonjëherë, atëherë kurioziteti im s'u shua edhe pse po luftoja me lodhjen dhe pagjumësinë dhe vendosa t'i ndjek gjer në fund. Madje atë natë meqë kishin harruar t'i vinin çelësin portës nga brenda, gjë të

cilën nena ime i kushtonte shumë kujdes sepse e kisha dëgjuar kur pyeste Xhekin, më parë se t'ia nisinin, nëse i kish hedhur celësin portës.

- Është e tmerrshme! - i kish thënë nëna, - po të ngrihet ajo dhe të hyje brenda, s'do doja të ndodhte për gjithë çfarë ka bota, - është ende e vogël dhe ruhem aq shumë prej saj sa që kurrë s'më ka parë të zhveshur. Thjesht s'jam zhveshur asnjëherë në prezencën e saj, të paktën që kur ajo ka mbushur vitin.

Por atë natë zunë të flisnin për diçka të pazakontë.

Pasi ranë në pushim dëgjova zërin e tij që i kërkoi ujë. Dhe nëna u ngrit dhe e pashë kalimthi nga vrima e çelësit të veshur me një fustan natë bojë qielli. Edhe ujin edhe pije të tjera që Xhek Shellit ia kishte ënda t'i kërkonte natën nëna i mbante në dhomën e tyre, kështu që s'do kish nevojë sa herë t'i çohet Xhek Shellit për të pirë diçka të hapte portat e dhomave dhe korridoreve dhe të prishte qetësinë e gjumit tim. Unë këto gjëra arrija t'i kuptoja edhe pse askujt s'i shkonte ndër mend që unë mund të gjykoja aq thellë.

Siç thashë atë natë tema ish një tjetër. Bëhej fjala për Lizbeth. E dëgjova me veshët e mi kur Xhek Shelli, po i thoshte nënës, se Lizbeth s'ish asgjë më tepër se një zezake e ndyrë dhe antipatike, një grua e shëmtuar që s'e meritonte të jetonte në familjen tonë, prandaj duhet të merrnin vendim me fjalën e tij që ta hiqnin menjëherë nga shtëpia me gjithë zhelet që ajo kish të sajat.

Kjo më ra si bombe dhe një fjollë urrejtjeje ma veshi kokën ato orë të vona të natës.

- M'u shpreh fare shkoqur në drejtimin tënd, - dëgjova zërin e nënës, - Lizbeth më tha se ish e ofenduar nga disa fjalë pa kuptim e të rënda që sipas saj i ishit kundërvënë.

Xhek Shelli, ia plasi gazit me përbuzje dhe mërmëriti:

- Mos do t'i puthim edhe bythën asaj zezakeje të qelbur?! - Zëri i tij kish më tingëlloi me oshtimën e një egërsire të panjohur. - Bëmë nder, bëmë nder dhe largoma sa s'kam bërë ndonjë të pabërë me atë të fëlliqur.

Asgjë nga ajo që po dëgjova s'ish e vërtetë. Lizbeth s'ish aspak e fëlliqur, ajo ish një grua e zeshkët, pakëz topolake, me fytyrë të

rrumbullakët dhe me sy të zinj e të shkruar. Ajo ish shumë e pastër dhe e mbante shtëpinë tonë me një rregullsi sovrane. Kurrë s'ish parë ndonjë ç'rregullsi në asnjë qoshk, as në ato vite kur unë mbahesha si mbretëresha e rrëmujes. Pastaj... pastaj gatuante në një mënyrë të përsosur sepse vetë nena ime e kish zgjedhur me rekomandim nga një kolegia e saj që, me sa mbaj mend, quhej Kristina, një grua e dyndur në para dhe që jetonte në një nga lagjet më të pasura të Hollivudit, tek e cila Lizbeth kish jetuar pesëmbëdhjetë vite gjersa fëmijët e Kristinës ishin rritur dhe qenë bërë zotër të vetes. Asnjëherë s'kish pasur asnjë problem përderisa dhe Kristina kish marrë guximin ta rekomandonte në një kohë, kur askush s'ka besim të rekomandoje askënd.

Nëna, pak a shumë për këtë temë, u mundua t'i fliste Xhek Shellit, por kur vuri re që ai hungërinte edhe ajo i mbylli sytë dhe veshët.

“Zot i madh! S'fjeta gjithë natën. Isha e tmerruar sepse s'po arrija të kuptoja asgjë, s'e dija gjer në ç'pikë do mbërrinim në atë mënyrë.”

Dikur nga të ftohtit u zgjova nga dyshemeja e korridorit dhe, duke ecur në majë të gishtërinjve, mbërrita në dhomë. U struka në krevatin e Lizbethit meqë çdo mëngjes, qëkur kish ardhur tek në Xhek Shelli gdhija në krevat me Lizbethin.

Të nesërmen, edhe pse kisha dëgjuar të gjitha bisedat, duke u përpjekur për të ruajtur interesat e të mëdhenjve të familjes, s'i kisha thënë asgjë Lizbethit. Gjithçka që po ndodhte më dukej e padrejtë, një njeri më të mirë, jo vetëm për mua, por edhe për nënën time, s'do të gjendej në tërë botën. Që prej gjashtë vitesh jetonte me ne dhe kurrë s'kishim pasur asnjë incident prej saj dhe, mbi të gjitha, ish një grua e dashur dhe tepër e edukuar.

Ndërsa shihja atë të qante dhe unë qaja më me dënese, saqë nënës iu desh të më dërgonte tek një kushërirë e saj gjersa unë të harroja atë të zezë që po ndodhte.

Tri ditë më vonë, kur u ktheva sikur s'e gjeta më atë ngrohtësinë që gjithnjë më priste në gjirin e Lizbethit.

Regjimi im ditor ish hartuar dhe ish zbatuar, në atë mënyrë, që mua një pjesë të madhe të ditës, më duhej ta çoja në shtëpi vetëm.



Ish ajo kohë që më bënte të kujtoja fjalët e dikurshme të nënës, se dikush mund të hynte dhe të ma bënte të zezën, meqë mua s'kishte kush të më mbronte. Duke menduar, se vetë të mëdhenjtë i dinin më mirë të gjitha, kurrë s'shpreshsha para nënës sime për frikën që herë pas here më pushtonte.

- Ti tashmë je e rritur, - më tha një ditë nëna në prezencën e Xhek Shellit, i cili zuri të vinte buzën në gaz, në një mënyrë të tillë që, mua për herë të parë, qëkur e kisha njohur të shkelte pragun tonë krah për krah me nënën, më la një fshikullim frikë nëpër mendje. - Mund të rrish vetëm, asgjë e keqe s'mund të të vijë. Tani di të hapësh portën, ta mbyllësh. Duhet t'u besosh vetëm të njohurve. Ja p.sh. kur je vetëm mund ta hapësh portën vetëm për mësues Xhakelinin dhe për askënd tjetër. Ti tani njeh mirë të mirën dhe të keqen. Di si të flasësh, si të sillesh, si të mbrohesh!

Nuk flisja, s'dija në të vërtetë përse po ndodhte gjithçka, përse ato fjalë dhe ato ndryshime e këshilla si të tërthorta? Përse ajo rrugë aq e larmishme? Megjithatë gjithmonë ngushëllohesha duke ua lënë në dorë gjërat të mëdhenjve.

Kështu do të fillonte një tjetër epokë e jetës sime. Dashuria ndaj personave që humbasin nuk mund zëvendësohet me asnjë dashuri tjetër. Kështu kish ndodhur besoj edhe me atë të babait tim, të cilin e doja, por kurrë s'dija se si ta doja. Në një mënyrë aksidentale u gjenda në duart e një jete plot emocione dhe halucinacione, por që më dukej se dita-ditës do të më bënte më të fortë, do të ndihesha më e rritur apo më afër preokupimeve të të rriturve dhe ta gjeja vetë mënyrën për t'i bërë ballë çasteve mistike që aty-këtu shfaqen para gjithkujt, pa marre parasysh moshën.

Çdo ditë do të dilja me nënën dhe do të prisja autobusin e shkollës. Pasditeve do të kthehesha e vetme dhe, sipas porosisë së nënës, shoferi i mikrobusit, një burrë i thinjur dhe i shëndoshtë, i quajtur Vini, do të më merrte për dore do më ndihmonte të zbrisja dhe do të më përcillte gjer në prag të shtëpisë dhe do të largohej vetëm atëherë kur të sigurohej që unë kisha hyrë brenda.

Katër ditë në javë, pasditesh, do të vinte mësues Xhakelini dhe, për dy orë, me të do ngjallja mrekullitë. Shumë shpejt do të mësoja t'i bija kitarës dhe në piano do të përparoja ndërsa ai do të më ndihmonte të kapja ca nota zanore të cilat më vonë do të më duheshin për kanto. Ai shprehej gjithnjë edhe para prindërve të mi, se unë kisha një zë shumë të bukur, ku ai vinte re ca zanore të veçanta, të cilat mund të kishin të bënin me famën time të ardhshme.

Një të martë, mësues Xhakelini më tha, se do të organizohej një koncert, i cili do të zhvillohej në një nga teatrot me të rëndësishme të Los Anxhelosit. Ai kish marrë nga një kantautor për fëmijë, një këngë të zgjedhur me bindjen që unë do të kisha rezultat meqenëse

sipas tij i përshtatej për së miri zërit tim. Në atë koncert do të merrnin pjesë mijëra spektatorë dhe, ndër të tjera, që sipas tij do ish më e rëndësishmja, do të merrnin pjesë edhe kritikë dhe çmues të muzikës kaliforniane dhe të ftuar nga shtete të tjera si nga Nju-Jorku, nga Bostoni, Teksasi, Uashingtoni etj.

Unë e mora me zell mësimin e këngës, megjithëse përveç ndihmës së mësuesit Xhakelinit asgjë tjetër s'do më inkurajonte. Nëna, që do ish pa dyshim një ndër pikat më të devotshme do të tërhiqej mjaft nga aktiviteti im. Ajo do të ndodhej përherë e më shumë pro burrit të saj, fjalën e të cilit do ta konsideronte me shumë si ligjin e saj. Kohët e fundit, prania e Xhek Shellit në shtëpi, do të bëhej permanente, e pandërprerë, meqë ai i kish mbushur orët e tij të lundrimit dhe, për kohën tjetër të mbetur, e kishin caktuar me një punë të re si shef të një firme mirëmbajtjeje të një porti mallrash në juglindje të qytetit.

Kur nëna do ta merrte vesh vendimin dhe bindjen e mësues Xhakelinit, do e përgëzonte, por kurrë s'arrita të kuptoj pse unë s'do të vija re tek ajo atë interesin e posaçëm e entuziast që ajo gjithnjë e shpallte pa kursim, kur bëhej fjala për të ardhmen time dhe për talentin tim. Përse kjo ftohtësinë? Ku e kishte burimin? Ndërkohë që babai im i mirë, Xhek Shelli, do të fillonte të më rrinte më pranë. Ai herë pas here do të fliste me mësues Xhakelinin, për të ardhmen time të muzikës, për detyrimet dhe për mangësitë, për kushtet dhe për pagesat, për bindjet e tija në lidhje me punën time dhe ritmet me të cilat unë përparoja çdo ditë. Ai filloi të me rrinte edhe më pranë dhe, shpeshherë, më pyeste për gjëra të ndryshme, të cilat kishin të bënin më shumë me ndryshimet e përparimin tim në fushën e muzikës. Unë i përgjigjesha shpejt dhe saktë, ndërsa ai rrihte shuplakat e tij të mëdha.

Një të diele, kur ngelem të vetme unë dhe nëna, meqë Xhek Shellin e kishin thirrur për një emergjencë, për diçka që kish vënë në rrezik ca mallra të shtrenjta, të cilat kishin të bënin direkt me ekonominë e shtetit, ajo më thirri në sallonin e katit të dytë të shtëpisë dhe më dhuroi një vello ngjyrë rozë të çelët. Ma theksoi se ma kish blerë natën e kaluar, për ta veshur ditën e koncertit. E mora dhe e ngjesha pas trupit dhe dola para pasqyrës që ish vendosur pranë dritares, e

cila shikonte jashtë në ballë të shtëpisë. Ngela me sy hapur, ish një mrekulli e vërtetë.

Por ky s'ish sekret i vetëm që nëna do të më tregonte, ish diçka tjetër më tronditëse, e cila do të më gëzonte më shumë se fustani.

- Ti tashmë je rritur bijë, dhe kupton më shumë se sa unë, mund të vlerësoj. Do të të tregoj një të fshehtë, por më parë duhet të më japësh fjalën se s'do të ushqehesh nga asnjë ndjenjë xhelozie, se zemra jote e pastër s'do të tradhtojë mendimet, sepse ti je shumë e shtrenjtë për mua. Ti e di këtë.

- Edhe ti je shumë e shtrenjtë për mua mami, - i thashë dhe përkëdhela flokët e saj të rrelta.

Ajo me puthi lehtë në buzë.

- Atëherë premtomë që do të lumturohesh ashtu si jot ëmë.

- Të premtoj nënë, se do te lumturohem njësoj si ti, - ia ktheva pa pritur që ajo të mbaronte mirë fjalën si të përsërisja me korrektësi një formulë.

- Pas pak muajsh s'do ndihesh më e vetme, nëna do të dhurojë një vëlla, oose një motër, - ma priti.

U mendova për një çast si e shtangur për të arritur shtjellimin e atyre fjalëve, sakaq ia ngula sytë në pjesën e barkut meqë kisha dëgjuar nga disa shoqe të shkollës se nënat e tyre i mbanin fëmijët në bark. S'arrita të dalloj asgjë të veçantë. Iu hodha në qafë dhe e putha.

- Dua një motër, - i thashë.

Ajo zuri të fshinte lotët dhe të më shtrëngonte lehtë e më lehtë në gjirin e saj që dridhej nga emocionet.

Lajmi për motrën e ardhshme më ndihmoi të harroja vetminë dhe të fantazoja ëndrra të tjera, të nëpërmendja lojërat e dikurshme, të cilat s'i zija më me dorë. Ato zura t'i gjeja, nëpër ahurin e shtëpisë dhe ndër komodinat e mëdha dhe, pasi i pastroja me kujdes, i vija në një dollap prej druri ku rrinin dhe dhuratat e mia më të reja. Zura të këndoja më me zell dhe gjithnjë isha më e lumtur. Nënë e shihja tek më vështronte sa herë më një sy pyetës, sikur donte të më thoshte "Sa je rritur?" Më qeshte më shumë dhe dallonte ndryshimet e mia prej motre.

Xhek Shelli ish një njeri i përkryer. Unë shihja se si e donte nënën time, se si e respektonte dhe e adhuronte. Tek ai s'njihej asnjë fjalë e rëndë fyese apo gjaknxehësi siç më tregonte nëna për tim at. Ai përkonte me imazhin tim të një njeriu të zellshëm familjar dhe fisnik.

Një të diele, më mori në telefon Lizbeth. Isha e vetme në shtëpi, pasi nëna me Xhekin kishin dalë të psonisnin për beben dhe fola gjatë me të. Dikur ajo zuri të qante dhe unë s'munda ta mbaj dot ngashërimin. Të dyja qanim në linjat e telefonit dhe, pauzat e gjata, vuanin ndër muzikalitetin e dihatjes.

- Më mungon shumë, - më tha dikur Lizbeth.

- Edhe ti mua më mungon shumë, - i thashë dhe vaji për të dyja s'kish të pushuar.

Kur dera trokiti i thashë, se duhej ta lija.

- Kam dëshirë të të shoh, - më tha se fundmi.

- Dhe unë sa do të doja, - ia ktheva dhe m'u desh ta mbyllja receptorin. Fshiva lotët dhe hapa portën pasi njoha zërin e nënës.

Ajo më pa me sy të skuqur dhe unë i kërkova të hynte në dhomën time. U mbështeta pas komodinës, ndërsa ajo u ul me kujdes në gjunjë duke lëshuar një ofshamë të lehtë. Mora dorën e saj me të dy duart e mia dhe e pashë drejt e në sy. Sytë e mi u mbushën me lot dëshpërimi. I tregova për gjithë bisedën, që kisha bërë në telefon me Lizbeth. Në fund i thashë.

- Nuk mund të gjendet asnjë farë mundësie që ajo të kthehet në gjirin e familjes sonë?!

- Mund të shohim, - më tha dhe, me një shami bardhë me thekë të qëndisura, që nxori nga borseti prej lëkure elefanti, me fshiu lotët.

- Po kur? - e pyeta gjithë ankth.

Zëri i Xhekit erdhi nga poshtë dhe ajo pa më kthyer përgjigje u ngut të dilte.

Pas tri ditësh fola prapë me Lizbeth. Ajo ish kujtuar për shtatëvjetorin tim dhe, me mori, të ma uronte. Me pyeti gjithashtu për mbarëvajtjen e shkollës. Dhe të muzikës.

I thashë, se nënës i pëlqente, që ajo të kthehej prapë mes nesh dhe, sapo të dija diçka më me vlerë a më konkrete, do e njoftoja

menjëherë. Ajo më falënderoi dhe duke më dërguar të puthurat e saj nëpërmjet telefonit. Më la, duke ma përsëritur: - Më mungon shumë vogëlushe!

Me Lizbeth kisha kaluar një jetë të tërë, me të kisha ndarë lojërat, qarjet dhe llastimet e mia, me të kisha mposhtur vetminë, kur nëna shkante me punë dhe, për ditë e net të tëra nuk kthehej, më të kisha ndarë sekretet e vegjëlisë për fajet që m'i fshihte duke mos i treguar nënës. Ajo më kish mësuar se si të flisja në mënyrën më të përsosur me njerëzit, si t'i respektoja të mëdhenjtë dhe si t'i falënderoja ata që më donin. Nga ajo kisha mësuar të gjitha përrallat dhe historitë, që dija në lidhje me njerëzit kafshët, shpendët dhe natyrën. Ajo kish qenë mësuesja ime e parë; dora e saj më kish shërbyer për vite me radhë, duke u kujdesur për mua si një nënë e vërtetë.

Mallkoja atë drejtë që i kish futur në mendje Xhek Shellit dhe nënës sime, se ajo ish e shëmtuar dhe pise. Mallkoja ato që mund ta urrenin atë grua të pastër, të zgjuar dhe bujare. Sillja nëpër mend duart e saj, që më vinin të flija dhe më gudulisnin lehtë para gjumit. Zërin e saj prej të cilit unë për herë të parë kisha mësuar të këndoja. Këngët e para që e shpotisja, duke rendur pas me gjysma fjalësh.

Ajo kish një durim të vërtetë dhe, me gjithë marrëzitë e mia të panumërta, kurrë s'e mbaja mend të vrenjtur. Ajo dinte vetëm të qeshte dhe, shpirti i saj dhe sytë e saj, s'dinin të shprehnin tjetër veç alegrisë.

Instinkti për ta dashur atë shërbëtore me besniken e botës s'më shqitej, ish ankthi im dhe dëshira e saj që m'u ngulitën në tru dhe të këmbëngulja gjersa ajo të kthehej prapë në gjirin tonë.

E kuptoja më së miri se Xhek Shelli e urrente. Nuk arrija ta gjeja përsenë. Xhek Shelli kish prejardhje irlandeze dhe, mbase, mund të urrente ngjyrën e lëkurës së saj. Unë e pëlqeja Lizbethin dhe gjithnjë e mbaja mend si të pastër. Xhek Shelli, pa asnjë të drejtë, e shante dhe e përbuzte. Ajo gjithnjë më parë kish gëzuar të drejtat që gëzonim dhe në shtëpinë tonë.

Një nate zura të qaja meqë më mungonin ledhatimet e saj. Thirra nënën, por ajo s'më dëgjoi, ndërsa nga dhoma e saj ku flinte me Xhek

Shellin vinin ca hungërima të thella dhe të largëta. S'kuptoja asgjë veçse ndieja mungesën e një dorë të butë dhe praninë e Lizbethit, e cila do të mund të ndërronte netët e mia, pasi ato, gjithnjë e më shumë, përfshiheshin nga një hipnozë e trishtë dhe e pangushllimtë.

Kaluan disa javë dhe netët e mia bëheshin më shumë të trishta. Kish nga ato net, kur pagjumësia shtrihej gjer në atë pikë, saqë s'ndieja më nevojën e gjumit. Atëherë më dukej vetja si një krijese e mbinatyrshme dhe më kujtohej një përrallë e Lizbethit për Niagarën, vajzën afrikane që s'flinte kurrë vetëm shëtiste në të gjithë planetin, për të ndihmuar njerëzinë.

Po unë kë mund të ndihmoja kur isha e bindur se s'mund të ndihmoja dot as veten?

## 10

Ai që arriti të hulumtonte i pari ndryshimin tim ish mësues Xhakelini, i cili menjëherë ia vuri në dukje këtë mangësi timen, nënës, një të hënë pasdite.

- Vajza juaj nuk është fort mirë, zonje..

Ai mendonte se unë s'po e dëgjoja që nga shkallët e katit të dytë, ku u ngjita të merrja kitarën e re që ma kish blerë Xhek Shelli të enjten e shkuar, kur ish kthyer nga Meksika e re.

- Diçka më ka rënë në sy edhe mua, mësues, - ia ktheu nëna. - Po ngase mendoni që mund ta ketë.

- Mendoj, se më mirë mund të ta thotë ajo vetë, ose mjeku i saj.

- Ju mendoni se ajo mund të jetë e sëmurë. Dhe pra nuk ankohet asnjëherë. Faleminderit Zotit nga oreksi s'më duket keq. Edhe pse në shkollë s'e di nëse ha ato gjëra që i porosis.

- Unë vë re heqjen e saj dhe zërin e saj të ngjirur zonjë. Mendoj se duhet të merreni pak më shumë me të, pa lënë mënjanë as problemet e tjera që kini. Kuptoj, se ju keni mjaft gjëra për të bërë, - ndërkohë unë e pashë mësuesin që hodhi vështrimin tek pjesa e barkut të nënës dhe vazhdoi- pastaj dhe burrin tuaj, punën që bëni etj, por mendoj, zonjë dhe, duhet të më falni për ndërhyrjen time kaq thellë në situatat tuaja, - Mësues Xhakelini u përkul paksa para nënës në shenjë mirësjelljeje, - vetëm dua t'ju kujtoj se një nga gjërat më të rëndësishme të jetës suaj është bija juaj. Mos harroni, se me pakëz kujdes, më shumë, ajo nesër mund të jetë një perlë. Jam i sigurt për këtë. Mendoj se diçka shpirtërore e bën të vuajë vajzën tuaj, zonjë, se çfarë, ju vetë mund ta gjeni. Dhe mësuesi, ashtu si një psikolog i zoti e me përvojë kish arritur t'i binte pikës me intuitën e tij. -



Mendoj se është vetmia, zonjë, ajo që bren dalëngadalë bukurinë dhe talentin e vajzës suaj.

Sesi më përshkoi befas një valë shprese, andej nga s'e kisha pritur. Ish e vërtetë gjithçka po i thoshte. Mësues Xhakelini fliste sikur e kish jetuar bashkë me mua çdo çast të jetës sime.

- Do mundohem të flas me të dhe të blej gjithçka mundem nga goja e saj dhe do bëj të pamundurën, që ajo të rritet siç duhet dhe të përparojë në mënyrën më të përsosur. Sigurisht që duhet të pranoni falënderimet e mia më të përzemërta, mësues Xhakelin, dhe... ndërkohë unë kisha zbritur poshtë nga shkallët. Shikimi i saj i ndezur u ndesh me shikimin tim të mprehur, ja dhe pse u mundua të ndërronte bisedën me mësuesin: - Thomëni, mësues Xhakelin, me të vërtetë bija ime mund të bëhet një perlë e muzikës amerikane? - Nëna shtriu duart e saj dhe më përmbodhi duke më puthur në buzë dhe pastaj në ballë. - Edhe unë kam një bindje të tillë, për vajzën time. Ajo do të jetë një yll në këtë bote dhe unë do jem për të gjithnjë krenare. Shih, shih a s'ju duket edhe juve që është një krijesë jo vetëm e vyer por edhe hyjnore?!

Mësuesi qeshi dhe, ashtu me buzën në gaz, theksoi:

- Kam bindjen e plotë, zonjë, se ajo kurrë s'do të na zhgënjë!

Unë i shtriva kitarën mësues Xhakelinit dhe, ai pasi shprehu habinë e tij, duke e parë me kureshtje, zuri ta akordonte, ndërsa ime më, shkoi t'i sillte diçka të ftohtë për të pirë.

Gjer vonë atë natë e kalova, duke kënduar në prezencën e nënës, me përjashtim të kohës, që ajo ngiste në kuzhinë, për të përgatitur gjellët e darkës.

Mësues Xhakelini darkoi me ne. Xhek Shelli atë natë do të mungonte, por kjo s'na pengoi t'ia kalonim mirë dhe plot hare.

Unë këndova, për herë të fundit këngën e re me të cilën do të prezantohesha në festival dhe atëherë mësues Xhakelini u bë gati të dilte. Nuk harroi së fundmi të më përqafonte dhe, kur i dha dorën e lamtumirës nënës, i bëri me kokë dhe me sy njëherësh nga unë. Meqë shikimi i tij u pleks në shikimin tim përçmues, e mori me qeshje dhe i dha fund takimit.

- Nesër do kemi një leksion të ri.

E ndoqëm me sy sa i hipi makinës së vjetër dhe gjersa projektorët morën kthesën përtej fushës me portokaj, ku mbaronte shtëpia e Rrokfelerëve.

Kur ngelëm të vetme, për herë të parë pas gjithë asaj kohe, nëna më mori me vete në dhomën e saj dhe zuri t'i shtrohej bisedës me mua, pa e lënë të ftohej këshilla e mësuesit.

- Hë, bija ime, - ia nisi, - më thuaj ekzakt, ç'është ajo që më shumë e mundon yllin tim.

- Ndihem e vetme, - ia këputa me një zë të prerë, - dhe ia ngula sytë, si t'i thosha: "Ti je vetë zgjidhja!"

Nisi të qeshë disi e brengosur pasi e nuhati se ç'hall kisha. E pashë qartë brengën tek rrëshqiti nga sytë e saj dhe iu derdh nëpër fytyrë, duke bërë buzët e saj të dridheshin. U ngrit, më zuri me duar gati pa fuqi dhe më ndihmoi të ulesha në poltronën me pupin ngjyrë bezhë, ndërsa vetë u përgjunj para këmbëve të mia dhe shtriu duart duke më shtrënguar në gjoks.

- Ylli im. Ti e di që unë të dua sa ç'dua dritën e syve të mi, madje më shumë. Jeta ime je ti dhe e vetmja kënaqësi, më e shtrenjta e jetës sime.

- Po Xhek Shelli? - e ndërpreva. - Mos vallë nuk është dhe ai i shtrenjtë për ty mama?!

- Oh, bija ime, s'prisja këto fjalë të dilnin nga mendja jote e vogël. Dalëngadalë po e besoj që je rritur. - Me përkëdheli në gushë dhe, me duar zuri faqet e mia, m'u afrua dhe buzët e saj m'u ngjeshën me forcë në vallë; u shkëput me ngadalë dhe, pa shkuar në pozicionin e mëparshëm, u shpjegua: - Si të them, si...? Ashtu është gjer në një farë caku, por është një shkak tjetër, që në një farë mënyre, e bën dhe atë të shtrenjtë për mua.

- Më të shtrenjtë se mua?!

Kësaj radhe ajo ia plasi së qeshurës me britma dhe pasi më hodhi një rrëke puthjesh shtoi:

- Joo, asnjëherë s'e kam menduar këtë! Ti sigurisht je më e shtrenjtë, por si të thuash, je akoma e vogël, bija ime, t'i kuptosh disa gjëra.

- Cilat gjëra? - e ndërpreva saora.

- Phhhhhh, mmmmm, cilat? Ja, që në familje, gjithkush ka rëndësinë e tij dhe familja jonë ka tre pjesëtarë: është Xhek, je ti edhe unë, më vone do të kemi edhe motrën, të cilën ti do ta duash më shumë se askënd.

Qesha ngaqë s'munda ta mbaj gëzimin që më përshkoi mbasi pata ndjesinë se ajo, motra që do të lindte, tashmë ishte aty dhe po dëgjonte njësoj si unë. U ndjeva e gëzuar dhe,ajo, te cilën unë më parë e quaja vetmi sikur më braktisi dhe e ndjeva vehten të lumtur mes njerëzish të shtrenjtë.

- Të dua nënë! - i thashë, - më shumë se gjithçka!

- Edhe unë, bija ime, të dua më shumë se gjithçka!

- Që unë të ndihem më mirë kur ty s'të kam pranë do të doja të kisha pranë Lizbeth, - s'ngurrova dhe ia hapa zemrën. Çast më të mirë nuk kisha. Kisha gjithçka po doja dhe Lizbeth. - Ma jep fjalën se do të flasësh me babanë dhe do të bësh të pamundurën që ajo të rikthehet përsëri në gjirin e familjes sonë?

- Sigurisht, bija ime, që do të bëj gjithçka, që ajo të kthehet meqë ti e do kaq shumë, megjithëse nuk arrij të kuptoj se ç'është ajo krisje që e bën atë grua aq të rëndësishme për ty.

- Prej saj kam mësuar shumë gjëra të bukura dhe prisja të mësoja të tjera, të cilat nuk m'i mësoni ju të tjerët.

Një hije e prerë i ra në fytyrë nënës sime, atë çast.

- Sepse ti e sheh, bija ime, se unë jam shumë e zënë, ndërsa yt atë gjithashtu, s'ka kohë të lirë, sido të jetë do të marrim në konsideratë huqet tuaja, më fal mendimet tuaja, - arriti të korrigjonte, - dhe të drejtat tuaja. Ndërkohë që do ta zgjidhim këtë problem ne formën më të drejtë, këtë do ta bëjmë vetëm për ty bija ime, në mënyrë që ti të mund të përparosh dhe të gëzosh atë jetë që meriton.

- Nganjëherë ndihem shumë keq, - i thashë dhe e shikova me një shenjë lutjeje, - shumë keq, shume keq.

- Ngase? Ç'është ajo ndjenjë e djallëzuar që guxon të nxijë orët feminare të yllshës sime, për të cilën unë do i kundërvihem me tërë shpirtin.

- Kam një si frikë, nënë, kur jam e vetme, shtëpia, nata, rruga, koha, vetmia, trishtimi, hija, drita, janë të gjitha, që më brejnë në

brendësi, kur me të vërtetë jam e vetme në këtë shtëpi. Ty të dua gjithnjë pranë, nënë, - iu luta dhe i putha duart që m'i kish vënë në prehër.

- Duhet të jesh gjithnjë e qetë, bije ime dhe të mendosh, për të ardhmen tënde të ndritur, lirisht të ndihesh e lirë, të këndosh dhe të dëflesh, të ushqehesh me frymën e haresë në këtë jetë dhe të zhdukesh tutje brerëzat e trishtimit prej të cilave kurrë, askush, s'ka fituar tjetër veç marrëzive.

- Por si t'ia bëj, që gjithsesi ndihem e vetme dhe jam e frikësuar. Kur jam vetëm, në çdo moment, rroj gjithnjë me shikimin nga porta, duke pritur, që ajo të hapet dhe të më shfaqet ndonjë fantazmë, që mund të më bëjë diçka të keqe.

- Oh, bijë, këto janë vetëm ëndrra të çmendura fëmijësh, janë parandjenja që nuk zbulojnë asgjë veçse tallen me besimin tënd të lëkundur. Ne këtu nuk jemi të vetme, edhe pse jemi femra. Ne jemi të mbrojtura nga Xhek Shelli, ti e ke parë se sa i fuqishëm është ai dhe mund të shtrije për tokë çdo djall dhe hije, ashtu siç ka bërë sa herë me fantazmat e detit, kur në befasi e kanë sulmuar. Ja dhe pse unë zgjodha që yt atë të ish marinar i sprovuar...

Mbaj mend gjer në këtë pikë, mbaj mend se e besova çdo fjalë të saj dhe frika m'u shkëput si një kafshim, që s'lë dhimbje në asnjë pjesë e trupit. Mbaj mend, se gjithsesi ia kujtova emrin e Lizbeth dhe se fundmi mbylla sytë pasi mora premtimin e saj dhe një tjetër të puthur të lehtë në buzë.

Duart e saj më ngritën dhe më çuan në dhomën time, ku fjeta gjer të nesërmen pa parë asnjë ëndërr të frikshme, ashtu siç me kish ndodhur net të tjera me rrallë.

U ndjeva e sigurt pas bisedës me nënën. Fjalët e saj më shërbenin si mbrojtje, ato ishin ilaçi i shërimit përgjatë netëve të qeta, kur agonia e heshtjes brente ëndrrën e ditës dhe formonte një kauzë boshësie aq të ftohtë saqë trupi im drithërohej. Kisha megjithatë një si frikë të cilën s'mund ta eliminoja me asgjë, ish një skëterrë e vërtetë dhe, ngjyra e verdhte, që shpesh më shfaqej, kur mbyllja sytë, zinte të më braktiste ndërkohë që gjumi më merrte në labirintet e tij pas një lodhjeje të gjatë, kur mendimet ngopeshin dhe s'gjenin më

asnjë fare kuptimi, kur sytë e lodhur donin të gjenin mbështetje jo më tek mëshira e gjumit, por te mëkati i kujtimit të frikshëm, që më rrihte mendjen gjithë natën.

Fjalët e saj, megjithatë më ndihmonin. Ne, fundja nuk ishim të vetme si dikur, edhe pse me Lizbeth nganjëherë trembeshim. Kjo ndodhte netëve me erë dhe furtunë, kur nëna siguronte mirë portën e hekurt të oborrit dhe portës së shtëpisë. Pasi rrotullonte çelësin gjer në fund, i hidhte gjithashtu dhe siguresën. Prapë edhe ashtu, pas gjithë atyre veprimeve, sytë e saj s'mund ta fshihnin gjithë frikën, që i përmbushnin legendat e netëve plot furtunë, megjithëse shikimit tim të habitshëm i dhuronin një buzëqeshje të trishtë, që ajo vetë kurrë s'do ta besonte që unë vite më vonë do të nxirrja në pah mësimet e mia mbi atë të qeshur të shkurtër dhe që fshihte pas saj shenja tmerri dhe frike.

“Çfarë mund të presësh nga guximi i shterpët i tri femrave?”, shprehej nëna kur ish koha e uraganeve.

Ne, pra, s'ishim më të vetme, gra të pafuqishme dhe delikate, gra duarlakuar dhe pa forcë, gra pa fat dhe të braktisura nga forca mashkullore, ne kishim në gjirin tonë të fuqishmin Xhek Shell, i cili do të na mbronte gjer në vdekje, ashtu siç mbron shqiponja gjahun e saj.

## 11

Nata e koncertit po afrohej. Çdo ditë e më shumë merrja pikët e mundshme nga mësues Xhakelini. Kur arrija pikët më të larta i qeshnin sytë e larë pas syzeve me xhama të trashë. Kohët e fundit kish bërë ca ndryshime në tekstin dhe muzikën e këngës sime. Në të njëjtën kohë shpresonte në suksesin e një mënyre të re që dikush ia kishte shtënë në mendje me të cilën atij do t'i rritej hovshëm fama, ndërsa unë do kisha rastin të bëhesha e njohur.

Gjithnjë e më shumë fitoja liri e terren në mënyrën e të shprehurit dhe të interpretuarit. Duartrokitjet e tij me do ushtonin pas çdo prove dhe fjalët më të bukura do të derdheshin në të gjithë skajet e shtëpisë.

Atë që ai po kërkonte po e mbërrinte, ndërsa unë po vija në vend ëndrrën time dhe të sime mëje, e cila ngrohej e bëhej me flatra me fjalët e mësuesit dhe më merrte me kënaqësi në krahë dhe më mbulonte me të puthura.

Ishin pasdite të bukura, të cilat gjithsesi do të ngelnin të pashlyeshme, për gjithë kusurin e jetës sime. Kur mbaronim herët dhe mësues Xhakelini ish me, se i kënaqur,do me merrte me vete në një nga teatrot me më famë të Los Anxhelosit, të quajtur Teatri Kinez, ku unë do kisha rastin të ndeshesha sy për sy me aktore të njohur dhe të tjerë, që fama i kish ngritur në qiell. Herë-herë do më shpinte në disa stacione të njohura radioje dhe televizioni. Ai, në mënyrën më të përkryer, hollësisht, siç tregon tregimtari një legendë, do më vinte në dijeni deri në detaje, të cilat ose i dëgjoja për herë të parë, ose nuk do të kisha rast tjetër t'i njihja më mirë për shumë ndryshime në teknologjinë e reja të artit dhe truket e

panumërta të tij, kallëzime të cilat do të zgjeronin horizontin e botës sime adoleshente.

Mekanizma të tëra do më tërhiqnin dhe kënaqësia do më mbërthente për t'u bërë edhe unë personazh i atyre legjendave një ditë.

Një tjetër lloj argëtimi do ish akoma me fashinant. Ai do më përcillte pa ma lëshuar dorën, si mbesën e tij të artë, siç më thërriste mes të tjerësh, nëpër kopshtin zoologjik, ku vitet e fundit ish pasuruar koleksioni me kafshë të sapozbuluara e të sjella nga Afrika, nga Azia dhe nga ca vende të ftohta, te cilëve unë s'arrija t'i ngulisja në kujtesë emrat e tyre të ngatërruar.

Nganjëherë ai do më shoqëronte edhe nëpër cirkun më të ri të fëmijëve, por aty s'do të përshtatesha me të gjitha mrekullitë që shihja edhe pse aty shkonin me qindra fëmijë të moshës sime. Gjithsesi edhe pse ish shumë bukur s'arrija dot të argëtohesha siç mund të argëtohet çdo fëmijë. Ëndrrat e mia më dërgonin në një tjetër kreshtë, atje ku rrinin të mëdhenjtë, atje ku mirësia, dituria dhe bota shihen me një sy të argjendtë, me një sy zhbirues, kërsëror dhe kërkues. Asgjë e thjeshtë dhe e zakonshme, rutinore s'do të mbushte minutat e jetës sime të asaj kohe.

Sidoqë të jetë, natyra e tij s'ish të më pyeste se për ku kisha dëshirë të drejtoheshim. Ja dhe pse unë e merrja seriozisht dhe me mirësjellje çdo ambient në të cilin ai më dërgonte.

Koha do shkurtohej dhe vetëm një javë do të na ndante nga koncerti.

Në mëngjesin e të premtes, nëna më zgjoi pak më herët. E pashë me sytë e përplotur tek më sodiste ndërsa unë ende po seleksionoja dhe hiqja nga kujtesa ca ëndrra pa kuptim, që më kishin shoqëruar gjatë gjumit të fundit. Një muzikë harmonike e lehtë vinte që nga jashtë në salón. Ish pikërisht kënga ime të cilën që prej tre ditësh mësues Xhakelini e kish incizuar në kasetë.

- Të pëlqen? - e pyeta.

- Je e mrekullueshme, - m'u përgjigj. - Thashë të mos ikja pa e dëgjuar, se s'di nëse do të jem e pranishme në provat e para të shfaqjes që fillon sot.

- Pse, ku do ikësh?

- Më kanë thirrur ata të filmit në Miami. Do xhirojnë një skenë të re dhe një të vjetër do ta përforcojnë me disa personazhe të tjera. Të gjithë kanë shkuar që mbrëmë, vetëm unë ngela dhe më duhet të nisem me avionin e orës tetë.

- Kështu qenka puna?! Po unë si do bëj pa ty, nënë? Do kem frikë, e di?!

- Nga se do kesh frikë? Këtu është yt atë dhe mësues Xhakelini do të të gjendet. Në prova do shkosh me mësues Xhakelinin ndërsa Xheki do të të marrë pasditeve.

- Nënë kam frikë! - ngula këmbë. - Pse s'u bë gjë për Lizbethin?

- Oh, vogëlushja ime, tani s'kam kohë të merrem me këto gjëra, do të flasim, kur të kthehem do ta rregullojmë edhe atë punë. Më shtrengoi fort sikur të linte edhe forcën e saj në mua. Më puthi në faqe dhe në ballë, pastaj më zbuloi të ndenjturën e djathtë dhe ma kafshoi ashtu sikur bënte sa herë kur bisedat e mia i dukeshin marrëzira. - Dhe dëgjo, më këshilloi, - kujdes me provat dhe të vishesh mirë. Mos harro të kuqtë e vezëve çdo mëngjes dhe çajin mos e pi shumë të ngrohtë, vetëm të vakët. Dhe sot ta bëra unë, - dhe më bëri me gisht drejt tavolinës ku më kish lënë të shtruar mëngjesin, - që nesër do të ta përgatiste vetë Xheki. Kam folur me të për gjithçka edhe pse sot ai ka dalë që pa gdhirë sepse ka një anije me defekt në port.

Ndërsa ajo më fliste e nxituar sytë me shkuan tek barku i saj që për të parën herë arrita të dalloj se ish i fryrë. Kohët e fundit as në dhomën e tyre s'dëgjoreshin me kërcëllimat as britmat e saj të çmendura. Desha t'i thosha që të kishte kujdes për vogëlushen, motrën time të ardhshme, por s'arrita t'i flisja më, veçse sodita e mallëngjyer siluetën e saj që u zhduk nëpër mjegull.



## 12

Një hije vetmie më pllakosi ndërsa me zor luajta nga vendi, ku ajo më la si të braktisur. Ndihesha disi e turbulluar dhe një frikë e panjohur me një intensitet edhe më të madh sikur më kafshonte pak nga pak gjer sa më hynte thellë në zemër.

Autobusi i shkollës erdhi dy minuta më herët se zakonisht. Unë pashë orën dhe dola jashtë. Isha veshur me të gjitha siç duhej përjashto kapuçit ngjyrë lil që e kisha vënë me xhufka përpara. Një shoqe imja me të cilën shpesh qaja halle Liset me rregulloi kapuçin dhe zuri të më pyeste për koncertin.

Gjithë dita më shkoi mes një ndrojtjeje të pakuptueshme, mpirjeje e hutimi. Në orën e matematikës, i shpreha Lisetit shqetësimin tim dhe ajo u tregua e gatshme, për të më ndihmuar.

- Do flas me mamanë dhe besoj se do më japë leje që të fle sonte në shtëpinë tënde. Po deshe hajde ti në shtëpinë time.

- Unë s'mundem sepse kthehem vonë nga provat.

- Atëherë po vij unë me ty.

Nëna e Lisetit erdhi menjëherë sapo e bija e mori në telefon duke i thënë se çështja ime ish shumë terrorizuese. Ajo ish një zonjë pak e moshuar krahasuar me nënën time, por tepër e dashur dhe me tipare të bukura. Kur ajo mori vesh për shqetësimin tonë, të cilin Liset ia tha, kur të tria ishim te ulura në stolin e drunjte të lulishtes përballë shkollës, ajo u gajtas së qeshuri dhe s'e la pa i treguar të shoqit, i cili sapo kish parkuar makinën dhe erdhi drejt nesh me një frymë. Pastaj u kthye nga unë dhe më tha:

- Dhe unë time bijë e kam lënë sa herë të vetme me të atin kur udhëtoja për në veri dhe në Kanada, por ajo kurrë s'kishte frikë. Yt at ka shkuar dhe ai?

- Ju e keni fjalën për Xhek Shellin, burrin e nënës sime? - e pyeta me mendje të lëshuar.

- Po, - më tha, - për tët at. - Ajo vuri buzën në gaz, duke ia hedhur sytë të shoqit.

- Jo ai s'ka shkuar me mamanë, - i thashë e singertë.

- Atëherë ti s'qenke e vetme pse duhet të kesh frikë. - Pastaj duke më përkëdhelur me dorën e djathtë shtoi: - Dëgjo, bija ime, përrallat që ju tregojmë s'janë asgjë tjetër veçse histori të thëna kot së koti ku personazhet e tyre kurrë s'kanë ekzistuar. Çdo prind i vë në punë përrallat për të ngulitur në mendjen e fëmijës së tij një farë frike që fëmija t'i bindet dikujt jo sepse me të vërtetë ekzistojnë sot në botë bëmat përralore. Prandaj s'duhet të kesh frikë nga asgjë. Ne jemi të rrethuar vetëm nga njerëz të mirë. Liseti të ka treguar besoj se sa herë ka kaluar net të tëra e vetme madje edhe pa të atin. Ja, tani do shkojmë në shtëpi, unë do ju shtroj drekë, se besoj jeni të uritura dhe pastaj do të telefonojmë tët atë që të kalojë nga shtëpia jonë dhe të të marrë me vete.

- Unë duhet të shkoj me mësues Xhakelinin, - i thashë, ndërkohë Liseti na ndërpreu duke i treguar prindërve për koncertin, ku do të merrja pjesë dhe unë, si dhe i bëri të ditur që unë isha një pretendente për të fituar.

Nëna e saj gati sa s'shqyente sytë nga mirësia.

Pasi hëngrëm, i ati mori në telefon mësues Xhakelinin dhe, pa u bërë gjysmë ore, mësuesi u duk me makinën e tije të jeshiltë. Dhe të dy morëm rrugën për nga qendra e qytetit.

Askush s'po e kuptonte frikën time. Disa herë u mata të flisja edhe me mësues Xhakelinin, por frika që edhe ai s'do të më kuptonte si të tjerët ma mbyllte gojën.

Salla oshtiu më shumë se herët e tjera. Dhjetëra duar, që përplaseshin frenetakisht formuan një zhurmë më të egër se të zakonshme. Zëra pëshpëritës e brohoritës u përzenë dhe, kur dola në skenë për t'i përshëndetur sipas zakonisht, thirrjet me sollën një fjollë turpërimi.

Dritat e forta të projektorëve s'më linin të shihja mirë gjer në thellësi të sallës, por ajo ç'ka më zuri syri mirë, ish e sigurt fytyra e njohur e Xhek Shellit. Një rrëqethje më përshkonte ndërsa filloi muzika. U kujtova se nga e papritura, që m'u shfaq harrova dhe të përkulesha për të përshëndetur spektatorët, këtë gjest sipas porosisë të drejtuesit të skenës zotit Robert Hilfinger, duhet ta mbaja në kujtesë dhe të mos e humbisja toruan asnjëherë, në asnjë provë dhe, sidomos, në provën gjenerale dhe natën e koncertit. Sido që të ishte ato dhjetëra të pranishëm ishin një publik i thjeshtë dhe jo përcaktues; ishin të gjithë pjesëtarë të familjeve të këngëtarëve, që do të merrnin pjesë në koncert si dhe ndonjë dashamirës apo mësues.

Në rreshtin e parë vetëm tre vende në të djathtë të Xhek Shellit, rrinte me sytë e ngulur plot kureshtje nga unë, mësues Xhakelini.

Pas një pauze prej pesë sekondash, e shoqëruar vetëm nga tingujt e hollë të violinës, ia nisa këngës ndërsa menjëherë në vargun e dytë u fut pianoja, violonçeli dhe, më pas, e gjithë orkestra. Duartrokitjet e pushtuan sallën për disa sekonda ndërsa zëri im vazhdonte të shndërronte melodinë në lot dhe zëra që çirreshin. Mësues Xhakelini tundej sipas melodisë ndërsa Xhek Shelli më kish ngulur sytë e ashpër dhe mundohej të vinte buzën në gaz si me pahir...

Megjithëse u mundova të përqendrohesh në vetëm te kënga, me shpirt, vlerësova për një çast gjithçka po me shihnin sytë. E vetmja gjë që më paraqitej vulgare ish shikimi dhe qeshja e Xhek Shellit, megjithëse u drodha, s'e dhashë veten gjer sa e mbylla këngën dhe, e shoqëruar nga duartrokitjet, dola jashtë.

- Shumë bukur, shumë bukur! - më shoqëruan ca zëra të njohur që s'arrita t'i deshifroja.

Isha djerësitur dhe dallova se sytë i kisha të përplotur. Po dridhesha e tëra.

- Jeni e emocionuar, - e njoha zërin aq të dashur të mësues Xhakelinit.

- Pakëz, - iu përgjigja pasi e sodita me një shikim mirësie. Por menjëherë e kuptova që po e gënjeja. E vërteta ish që po dridhesha nga frika. Ende më silleshin të freskët shikimi dhe buzëqeshja e Xhek Shellit. Ish një ndjenjë krejtësisht e pakuptueshme. Sepse më ngjau se ai shikim më sillte pranë një humnerë të cilën u mundova t'i shmangesha. Kërkova të çoj mendjen tek nëna. Zërat që më rrethuan u dyndën edhe më dhe më nxorën nga ajo vorbull dyshimesh e pavëmendshmërie, që më kishte kapluar. Harrova gjithçka dhe u përfshiva në atë mjedis lodrues plot zhurmë dhe aq mirëpritës sa që s'e kisha ndier ndonjëherë.

Nganjëherë njeriu parashikon. Dhe ky është një mister i vetë njeriut apo i të tjerëve që e rrethojnë. Ai mund të jetë një imagjinues i mirëfilltë i ngjarjeve të tij. Njeriu nganjëherë fare thjesht mund të parashikojë të përpjesëtuar fatin e tij, falë ndjeshmërisë, dhe xhelozisë ndaj disa momenteve paraprirëse, që më vonë i beson si vendimtare dhe më kot u kërkon hakmarrje. Nganjëherë njeriu bëhet vetë viktimë sepse fare thjesht nuk i beson ndijimit, nuk përkrah mendimet e çmendura që mund ta rrethojnë, vetvetiu njeriu s'beson se çmenduria mund t'i tregojë rrezikun. Gjithçka, gjithmonë, është aq enigmatike sa ç'mund të përjetohet. Kureshtja ndaj enigmës ose atyre dhjetëra e dhjetëra sinjaleve të padeshifrueshme që merr në mënyra të ndryshme e që konvertohen në nënvetëdijen e tij në frikëra e dyshime të mjegullta, është arma që gjithmonë gjithkujt i sjell humbjen apo fitoren. Kureshtja dhe mizëria e enigmave, me të cilat të sulmon realiteti i përditshëm, janë vegla abstrakte të fatit, i cili të çmon, në rastin më të mirë, kur gjakftohtësisht ulesh dhe shqyrton tymthi njëfarë korrelacioni irreal e hipotezues, duke lundruar kundër rrjedhës së furishme të “pse”-ve të pafund ose të përçmon, të shpëton ose të hedh në rrjedhën e fatkeqësive... Engimat, pandehmat, ëndrrat, fantazia janë pjesë eterike dhe e errët e nënvetëdijes, pa të cilat njeriu nuk mund të bëjë dot. Është pikërisht pjesa më vetjake, më e panjohur e njeriut si nga vetja, po sidomos nga të tjerët, nga më të afërmit, është ai “pus” i thellë, për të cilën njerëzit shprehen se “njeriu është pus i thellë e nuk njihet dot”, ndaj dhe ka mbi 2000 vjet, që është ende aktuale thirrma-ftesë e filozofit antik grek Sokratit.

Salla zuri të boshatisej. Nga jashtë, siç ngjet rëndom pas koncerteve, zëra të ndryshëm ende zinin emrin tim në gojë. Më së shumti i shkëlqenin sytë mësues Xhakelinit. Unë po përjetoja diçka mes kënaqësisë dhe tmerrit, diçka pa emër që më godiste në gjoks dhe më jepte një dridhje, të cilën sigurisht që të gjithë ata që më rrethonin e merrnin për vërshim emocionesh. Skandali i triumfit dukej sheshit. Kënga e kënduar nga unë dhe e kompozuar nga mësues Xhakelini mbahej nga të gjithë si më e bukura. Dhe fjalët i kish prekëse, të shkruara nga një poet me origjinë austriake, por që prej vitesh jetonte në Kaliforni. Kënga thoshte:

“Nuk është kjo një dashuri e vogël  
 Që shpirti mund ta vuajë veç një herë,  
 Kjo është një dashuri njerëzore  
 Që shpirti e vuan përgjithmonë”.

Ish krijuar një atmosferë e gjallë, e cila cangaca po fashitej, duke lënë në mua më shumë tmerre.

Ndër të fundit dolëm jashtë unë dhe Xhek Shelli të shoqëruar nga mësues Xhakelini.

Jashtë bënte ngrohtë. Një flad oqeanik na binte përballë si një rrymë e shturur. U ndjeva e djersitur e tëra. Mësues Xhakelini vazhdonte të më jepte këshilla, ndërsa Xhek Shelli më ngulte sytë dhe vinte buzën në gaz. Sepse më ngjau që kish një shtirje ajo qeshje skandaloze. E gjykova kështu me mendjen time, që aspak s’fluturonte nëpër thjerrat e suksesit, që më priste. Ndjeva mungesën e dikujt. Fytyra e saj m’u shfaq si e zënë nga një hije. U binda që s’ekzistonte ato çaste. Prapë gjer sa u ndamë nga mësues

Xhakelini e mbajta veten. Disa herë desha ta ftoja dhe atë që të vinte me ne në shtëpi, të flinte atje. Desha t'i flisja për frikën time, për mendjen time që dyshonte në diçka ç'njerëzore dhe për njëfarë urrejtjeje që atë pasdite me kish lindur befasisht për Xhek Shellin. Gjithsesi kujtohesha, nxirrja konkluzionin që më parë... gjithmonë e kisha dashur. Dhe e kisha ndier atë dashuri sikur ai të ish babai im i vërtetë, por diçka e çuditshme po ndodhte mes perceptimit tim dhe veprimeve të tij.

S'e di pse nuk ia qava hallin mësues Xhakelinit. Ai u nda nga ne me një lamtumirë të çuditshme. Më shoqëroi me një shikim si të përvuajtur duke u munduar të vinte dhe buzën në gaz, sikur i erdhi keq që po më linte në duar të pasigurta. Harroi të më puthte në ballë siç e kishte gjithnjë zakon. E vetmja gjë që bëri si zakonisht ish të më linte porosinë në lidhje me zërin; të mos pija gjëra të ftohta as të ngrohta dhe humbi nëpër errësirën e parkingut.

Këtë rrallë Xhek Shellin më shtriu dorën e tij të madhe. Me këtë gjest kërkoi që unë ta shoqëroja. S'e di nëse arriti ta kuptonte dridhjen e dorës sime. E ndjeva që ma shtrëngoi dhe frika atë çast m'u shtua njëqind herë më shumë.

Nuk arrija të nxirrja zë. Kurrë më parë s'isha ndjerë aq e frikësuar, as kur nëna më tregonte për historitë e trishta të babait, kur ai e rrihte, as kur kisha kaluar natën më të frikshme gjer atë çast, në vjeshtën e tre viteve më parë kur furtuna e ardhur nga bregdeti na kish rrënuar gjysmën e çatisë dhe kur një zhurmë e tmerrshme më kish zgjuar nga gjumi dhe as në netët kur e vetme prisja të vinin nëna me Xhek Shellin. S'isha ndier aq e frikësuar as natën e parë kur ngela e vetme menjëherë pasi ish larguar Lizbeth dhe nëna e Xhek Shellin nuk erdhën gjer në të gdhirë. Kisha kaluar vërtetë net të tmerrshme, mbushur plot me frikë dhe pa gjumë, ku të lehurat e qenërve të Rrokfelerëve e shtonin edhe më shumë frikën time, por asnjë çast të gjithë atyre netëve nuk mbaja mend të kisha qenë më e frikësuar se sa në ato momente, kur dora e tij e ftohtë më shtrëngonte dhe më tërhiqte pas vetes.

Ato metra gjer te makina e tij m'u dukën të gjata. Djersiva më shumë. Ai hapi portën dhe më mori në krahë duke më ndihmuar të

ngjitesha në kabinë. Makina e tij ish një makinë e lartë. Kurrë s'më kish pëlqyer. Të paktën ato tre katër herë që kisha hipur ne të më parë. Gjithnjë do i lutesha nënës që të dilnim me makinën e saj.

Kur mbylli portën e krahut të tije ndjeva një aromë të uthullt të më pushtonte dhe goja ime e tharë desh ca ujë të pinte, por zemra ime e thyer s'linte për mendjen as për gojën fjalë të formoheshin, ndërsa tundej si e marrë në gjoksin tim.

Makina bëri përpara dhe pikërisht pas një çasti ndjeva shikimin e tij të më shponte.

- E di Margaret?!

- Çfarë?! - pyetja ime ish vetëm shikim i frikësuar. Buzët më ishin qepur dhe zemra, besoj, as që më rrihte atë çast nga agonia.

- Që jeni e mrekullueshme, -iu përgjigj shikimit tim te trishtuar.  
- Këndoni vërtet bukur. S'e kisha besuar po mos t'ju shihja me sytë e mi sonte. Megjithëse jot ëme gjithnjë më përcjell mesazhe për ty.

Aroma e uthullt, tek ai fliste, bëhej më e dendur dhe ndërkohë që goja ime thahej më tepër, zemra ime gati sa s'po pushonte nga frika e ankthi.

- Jeni dhe e bukur, gjithashtu. Ju pashë në skenë. Nuk keni aspak shoqe. Pa dyshimin më të vogël, jeni më e mira.

U mundova të shtrij shikimin dhe ta shoh paksa. M'u duk si një djall profili i tij. Mjekra pak e zgjatur. Hunda e dalë. Mustaqet e shtrira përtej buzëve. Flokët e gjatë nga pas dhe balluket përpara, që i jepnin më shumë pamjen e një njeriu të shthurur. Për herë të parë, që kur e kish sjellë nëna ime në shtëpinë tonë po e shihja me një sy kritik dhe me një ndjesi të tillë analizuese. Ish vërtet një krijesë e shëmtuar dhe e frikshme. Sakaq u pendova që kisha pranuar ta thërrisja baba një shëmtirë të tillë.

E humba shikimin jashtë te makinat që linim pas. Një çikëlim shiu rrihte xhamat e përparmë, e cila më bëri të frikësohesha edhe më shumë.

- Vura re se dhe mësuesi juaj është i bindur për suksesin që do të korroni. E besova sepse ishte shumë entuziast. Madje këtë herë e besova që ju donte me shpirt të pastër. Xhek Shell vazhdonte të fliste, ndërsa unë me frikën strehuar thellë në zemrën që pulsonte



gati për të shpërthyer, sodisja dhëmbët e tij të verdhë. Ai shtoi. - Ta ndez një cigare, s'besoj që të bezdis.

- Mësues Xhakelini më porosit gjithnjë, që të mos marr pjesë nëpër ambiente, ku pihet duhan, sepse është i dëmshëm për zërin. S'e kuptova se si mora guximin t'i flisja në atë mënyrë.

Ai, megjithatë, e ndezi sikur të mos kish dëgjuar çfarë unë i thashë dhe m'u përgjigj me një ton vulgar:

- Po të rrish gjatë në një ambient, ku pihet cingarja po edhe mundet, por vetëm për kaq s'do të ndodhë asgjë me zërin tuaj. Ja, dhe pak mbërritëm.

U frikësova dhe më shumë nga ajo përgjigje e tij dhe mendova që më mirë do ish ta kyçja gojën.

Desha paksa të merresha me çorapin tim të bardhë, i cili në një rën anë të llastikut që ndotur me një masë të murrme, por sakaq ktheva mendje meqë s'doja t'i tërhiqja vëmendjen me ndonjë lëvizje timen.

Një muzikë xhazi pushtoi kabinën dhe Xhek Shell i më pyeti:

- E njeh këtë muzikë?

S'leshova zë ngaqë s'dija si të përgjigjesha. Ai vazhdoi:

- Është muzikë tepër e preferuar për ata që kalojnë jetën e tyre në det. Ka të bëjë shumë me detin, kështu thotë një shoku ynë marinar. Flitet se u përngjet valëve të melodisë që lënë pas valët ndër dritën e diellit dhe të hënës. Valët zhurmojnë ndryshe ditën dhe ndryshe natën. E dije këtë.

- Jo, - i thashë me një fije zëri.

- Po që valët krijojnë muzikë më vete. Këtë e dije?

- As këtë!

- Po që deti është një përbindësh?

- As këtë!

- Po që ju jeni këngëtarja më e mirë në botë? As këtë?

U mundova të buzëqeshja paksa si shenjë mirënjohje për komplimentin superior, ndërsa ndjeva se shpirti m'u çlirua nga ajo prangë që më shtrëngonte.

- Mbërritëm në shtëpiiiii! - ai me shikoi dhe vuri buzën në gaz ndërkohë që hodhi bishtin e cigares nga dritarja

- Harrova të të pyesja nëse doje të haje diçka, - u kujtua ndërkohë që përveç restoranteve të qendrës, të paktën kishim kaluar pranë tre restoranteve të tjera anës rrugës gjersa erdhëm në shtëpi

Prapë më rrëmbeu frika kur pashë se po më trajtonte si një zonjë të panjohur.

- Kam frikë, - i thashë. - S'kam uri.

- Frikëëëë?! - ushtoi zëri i tij. - Nga kush nga nata? Nga të lehurat e qenve? Nga zhurma e detit. Nga... se?!

- Nga ju, - e ndërpreva, pa ditur se ku e mora tërë atë guxim.

- Nga unë? Nga yt at, që ju do si dritën e syve?! Oh Zot, ç'po dëgjoj? - shfryu duke përplasar duart e tija të mëdha mbi gjunjë.

Më mori në krahë dhe më zbriti nga makina.

- Nuk dua t'ju dëgjoj më ta thoni diçka të tillë, - m'u drejtua me një zë të vendosur e të veshur me një qortim prindëror.

E pashë që ishin të gabuara të gjitha ato përgjigje, megjithatë ç'mund të presë njeriu nga një vajzuke tetëvjeçare, që është e mbushur me një frikë të dyshimtë dhe të tmerrshme.

Asgjë s'pipëtinte veçse të lehurat e rralla të qeneve të komshisë diku në thellësi, të cilët kishin vilën më të madhe në atë zonë dhe dihej nga gjithkush se ishin kushërinj të afërt të Rrokfelerëve.

Xhek Shelli më mori për dore dhe më shoqëroi brenda në shtëpi. Ndezi dritën e korridorit dhe, më pas, atë të sallës.

- Unë po dal. Ju s'do të kini frikë? - m'u drejtua.

- Jo! - i thashë.

- Aspak? - më pyeti si për t'u siguruar

- Aspak- iu përgjigja duke e miratuar me lëvizjen e kokës.

Doli jashtë ndërsa unë u çlirova thujse e tëra. Ish një kleçkë e vogël që s'më shqitej sido që të ishte. Ia nisa të hidhesha përpjetë nga gëzimi dhe, kur makina e tij mori dhenë dhe zhurma e saj humbi, ngjita shkallët dhe mbërrita në dhomën time me një frymë, kyça portën nga pas dhe, pasi u sigurova mirë e mirë, u mbështeta pas portës dhe hodha sytë nga dritarja, m'u duk sikur një përbindësh do përplasej në dritare nga çasti në çast dhe do hidhej para këmbëve të mia. Mbylla sytë dhe, pas një pauze, që se di se sa zgjati, i hapa përsëri. Kisha dëgjuar nga Lizbeth që kinezët arrinin ta mposhtnin

frikën dhe tmerrin duke mbyllur sytë dhe duke imagjinuar gjërat më të bukura që kishin kaluar gjatë gjithë jetës së tyre si dhe gjërat më të bukura që ëndërronin të kalonin. S'arrita të gjej qetësinë e shpirtit as gjatë atij ushtrimi të sforcuar, të cilin po e provoja për herë të parë. Sytë m'u rrëzuan andej nga ish e vendosur pianoja. Diçka tjetër më e volitshme më erdhi ndër mend. I hodha një vështrim portës dhe tërhoqa dorezën e saj të bronztë me të dy duart për t'u siguruar që ish e mbyllur mirë ndërsa vrapova drejt pianos, zbulova tastierën, vendosa mënjane fotografinë, ku kisha dalë unë me mamanë dhe Xhek Shellin me rastin e shtatëvjetorit tim, festuar në Las Vegas. U ula në karrige dhe, pasi fshiva djersët e ballit, për të fundmen herë ia mora këngës.

*Njeriu ka një djall në vete  
Shpresa është arma që ndan  
Shpirtin e mirësisë dhe të ndjenjës  
Aty ku do fitoje dhe bukuria e jetës.*

*Aty ku s'ekzistojnë të çmendurit  
Ku kafshët janë zhdukur përgjithnjë  
Ku çmohet e bukura dhe mirësia  
Aty është e bukura e jetës.*

*Lëndinë njerëzore plot fryte  
Të natyrës së pastër njerëzore  
E mbushur me lule dhe këngë  
Tek ti është jeta më e bukur...*

Dikur m'u qep një bindje urie, lashë mënjane tastierën dhe mbajta vesh. Përreth qetësia vetë më dhuronte një sintezë frike. Ish prezenca e një boshësie shpirtërore e cila tradhtonte adrenalinën që tkurrej plot mishërim. Boshësia thellohej më shumë e më shumë brenda stomakut tim. Uri, një uri e tmerrshme kish zaptuar qenien time. Shikoja rreth e rrotull për të perceptuar diçka të palëvizshme në një vend të papërcaktuar. Diku tutje fërshëllente era e çmendur e bregdetit. Fishkëllima e saj më sillte gjithë atë frikë u mundova ta

besoj atë parantezë ndërsa mora guxim. U mbusha me frymë thellë dhe si një luftëtare, siç kisha dëgjuar për tim at, arrita të shkëputem nga ajo kauzë heretike.

Dola në kuzhinë dhe pashë s'e mund të haja. Te vetmet gjëra që më ranë ndër mend ishin cerealet me mjaltë, i hodha në pjatë dhe mora ca qumësht diete të cilin nëna ime e përdorte zakonisht për vete kur i dukej vetja se po shtonte në peshë më shumë se duhej. Hëngra ca, një lugë dy tre pastaj e lashë. Uria m'u zhduk siç zhduket hija në errësirë. U enda nëpër sallnin e gjatë. Një boshllëk më rrëshqiste nga gryka për në stomak, dhe barku po më rëndonte. E mora me mend se do të ish shpirti im i cili parandiente diçka të keqe. Mendja ime luftonte me një parandjenjë inekzistuese që po më kërcënonte. Isha e vetme. S'më frikësonte vetmia. Më frikësonte prania e çdokujt tjetër.

- O Zot, mos e sill sonte Xhek Shellin, - iu luta Zotit. - E vetme ndihem më mirë.

Jashtë gjëmonte një furi e rëndë erë. Fërshëllima e pacifikut përzihej me të lehurat e qenve të Rrokfelereve. Binte shi i dendur. Diçka e zymtë ma zinte mendjen dhe një prerje më bezdiste në fundin e barkut

“Mos e sill Zot, mos e sill. Le të dehet diku atje tutje ose le ta thyejë qafën me makinë.”

U ndjeva keq që po mendoja ashtu për të por ish një parandjenjë shpirtërore që më shtynte. Ish një intimitet që e shfaqte atë para meje si një bishë që donte të më gllabëronte Kish kaluar më shumë se gjysma e natës. U lodha së menduari, U lodha së gjykuari përmbi hijen e tij të rëndë dhe aq të frikshme. Skërmitja, dikur, më pështolli me një mbulesë të hollë dihatjeje dhe një ëndërr e mbushur me yje më ftoi në strofullën e saj.

Ish një natë e bukur, unë isha shtrirë përmbi një lëndinë të gjelbër me shikimin lart nga qielli. Yjet më rrinin mbi krye dhe një nga një uleshin gjer poshtë të më puthnin sytë. Ish një skenë ekzistuese. Një mrekulli e vërtetë që mund ta shprehë vetëm ëndrra. Ish një kalamendje lozonjare që harbonte shikimin tim ndërsa humba poshtë atij piedestali të këndshëm. Por pas gjithë asaj mrekullie

shfaqej një enigmë, pas enigmës nxirrte krye diçka tepër e urryer.

Një dorë e madhe dhe e ashpër m'u shtrua në fytyrë. Ndjeva një ftohtësi të ma mbështillte fytyrën dhe zura të klithja. Një klithje e lehtë si e një maceje para ngordhjes U mundova të shquaj përreth ç'ish ajo humbëtirë. E pashë fytyrën e Xhek Shellit ndërsa tafti i gojës së tij më solli përnjëherë një dëshirë për të vjellë. Volla ç'kisha në bark ndërsa dora e tij e madhe u mbush me të vjellët tim. E pashë me sytë e tmerruar kur gëlltiti

- Këtu brenda tyre jeni ju bukuroshe e njomë, - më tha.

U tmerrova dhe s'dita si do mund të çlirohesh nga duart e tij. Klitha me një zë të mbytur që as vetë s'arrita ta dëgjoja. Ish më shumë një klithmë e brendshme. Ndjeva që ai do të më mbyste. Arrita të lëshoj një fije zëri të dobët.

- Ju lutem, mos më bëni asgjë të keqe, baba.

- Asgjë të keqe bukuroshe. Veçse thjesht ju dua më shumë se nënën tuaj ju dua. Jam dashuruar me ju që herën e parë që ju pashë dhe prisja të vinte një natë e tillë.

Zura të qaja me ngashërim. S'kuptoja nëse zëri im e trishtonte apo e eksitonte më shumë përbindëshin që më rrinte përmbi.

"Të lutem, të lutem, të lutem. Kam frikë. Mos më bëni asgjë të keqe."

"Është thjesht një lojë, bija ime. Ju e dini që sytë e mi ju admirojnë."

Fryma e tij më kish nxënë, edhe njëherë tjetër volla, këtë herë diçka të hidhur më shijen e helmit, ai prapë gëlltiti. U ndjeva e këputur. Një peshe e rëndë më shtynte ndërsa yjet po zhdukeshin duke lënë para syve të mi vetëm frikën e natës.

Hapa sytë me bindje se s'isha më unë. Nga jashtë kish zënë të zbardhte një fill i lehtë drite. U ngrita në këmbë, asgjë s'pipëtinte. Gjithkush flinte, dhe pemët gjysmë të zhveshura s'ulërinin më, dhe fladi oqeanik s'dërgonte më mesazhe, dhe qentë e Rrokfelerëve strukeshin nëpër thjerrëzat e agimit bashkë me britmat e tyre.

U gëzova pa masë që kisha jetuar një ëndërr. Xhek Shelli s'dukej asgjëkund. Falënderova Zotin, të vetmin dëshmitar të frikës sime.

Zbrita poshtë në salle dhe u ula në piano për t'ia marrë këngës.

Kur ndjeva se isha lodhur duke luajtur piano ndërsa fyti po më digte nga një tharje e tepruar, mbështeta duart në tastierë dhe u

shtyva. Qetësia u thye nga dy duar që trokitën duke më shtjerë frikën aq sa e humba toruan. Ktheva kokën pas dhe pashë sytë e ënjtur të Xhek Shellit.

“Zot, i çmendur!” , belbëzova me vete, meqë u ndjeva e tradhtuar nga Zoti sepse më kish premtuar që s’do të ma sillte.

- Bukur. Shuuuumë bukur! S’paskeni fjetur Margaret?

- Po kam fjetur, - u mundova të përgjigjesha menjëherë, duke ia minimizuar shkasin që t’i binte në erë dridhjes sime. - Sapo u zgjova dhe, ngaqë s’po më zinte më gjumi, vendosa t’i jap një përsëritje këngës sime.

- Oh, për mrekulli! Shumë bukur! Ndërsa unë e kam kaluar gjithë natën me xhazet në bregun e detit.

U mundova të mos i ktheja përgjigje për të mos ushqyer bisedën më tej, ndërkohë që, me shpejtësi, mora tatëpjetë shkallët dhe u mbylla në dhomën time. Zura portën nga pas me trupin tim dhe po shtjelloja qetësinë e frikshme që shtrihej atje poshtë.

Pashë orën. Mungonin dy orë që të vinte autobusi i shkollës. M’u duk tepër e gjatë ajo kohë gremine. U mundova të merrja me mend, për të sajuar ndonjë rrugë shpëtimi, por e vetmja gjë që pashë të arsyeshme ish të ndryhesha në dhomën time e kyçur nga brenda. Një frikë makabër më guduliste në brendësi. Ish një velësi aq e pështirë, saqë lotët që më binin rrëke s’mund ta çlironin atë shtrëngim. Vendosa t’i thërras vetes.

Ndërkohë nga poshtë erdhi një zhurmë. Pastaj zëri i tij çakërdisur.

S’i lashë vetes kohë që të zhvishesha dhe të lahësja. Dhëmbët mora mundimin t’i pastroj, por i lashë përgjysmë duke shpëlarë vetëm gojën me ujë dhe duke fshirë me letër higjienike jargët që më përftonte e qara ime e mbytur. Hidhja sytë drejt portës, duke pritur me ankth ndonjë shpërthim.

- Margaret!

“Uhhh, zëri i tij i tmerrshëm ushtoi pikërisht rrëzë derës së dhomës sime. Një rrëqethje pa përmasa më drodhi si një fiskël në mes të furtunës. S’u përgjigja aspak ndërsa zëri i tij ushtoi për së dyti.

- Hape portën!

- Po bëj banjë, - e gënjeva, sa për ta larguar.

- Mirë shpirt atëherë po të pres, - ma ktheu me atë zërin e tij edhe më të tmerrshëm.

E pashë që rreziku s'po më shmangej. Me kujdes hoqa çelësin nga brenda portës dhe nga vrima e tij, ashtu pa bërë zhurmë, u mundova të shpoj atë gjysmë errësirë. Shikimi im i përplotur në fillim s'dalloi asgjë. Dikur e etur nga tmerrri dhe ankthi i çmendur arrita të shquaj figurën e tij përtej, Ish ulur në gjunjë para portës dhe, me kokën mbështetur në duar, po priste. U tërhoqa me forcë dhe, instinkti për të shpëtuar, me dërgoi të shpresoja tek dritarja. U nisa drejt saj dhe me kujdes, pa bërë zhurmë arrita ta hapja. Shpati i kodrinës mbi të cilën ish e ndërtuar shtëpia jonë në atë pikë vinte thikë. Besova që do ish fundi dhe frika me mbështolli më me forcë. U ndjeva e humbur. Rrija me shikim poshtë e gatshme për t'u hedhur nëse ai do të bënte qoftë edhe një hap brenda dhomës sime. E kisha aq frike atë njeri sa që kurrë s'do mendoja s'e do të ekzistonte një frikë e tillë në zemrën e askujt.

- Margareeettttt! - prapë erdhi zëri i tij këtë rrallë me një ëmbëlsi përkëdhelëse të shtirë.

S'mori përgjigje nga unë.

- Margaret, Margaret, Margaret, - të dytën herë kumboi me të njëjtën ëmbëlsi, të tretën herë u shtur, te thirrma e katërt u dallua një nervozizëm i hapur brenda tij.

Porta ime u shkund dhe, për herë të pestë, u çjerr zëri i Xhek Shellit:

- Margaretttttttt!

Nuk dija ç'të bëja. Ndjenja e frikës së një të papriture më thoshte të hidhesha nga dritarja, ndërsa shkëmbinjtë poshtë më kërcënonin me majet e tyre të mprehta. Isha tepër foshnjë, për të vdekur në mënyrë aq mizore, por gjithashtu isha tepër foshnjë që të rrëmbehesh nga egërsia e tij aq e ndyrë.

Nëpër ato momente të çakërdisura që vrullonin si një tornado në kokën time, s'arrita ta kuptoj dramën që mund të më përfshinte cilëndo rrugë që të merrja. S'ish mendja ajo që më jepte drejtim; ish frika ajo që më tërhoqte drejt njërës prej greminave që kisha si rrugëzgjdhje.

Ndërkohë një shpërthim më hodhi shuk. S'ish ëndërr. Prania e tij ish e gjallë, e gjallë si vdekja. Arrita të dalloj si nëpër mjegull fytyrën e tij të ashpër ë të përndezur; gojën e tij që nxirrte dhëmbët si të një egërsire; duart e tij të fuqishme të shtrira, për të më përfshirë.

Më rrëmbëu. U mundova të çlirohesh, por ish e pamundur, prapë u mundova të besoj që ish vetëm një ëndërr.

Jashtë dielli po zbardhtë ditën më të mallkuar që natyra ndonjëherë kish dhuruar. Qielli ish i kthjellët. Nga jashtë vinte aroma e mimosave të thyera nga furtuna. Zhurma e detit, diku ulërinte dhe qentë e Rrokfelerëve gati sa s'pëlcitën se gajasuri.

I dhashë vetes me sa kisha forcë, e shkunda Xhek Shellin dhe rrëshqita nga duart e tij mizore. Diçka më goditi dhe rashë. Ish dora e tij e mallkuar që më shtriu përtokë. Klitha me sa zë kisha. Dora tjetër e tij më zuri gojën dhe hundën. Shpërtheva në vaj të mbytur si një bretkosë që e rrjepin për së gjalli, ndërsa këmbët e mia të holla përpëliteshin duke e humbur fuqinë. Ndjeva të më prekte aty ku kurrë s'më kish prekur as nëna ime. S'e kuptoja ç'po bënte me mua ato çaste. Frika dhe vaji kishin asfiksuar intuitën time. Ndihesha e ftohtë, e ftohtë si një e vdekur. S'shijja më asgjë dhe s'ndieja më asgjë.

Dikur më sollli në vete zëri i tij që po derdhej mes epsheve. Ulërima të forta më gëlltitën dhe tmerri m'u zhduk si vetë dëshira për të jetuar. Besova që Xhek Shell bëri një krim me qenien time që kurrë më s'do të ekzistonte. Këtë e besova kur ai u spraps dhe pashë veten të larë në gjak gjithandej. Mbylla sytë e lodhur dhe u venita mbi një ëndërr të vdekjes. S'kish si të ishte ndryshe, përveçse ashtu...

S'e di sa çaste kalova në atë dilemë. S'e di se si zbardhi më tej ajo ditë. S'e di se si vdekja s'më mori në krahët e saj. S'e di pse s'rashë në gjirin e shkëmbinjve dhe s'di pse Xhek Shelli i vuri jetës sime një kapak aq të zymtë e mizor. Di vetëm që kur u zgjova nga zëri i ëmbël dhe i tmerrshëm u tij ish pasdite. Një vapë e rëndë rrethonte gjithandej.

- Ngrihuni dhe pastrohuni! - pati guxim të më thoshte



Ish një boshllëk pa fund që përmbushte qenien time si të paqenë. Arrita të kuptoj s'e ç'kish ngjarë dhe se kurrë më s'do të isha në këtë jetë Margaret Kodington.

- Ku është mësues Xhakelini? - m'u kujtua kompromisi me të dhe humbja aq e thellë që kisha pësuar. - Pse s'kam shkuar në shkollë?

- Erdhën të të merrnin, por unë u thashë se jeni e sëmurë. Të njëjtën gjë ia thashë edhe mësuesit tënd. Dhe pasi zgurdulloi sytë e tij të brengosur mbi ballin tim m'u hakërrye: - Dhe ti ashtu do u thuash te gjithëve që ke qenë e sëmurë dhe kurrën e kurrës të mos i tregosh askujt për atë që ka ndodhur sot mes nesh. Ne të kundërtën do të të hedh në fundin e detit aty ku rrojnë peshkaqenët më të uritur. Ke dëgjuar për peshkaqenët? Ata të gëlltisin dhe kurrë më s'dëgjohet nga askush zëri yt aq i bukur dhe kurrë më s'të sheh as të ndien njeri. Unë kam parë me sytë e mi sa herë ata kafshonin shokët e mi, që zhdukeshin përgjithmonë.

Fytyra e tij, egërsirë ëndrrash, skërmitëj krejt pranë fytyrës sime, që s'di së në çfarë mund të ish shndërruar ato çaste. Një dhimbje e tmerrshme më shtrëngonte në brinjë dhe në fundin e barkut. Ai s'm'i hiqte sytë e vrenjtur si të një bishe të egër që i kërcënohet gjahut te ngordhur. S'e durova me gufmën e tij. S'arrita të honeps më shikimin e tij kafshëror. Pranova humbjen. S'arrita të kuptoj më kurrë se vdekja mund te ish dhe më e ëmbël se sa humbja!

Mbylla me mundim sytë e përлотur, mbështeta duart, që më dridheshin nga sflitja, në ballin e drunjtë të krevatit dhe u tërhoqa nga shikimi i tij i neveritshëm.

Pas atij mëngjesi të krisur, asnjëherë më në këtë jetë s'do të doja të qeshja. Bota kish marrë përmasa të tjera. Njerëzit e mirë më s'ekzistonin. Shoqëria ime e mitur dhe mësuesit e mi ishin tashmë thjesht vegla të një huluntimi, që të shfaqet, sa për të treguar rrugën e ca të fshehtave pa vlerë. Jeta dhe vlera e saj s'ishin më të lidhura me njëra-tjetrën.

Arrita ta kyç gojën dhe t'i bindem presionit të Xhek Shellit, duke mbajtur gjithmonë ndër mend fundin e detit dhe tmerrin që mund të më gjente atje poshtë.

Atë natë, ndërsa i qahesha me lot vetmisë dhe tmerrit, ndërsa luaja me limitet e një jete pa cak dhe pa ëndrra më, me një frikë të mbirë thellë në shpirtin tim foshnjor, ndërsa thërrisja një shpresë hijesh të më kundronte dhe të më mbante gjallë, midis sikletit të ndjenjës së djegur dhe të asaj ndjenje që kurrë as më vonë s'e kuptova, ndërsa lotët mundoheshin të lanin ndyrësinë që kish rënë mbi mua, erdhi Xhek Shelli me një tjetër fytyrë.

Më kish sjellë ëmbëlsira, dhurata dhe ndër ta një kukull të virgjër. Zuri të ma shpjegonte kur ma dhuroi, duke llomotitur për virgjërinë e kukullës, e cila ishte bërë për të jetuar gjithmonë e virgjër. “Vetëm kukullat s'ka kush t'i zhvirgjërojë”, pëshpëriti dhe m'i nguli sytë për një kohë të gjatë.

Unë largova vështrimin nga ata sy të bezdisshëm e cinikë. Ai fliste para meje sikur para një gruaje te moshës së tij.

E urrejtja pa masë me një dëshirë që ta shihja të vdekur. E urrejtja mes një agonie që s'i nënshtrohej më urrejtjes së mëparshme. Pashë rreth e rrotull me se mund ta vrisja. Pati guximin e marrë dhe, akoma me të ndyrë, të më afrohej dhe të me puthte. Era e alkooolit

më bëri të kollitem, kur afshi i tij m'u përplas nëpër buzë. S'kuptoja çmendurinë e tij aq të thellë, veç ndjeva buzët e tij aq të velshme të ciknin buzët e mia fëminore.

- Ju jeni kafshë, - pata guximin t'i thosha. - S'e di ç'ju solli mes nesh.

Dhe u ngrita, për të marrë vrapin për në dhomën time. Ajo dhomë, për një kohë të gjatë, do më ngjante me varrin tim. Ai do më shihte me sytë e tij të çuditshme ndërsa do të rrëzohesha nga padurimi i dhimbjes dhe nga plaga e freskët dhe, do të merrte guximin e ndyrë, të më ndihmonte. Pafytyrësia e tij ish e rrallë, ndërsa njerëzillëku i tij do ish i shterpët. Do më linte ëmbëlsirat mbi tavolinën time të librave dhe do të largohej me një buzëqeshje të varur nëpër buzë, si një rrobë e harruar në telin e rrobave.

“Ah, jetë mizore që s'sheh përreth dhe të marrësh vendime të tmerrshme për njerëz të tillë”. Shpirti më nxirrte dufshëm fraza të tilla edhe më të thella. Kur mizoria dhe forca e një proverbi ka të bëjë direkt me jetën e dikujt, atëherë humbjen e vërtetë do ta pranojë edhe një shpirt i freskët, siç mund të jetë shpirti i një vogëlusheje që kurrë s'e ka parë violencën me sy në jetën e saj. Është diçka që fshihet në gjakun e njerëzve që prej gjeneratash, diçka që s'shihet me sy, që fshihet nëpër mendje çnjerëzore dhe dënojnë shpirtin të thjeshtë e plot dashuri për gjithkë.

Ndjeva që shpirti im po gjykonte me një mënyrë që kurrë më parë s'kish gjykuar. Ai s'ish me një shpirt i brishtë ngarkuar plot ëndrra të pastra. Ish një shpirt i egër që e rrethonte errësira e një shthurjeje, duke e detyruar qenien time që të urrente më shumë se sa të dashuronte. Dhe ky fakt, - për të më shthurur, - ish goditja e tmerrshme që Xhek Shell, ky njeri me fytyrë njerëzore dhe shpirt çnjerëzor, i kish dhënë të qenies sime, duke hyrë dhunshëm mes për mes tij duke ndarë kështu qenien time nga shpirti im.

Ajo nate do ish e gjatë, pa gjumë dhe e mbushur me një frikë të ftohtë, e cila herë pas here si një mburojë e padukshme më ndante nga rruga e skandalit tragjik.

Shkëmbinjtë poshtë dritares, që çonin rrëzë murit të lartë, që ndante tokën e shtëpisë sonë me atë të Rrokfelerëve, sikur më ftonin

në mes tyre. Disa herë shkova nëpër mend një mëngjes të ndritur nga rrezet e diellit, që rrezatonin mbi koka njerëzish të panjohur, të cilët me dhimbje mblidhnin copat e trupit tim. Imagjinova nënën time, që qante dhe motrën time të vetme që përpëliste qepallat, për të kuptuar disi se ç'më kish ngjarë mua. Imagjinova Xhek Shellin e nxirë të penduar dhe të vetëdijshëm që vendimi i marrë prej meje për t'u larguar nga kjo jetë ish për shkak të tij. Shkoja nëpër mend mësues Xhakelinin, që qante me letrat e pentagrameve në dorë, ndërsa shihte copat e trupit tim që shkriheshin mes tingujve të një kënge që kurrë më s'do të fitonte. Njerëz të tërë që qanin për këngëtaresh, e cila pritej të behej më e famshme. Shoqet e mia që do të frikësoheshin për vendimin tim të çmendur dhe prindërit e tyre të veshur me mantelin e frikës së enigmës për shembullin e keq që mund t'u jepja bijave të tyre, si një zgjidhje e skajshme.

Jetova me të gjithë gjer sa zbardhi një tjetër ditë. S'ndjeva zhurmën e Xhek Shellit, vetëm u binda, që kisha gëlltitur humbjen ndaj vetvetes.

Në mëngjes fola me nënën. Zëri im i shtjerrë s'gjente forcë të fshihte mirë rrënojën që kish lënë tek unë ajo plagë e pashërueshme. Me siguri, ajo dalloi diçka anormale në zërin tim dhe, që atje larg tej linjës telefonike, më pyeti:

- Ti s'më dukesh se je tamam mirë bija ime. Thuamë çfarë të mundon?

Heshtja që u krijua mes linjash linte për nënën me sa duket shtoi dyshimin intuitiv të saj, por ajo kurrë s'do ta imagjinonte dot atë që kish ndodhur me të vërtetë.

- Do t'i them tët ati që të ketë më shumë kujdes me ty. Megjithëse ai më tregoi se të kish blerë ëmbëlsira, dhurata dhe, ndër ta, një kukull të madhe gati sa ti në këmbë.

Ishte pikërisht Xhek Shelli që ma kaloi telefonin pasi vetë kish folur më për një kohë të gjatë.

Vendosa të mos flisja më mirë, pasi e dija së nëna tani do të vijonte të bënte analizën e zërit tim dhe gjithçka kisha thënë, siç ndodhte nganjëherë. U mundova ta përmbush atë heshtje me diçka që s'i gjeta kuptim, megjithatë gëlltita dridhjet që më shtrydhnin dhe i thashë:

- Jam fare mirë!

Kurrë s'e kisha gënjyer. As kur i fshihesha, për të mos rënë në duart e saj kur ish e egërsuar me mua. Edhe kur Lizbeth mendohej të mos i tregonte për prapësitë e mia, që i bëja shpesh me komshien time, Lolën, që më vonë do të çmendej nga një sindromë, që u bë shkak i një tumori, i cili mezi e kish lënë të gjallë dhe, që më në fund, ia shkurtoi jetën.

Unë darkave, kur bija të flija pranë nënës, i tregoja në fshehtësi për prapësitë që kishim bërë, por në krahun tjetër i lutesha, që të mos nervozohej me Lizbeth sepse ajo çdo gjë që e bënte ish për të më mbrojtur mua. Ajo qeshte. Shihja qartë sytë e saj që kënaqeshin me sinjeritetin tim dhe, pasi më mbushte me të puthura, më shtrëngonte në gji dhe, duke më kënduar, më vinte në gjumë.

Por në ato çaste tmerri për mua, ajo ish larg. Isha e bindur që ish e paarrishme për mua. Duhej t'i tregoja, mbase ajo do ish e vetmja shpresë për mua. Isha e bindur, që do të më kuptonte dhe do të urrente përgjithmonë atë Xhek Shell të çmendur, të cilin ajo e konsideronte më të çmueshëm edhe se veten e saj.

- Ja dhe pak ditë do të kthehem. Të kam blerë sa gjëra të bukura. Kam dhe një surprizë tjetër për ty dhe do të ta them kur të kthehem. Apo do që të ta them tani?

S'isha në gjendje të dija se ç'mund të më hynte në punë asnjë surprizë e kësaj bote. Surpriza më e mirë, mendova me vete atë çast, është të më sjellësh me vete vdekjen, po munde. Ajo do ish surpriza më e denjë.

Sikur dikush do të mund të dëgjonte rrjedhën e vrullshme të mendimeve të mia, s'do të besonte moshën e mendjes sime. Gjithçka e analizoja dhe gjykoja me mendjen e një të rriture. Dhe ishte e qartë se gjithçka kish nisur si me një kurdisje te menjëhershme pikërisht fill pas mëngjesit të poshtërimit tim nga burri i nënës sime.

Nëna s'i dha shkas heshtjes sime dhe, aty për aty, mendoj që duhej të ma thoshte sekretin e saj. Ajo e dinte se unë zakonisht isha një fëmijë që vuaja nga padurimi. Gjithnjë duhej të më plotësonte dëshirat dhe gjithnjë duhej të më tregonte çdo të fshehtë të jetës së saj. Ashtu siç më kish treguar për netët e lumtura, që kish kaluar me Xhek Shellin.

- Dje në mëngjes e pashë motrën tënde në fotografi! - Ajo priti, që unë ta mbysja me pyetjet e mia kureshtare, por nga ana ime s'mori asnjë pyetje me interes.

- Je mirë, bija ime e shtrenjtë? - tashmë zëri i saj ish akoma më dyshues e më i padurimtë për të mësuar ndonjë gjë, por prape

ndodhte sepse i shkonte mendja tek ndonjë gjë e vogël, siç mund të ishte ndonjë trishtim normal që vjen kur dy persona të dashur janë larguar për një farë kohe. Kështu që vendosa t'ia ktheja.

- Po! - iu përgjigja fare shkurt.

- Atëherë si s'po gëzohesh, që Zoti ta plotësoi dëshirën, që ia ke kërkuar kohë më parë? E di se për çfarë po të flas? Për motrën tënde që do të dalë në dritë për pesë muaj! Ti vetë a s'më the që doje një motër?

- Oh, sa po më gëzon nënë! - u kujtova të shtihesha. - Është motër vërtet?!

- E sigurt!

Tutje dëgjova ca zëra që shqiptuan emrin e saj.

- Po shkoj, vogëlushja ime e dashur, po më thërrasin dhe s'kam më kohë. Do të të telefonoj në darkë ose nesër në mëngjes. Jam shumë e zënë me punë këtu në Miami. Punojmë me orë të zgjatura dhe...Okej, shpirt i mamit, të puth dhe të puth me gjithë fuqitë. Të dua dhe gëzohu për motrën.

Linja ra dhe vetmia e frikshme më rrethoi. S'dija ç'të mendoja kur pas meje, jashtë përtej portës së hapur, në oborrin e shtruar me tulla të kuqërremta, rrinte me duar mbështetur në pjesën e përparme të makinës, Xhek Shelli.

E pashë si përciptas. Kish formën e një hijeje të trishtë. Arrita t'i shmangesha shikimit të tij.

E pashë tek më erdhi pas. Më erdhi të klithja. S'ishte më hije. Duhej plot gjysmë ore që të vinte autobusi i shkollës. U ngjita në dhomën time dhe u ndërrova shpejt e shpejt. Dola në dritare dhe qëndrova me shikimin poshtë. Sa më shumë që e shihja atë fund të thepisur aq më shumë më shtoej një tjetër frikë. Prisja nga pas derën e kyçur që të shpërthente.

Padurimi, ankthi dhe frika, ishin tre komponentë që shkrinin në krejt qenien time vuajtjen. Ish mëngjes i qartë, dielli gërmonte me syrin e tij të zbardhte atë të vërtetë që po gremisej në thellësinë e shpirtit tim.

Dita e re, me kristal, mendohej të lante ndyrësinë me të cilën Xhek Shelli, kish arritur të njolloste qenien time një natë më parë.

Por fytyra e tij e mprehtë dhe e djallëzuar erdhi e tjetërsojmë, sikur mes atij dhe meje të mos kish ndodhur asgjë.

- Bija ime, doni që t'ju përcjell unë apo doni të shkoni me autobus? Ai po me fliste me një ton sikur dikush i flet një të huaje, pa rënë në marrëveshje se si do të flasin në mes tyre, me ti apo me ju.

Në djall vafsh, shfryva me vete e çmeritur dhe sytë i zgurdullova tutje, atje ku më ngjau të ngjallej një errësinë. “Ju keni mirësinë e ndyrë të më thërrisni bijë?!”

Frika, pas asaj errësire enigme, m'u shtua njëqind fish. Fundi i detit më erdhi ndër mend i mbushur me djaj të vegjël, por që vidhnin helm. M'u ngjyros para syve goja e tij e shpupurishur dhe fytyra e nxehur me damarë të kërcyer si e një përbindëshi. Fundi im ish në duart e tij. Gjithçka ish më e fortë se unë. U ndjeva e mundur para mirësisë së tij të shtirur.

- Do shkoj me autobus, baba, - i thashë më në fund.

Boria e zakonshme e autobusit të shkollës e prishi atë kaos lebëtitës. Si e mpirë dhe, duke duruar dhimbjen e plagës, që ende s'më ish shëruar, gjeta rrugën për t'ju mënjeluar shikimit dhe duarve të tij që i urreja më shumë se gjithçka një njeri mund të urroje në këtë botë.

Arrita më ndihmën e Vinit, që kohët e fundit vinte me rrallë të na merrte, të hipja ne autobus dhe, pas një “mirëmëngjesi”, pa parë askënd në sy zura vendin tim në mesin e autobusit pranë dritares, aty ku rrija gjithnjë dhe bëja zakonin, duke përshëndetur nënën time apo Lizbethin kohëve të shkuara.

Arrita të shikoj drejt Xhek Shellin se si mendohej të nxirrte dhëmbët për të vënë maskën e radhës të përzemërsisë. Dukej se ajo ëmbëlsi që ngutej të ushtronte ish e shtirë.

Si një fantazmë më gëlltisnin shikimet e shoqeve që më ngjante sikur pyesnin njëra-tjetrën: “Po kjo pse mungoi dje? Pse mungoi pra?! Kaq shpejt u shërua?!”



S'ish koha ajo që ndante hidhërimin nga urrejtja. S'ish mësues Xhakelini, as shoqet e mia të koncertit, që qeshnin dhe argëtoheshin të lumtura, duke treguar për prindërit e tyre histori të paskajshme. S'ish magnetizimi i trishtimit që përkonte me çdo shikim timin, as s'ish asgjë veçse një ëndrre të përjetuar barbarisht, kur qenia ime ekzistonte, por mbi ca re që nuk sillnin tjetër në atë botë, veç një dhimbjeje që vishte me një petk dyshimi gjithë trupin tim. Natyra ime nga e çiltër dhe humane, nga e këndshme dhe e gjallë, ish shndërruar përfundimisht në një asgjë, e kot së koti. Kur asgjëja e një botë të pakuptueshme kish lëshuar rrënjët e saj në thellësi të atyre ndjenjave, që më s'ndiejnë e që rrojnë vetëm sa për të rrojtur, ashtu si një qenie e sëmure që shpreson e shpreson mbi diçka, që kurrë më s'do ta shërojë. Më dukej vetja si dhëmbë i shkukur...

Ditët më nuk qeshnin si më parë, shoqëria më s'gëzonte e qeshur dhe e lumtur si më parë, ndërsa muzika e këngës sime vajtonte mes një ritmi që më bënte të qaja.

Ish kompromisi im ballë shoqërisë, ndërsa akullimi ndaj gjërave që më rrethonin e që dikur kishin qenë aq të bukura dhe të dashura, përparonte paprerë, duke pushtuar çdo qelizë.

Është e thjeshtë të mendosh për diçka që mund t'i ndodhë ndonjëherë ndokujt pavarësisht nga lidhja a afria që mund të kesh me të, por oh, sa e vështirë është të gjykosësh mbi atë që të ka ndodhur me të vërtetë dhe nuk e shkarkon gjetiu. Rebelimi i një zemre që shtrydhet është më i pashërueshëm se sa një zemër që ka lindur në një çast me vuajtjen. Për çfarë më duheshin sytë e ballit, kur sytë e zemrës i kisha të verbër?!...

Më kot mundohesha të kujtoja që dikur kish pasur kjo botë edhe ditë të bukura e plot gëzime. Ata dukeshin se më ishin groposur thellë në zgafellet dhe s'guxonin të shfaqeshin sërish, të paktën jo me ndritjen e emocionet e para. Gjumi i thellë i atyre kujtimeve kish dremitur edhe ëndrrën më të vogël aq sa sytë e mi ishin veshur me një pluhur harrese që s'lejonte aspak depërtimin e atyre kohërave që më kot, më kot ndonjëherë kisha denjuar t'i quaja të çmuara.

Xhek Shelli dhe shikimi i tij i ndyrë ndanin dy epokat e jetës sime dhe do të shënonin përfundimisht fundin e një jete të vogël dhe fillimin e një jetë të madhe.

Na ndodh, sa herë që jeta e madhe të jetë më e ndyrë, se sa jeta e vogël. E madhja me kërcimet e saj, me mendimet e shkrija habitshëm, na vë nëpër pozicione të rënduara nga fatkeqësitë, ndërsa e vogla, sado e madhe që të jetë, s'arrin kurrë përmasat që dëshirojmë. Ja dhe pse urrejmë sa herë gabimisht veten, kur duhet të gjejmë shtigje për të dalë nga vështirësitë. Por fatkeqësia s'njeh rrugëdalje tjetër veç të të gëlltisë përmes saj, duke të dërguar në duar të panjohura, që s'dinë të të lënë të qetë. Ato janë gjithmonë duar njerëzore, që dinë të shtrihen këndshëm dhe me një bujë të pakufishme. Dinë të të përqafojnë dhe të të shtrëngojnë ngrohtësisht ndërsa së fundmi të shtyjnë drejt një gremine të magjishme ku gjithçka gjendet në errësirë.

Ditët e tjera do visheshin nga dhimbje njëtrajtësisht të ngjashme. Figura e shpifur e Xhek Shellit dhe fytyra ime e zbardhur do të viheshin shpesh përballë. Kjo do ish e vetmja ëndërr, fantazme e se nesërme, që s'do sillte kurrfarë ndryshimi.

Të vetmet çaste harrese do të ishin ca çaste të ngrohta në sallën e teatrit, apo në shtëpinë e mësues Xhakelinit. Ai, me optimizmin e tij, do të thurte një shpresë, që do të më mbështillte, do më mbante butë e ngrohtë, por vetëm për pak kohë ndërsa prapë do sillesha pas në grykën e shpellës magjike, që kish marre formën e shtëpisë sime, aty ku kisha hedhur shtatin. Aty ku kisha mësuar muzikën dhe ku sfondet ngjyrë rozë të lehtë së bashku me të qeshurat aq të çlirëta të nënës sime, me kishin mësuar të isha një fëmijë i gjallë dhe plot bindje të vyer.

Por, kur arrin të lësh pas një bindje që të gënjen, prano më mirë të gënjehesh se sa të gjuhëzohesh.

Kënaqësia dhe hulumtimi janë dy gënjeshtër që bashkëjetojnë për të dhënë kureshtjen e mbajtur gjallë atë.

I erdhi radha natës së madhe të koncertit. Drita inkandeshente shfaqeshin nëpër horizonte. Zërat e njerëzve, fishkëllimat rinore dhe barbarizmat joshëse të zërave që thërrisnin emrin e fituesit të tyre. Dëgjova një turmë të mirëfilltë që po buçiste me emrin tim. Kodington, Kodington, Kodington... Një forcë e brendshme ma ngrinte moralin. Emocionet ishin zhdukur ndërsa kundroja turmën e fansave të mi. Teatri kinez, që ndodhej në qendër të Hollivudit, oshtinte si rrallë ndonjëherë.

Bulevardi Hollivud ish dekoruar me drita shumëngjyrëshe, ndërsa ne të hyrë të teatrit ishin vendosur të gjithë fotografitë e këngëtarëve. Rruga ish e mbushur plot me njerëz, ndërsa trafiku ish i bllokuar në mënyrë që të mos bëhej rrëmujë me makinat e shumta që kalonin andej atë orë.

Unë kisha veshur fustanin ngjyrë rozë, që nëna më kish bërë dhuratë ditë më parë, ndërsa një mikja e saj parukiere Suzan Bertoliera, ish kujdesur për estetikën e paraqitjes sime, Ajo ish marrë me mua gjithë atë pasdite, duke me rregulluar flokët. Ajo pasi kish provuar disa modele flokësh kish vendosur që t'i shtrinte duke bërë një "blow dry" ndërsa me rimele të lehta kish punuar në fytyrën time. Në fund, më vendosi edhe një kordele po ngjyrë rozë, meqë ajo shkonte me shumë me fustanin tim dhe, kur bëri nja pesë hapa pas, mbuloi sytë më duar.

- O Zot! - tha. - Dukesh si një engjëllushe.

Kur kish ardhur mësues Xhakelini ish mahnitur. Dukej që edhe ai ish i lumtur sepse ish i bindur që fitorja do ish e jona...

Qetësia ime dominonte mbi zhurmën e ecejakeve plot emocione të gjithë shoqeve të mia. Ajo ia kalonte edhe zërave të mësuesve, edhe orkestrës madje edhe vokaleve të fundit të korit studentesk që po bënte hapjen e skenës.

Asnjë emocion s'kish mbetur i ngulitur, për të me dhënë sadopak një drithërimë të gjallë. Njëherë të vetme, më erdhi nëpër mendje të pyes veten nëse ime më do te ish e pranishme ashtu siç më kish premtuar një natë më parë.

Mësues Xhakelini kushedi ku kish humbur dhe u bë i pranishëm menjëherë pas këngës së parë. Unë isha e nënta në radhë. Kështu që ai më mori pas vetes gjer në dhomën e pianos duke m'i kënduar me zërin e tij gjysmë të çjerrë për herë të fundit notat e melodisë sime, duke bërë kujdes me shqiptimin e saktë të fjalëve. Dikur u ndal, ndërsa unë çova gjer në fund vargjet e këngës.

- Jam i sigurt që do të marrim çmimin e parë. Ju do jeni me gjithë sigurinë time më e shkëlqyer se sa Alisa Stefany.

Atij i shkëlqenin sytë, gjer në atë pike saqë s'arrinte të dallonte dobësinë që zymtësonte vëzhgimin tim drejt suksesit.

- Ju do fitoni, vogëlushe dhe, pas kësaj nate, s'do të jeni më një vajzë e vogël, por një e famshme e madhe, me emër të ri mes njerëzish, që do ju admirojnë dhe do ju marrin nëpër gojë. Ju do rroni mes zërash që do ju çmojnë për kusurin e jetës suaj të gjatë. Bëhuni e fortë dhe e vendosur. *Carpe diem!* - përsëriti refrenin e tij për këso rastesh.

Ballë tij e mbajta veten. Lotët, që me çdo kusht donin të shpërthenin nga sytë e mi, ranë menjëherë sapo ai më ktheu shpinën. Si nëpër mjegull, arrita të shquaj hijen e tij, që u kthye në të djathtë në fundin e korridorit të gjatë.

Duhej të fitoja me çdo kusht. Ish një ide që përcaktonte suksesin e jetës sime në të ardhmen. Ish një pikë ndriçimi me të cilën do merrte dritë gjithçka që më vonë do më dilte përpara. Kështu thoshte mësues Xhakelini, sa herë që s'ndahej i kënaqur, ose kur shihte moralin tim që kish marrë teposhtën.

U ndjeva e vetmuar, fillikate, e braktisur nga gjithkush dhe si e humbur, pa ndonjë mbështetje. Lotët, arrita të gjeja forcë t'i prapësoja e t'i zhdukja, por lëngimet e thella që qenë bashkuar me

emocionet e skenës ishin të pashmangshme. Pas disa çastesh duhej të dilja para gjithë atij publiku. Duartrokitjet e forta rrëqethnin trupin tim, ndërsa mendja zhubrosej tek përcillte një turmë mallkimesh pa adresë.

Publiku do të çirrej para qenies sime. Çdo përqendrim do thellohej në mua, kur prej meje duhej të dilte shkaku i një kënaqësie për ata njerëz, të cilët po më bënë të vuaja kur më ngjante se vuajtja ime po merrte shkas vetëm nga ajo zhurme. Por vuajtja ime merrte shkas nga gjëra të pakuptueshme. Rrugë të thella dhe të errëta drejtonin ato çaste mendjen time drejt një gremine. Ish një errësi i aq e dendur sa që prozhektorët e skenës as që ndikonin sadopak mbi atë errësi. Ish një qetësi prej vdekjeje që s'ngjallej më asgjë.

Arrita të dalloj mësues Xhakelinin të vinte drejt meje me vrap.

- Ku je? Kam kohë që po të kërkoj, - më tha. - Pas Linda Rrokëllit është rralla juaj. Përqendrohuni dhe binduni se keni për të fituar vogëlushja ime. Mos u ngjyrosni nga pikëpamjet dhe brohoritjet e publikut. Vendosni para syve tuaj vetëm figurën time. Kapelën time të palarë, - dhe, atë çast vendosi dorën tek kapela e tij ngjyrë kafe dhe zuri të qeshte ëmbël si gjithmonë.

Më mori për dore dhe më la në qoshkun e krahut të djathtë të skenës.

- Unë do të dal në krahun tjetër, - më tha. -Dhe ju do ecni përpara sapo unë t'ju bëj me shenjë.

E pashë, kur ma bëri me dorë që nga ana tjetër e skenës. Shikimi im ish i rëndë. Diku tutje si nëpër një humbëtitë dalloja një pjesë të zezë të publikut.

Kënga e Lindës mbaroi, ndërsa duartrokitjet e publikut s'm'u dukën aq të vendosura, pa le më të zgjatura.

Dora e mësues Xhakelinit u ngrit dhe, unë, pasi bëra disa matje të çrregullta, vendosa te vihesha në lëvizje përpara. Prapë dallova lëvizjen e dorës së tij me ritme të përsëritura por s'i dhashë më rëndësi asgjëje. Ula sytë poshtë dhe shkova ashtu gjer pranë mikrofonit.

Orkestra po përgatitej për të nisur këngën time. Partiturat e muzikanteve thyenin qetësinë aq të bindur të atyre çasteve të ftohta ndërsa unë ngrita sytë me mendjen për t'i mbështetur diku në fizionominë e nënës sime.

Përpara ish një mori njerëzish. Kish aq shumë saqë shumë prej tyre rrinin jashtë vendeve nëpër shkallë ose në këmbë.

Arrita të kuptoj rëndësinë e veçantë të asaj nate dhe të gjitha gjërave që shpesh m'i kish bërë të ditura mësues Xhakelini.

Kur orkestra filloi mora një qëndrim gatitu. Më dorën e djathtë preka mikrofonin, ndërsa sytë e mi rrotulloheshin në kërkim të fytyrës së njohur.

Kur zëri im zuri të ushtonte, sapo mbarova vargun e parë, një lume duartrokitjesh u përzier me melodinë e këngës.

Vazhdova këndimin, duke u përqendruar gjithnjë tek kapela e mësues Xhakelinit. Gjithë ai publik kish marrë pamjen e një kapele të madhe. Gjatë refrenit shpërthyen prapë duartrokitje të fuqishme të shoqëruara edhe me thirrje. Suksesi dukej se po më buzëqeshte.

Ish momenti kur do të fillonte strofa tjetër e këngës. Gjatë pushimit tim pas refrenit dhe, kur melodia e orkestrës po udhëhiqte pentagramin drejt pjesës së dytë të këngës, sytë e mi kërkues panë atë që s'duhet ta kishin parë.

Xhek Shelli qeshte dhe e kisha aq pranë, aq pranë saqë kapelja e mësues Xhakelinit mori pamjen e fytyrës së tij. Humba nëpër një tkurrje enigmatike që s'po e kuptonte dot asnjë arsye e imja. Por ja, ku trishtimi i një natë të frikshme dhe tmerri i paanë i një historie të neveritshme bënë që ta urreja atë figurë. Nëna ime ish mbështetur në supin e tij dhe duartrokiste me sytë ngazëllyes, që m'i kish ngulur aq thellë. Qeshja e saj ish aq e ëmbël dhe gazmore saqë s'më lanë asnjë shteg mallkimi në adresë të saj.

Ish një kontrast i neveritshëm që do më jepte humbjen. Zëra të ndryshëm u dëgjuan pastaj klithje të tjera dhe fërshëllima.

Instinktivisht ktheva kokën nga qoshja, ku kish nxjerrë gjysmën e trupit mësues Xhakelini, dora e tij ish ngrirë në pozicionin lëkundje.

E pashë me sytë e mi humbjen. Shikimi im u ngri drejt morisë se njerëzve, ndërsa fërshëllimat u dyndën. Orkestra vazhdonte të mbulonte ecurinë e këngës edhe pse zëri im më s'ekzistonte.

S'arrita t'i mbaja më lotët që ishin më të rëndë se pesha e syve të mi. Shtyva mikrofonin. Mbajta sytë me duar dhe rashë në gjunjë e kërrusur.

Një peshë magjike më shkuli furishëm dhe më ngriti mbi hijet e tyre. Një ekzistencë e papërshkrueshme më shtrëngonte në gjoks, më tërhiqte nga koka dhe me priste këmbët. Çdo gjë humbi në atë çast të shkurtër portretesh të Xhek Shellit dhe të nënës, që i ngjita nga plateja në kokën time. Një bardhësi e dendur më shtyu drejt një vetmie plot zhurmë. Një instrument si një botë rrangallë sillej rreth meje duke përfytyruar qindra fytyrime brenda një sekonde. Zëra të paqartë britnin. Ishin zëra të panjohur, zëra të frikshëm, që qanin dhe qeshnin pa pushim. Dhimbja ish zhdukur. Një shkundje e dytë me hodhi mbi një shtresë të butë dhe zhurma u shua. Bardhësia më mbështolli me krahët e saj të ftohtë dhe më mori me vete.

Korridori ish tepër i gjatë. M'u lodhën sytë gjersa i doli fundi, ndërsa mendja ime ende dinte të këndonte vetëm melodinë e këngës së koncertit. Mësues Xhakelini dhe çdo fytyrë tjetër ishin zhdukur. Bardhësia më kish fshirë nga truri çdo figurë edhe atë të nënës sime, të cilën kur e pashë në kontrast me dritën e diellit m'u duk më shumë si një hije që dikur, shumë kohë më parë, kish ekzistuar.

Para se të ktheja kokën pas, i rashë me sy çuditshëm gjithë botës që kisha përreth. Kombinimi i ngjyrave me tërhuqi dhe pesha e rëndë mbi kokë s'më linte të shihja lart diçka që më tërhiqte lehtë, por vazhdueshëm.

Zërin e saj e njoha. S'më solli në vete, megjithatë për t'i treguar se e njihja e thërrita në emër:

- Li-lu-la, li-lu-la.

Sytë e saj u shtrembëruan. Zuri kokën me duar dhe klithi me sa zë që kishte.

- O Zot, ma ruaj bijën time dhe mos ma çmend.

- E kam parë unë që ti je unë, - me këtë i tregova, se nuk isha e çmendur dhe pastaj i thashë që të mos çmendej ajo. - Guri, mali dhe dielli, kafshët janë zogj të mirë ja pse tremben, - i pëshpërita me gjithë fuqinë e zërit tim, të cilin ajo mezi po e dëgjonte.

Ajo zuri të qante me ngashërime.

- Një grua me të bardha, - ish ajo që pak më parë më tërhiqte vazhdueshëm nga zverku i këmishës ngjyrë rozë, - që më kishin veshur, u mundua ta ndihmonte që ajo të përmbahej.

Unë kuptoja plotësisht bisedën e tyre.



- Zonjë më mirë të çmendem unë se ajo. Dua ta takoj menjëherë doktorin. Natën e kaluar ai më dha shpresë, duke më thënë, që do vinte në vete.

- Doktor tani për tani është i zënë me një pacient, të cilit po i bën ca rrezatime, por ai asnjëherë s'e ka humbur shpresën, në lidhje me shëndetin e vajzës suaj. Ai e theksoi në takimin e mëngjesit, që vajza juaj kishte pësuar një traumë psikike si rezultat i ndonjë asfiksie, që i ka ardhur si rezultat i një emocioni paramendor ose që kish të bënte me ndonjë frikë emocionale, që mund t'i ketë cenuar plazmën e qelizave të kujtesës. Ai ende është plotësisht i bindur që bija juaj do t'i kthehet shërimit.

Ajo m'i nguli sytë e tmerruar. Unë shtriva duart drejt saj dhe e thërrita të më afrohej duke i thënë:

- Ik, ik me vrap se do të zë. Ai ka ardhur me vrap pas teje.

Ajo shikonte rreth e rrotull dhe s'më afrohej. Vetëm mbulonte dhe zbulonte sytë me duar duke qarë me ngashërim.

Infermierja zuri të më ndihmonte, që të kthehesha në krahun e kundërt. Unë doja të përqafoja nënën time. Doja të ikja me të dhe të mos kthehesha më në ato dhomat e bardha dhe të rëndomta. Doja t'i gëzoja e të zbavitesha me ngjyrat e jetës dhe të diellit.

- Ik larg meje, ik sa më larg se s'dua të të shoh më kurrë me këtë, - ia bëra të ditur që e doja pranë dhe doja të ikja me të përgjithmonë.

Ajo s'më kuptonte. Më shikonte me sytë e dërmuar ndërsa duart e mia ngelën të kthyera pas gjer sa m'u zhduk nga sytë.

- Unë s'dua ta shoh më sy, - iu kërcënova infermieres, - duke i bërë të ditur që e doja shumë nënën time.

Ajo më shikonte rreptë dhe shtynte karrocën nga pas.

- S'dua ta shoh më me sy. Ju s'e dini që ajo s'është, - iu kërcënova me duar. - Ju dini, ju jeni e mirë, - u ngrita me forcë dhe e mbërtheva në gjoks. Ajo klithi. Dy infermieret e tjera lanë një plak të rrezohej dhe u nisën drejt nesh duke vrapuar.

- Lidheni shpejt këtë vogëlushe ia bëri ajo që po më shtynte. Dhe bëjini një qetësues të gradës së tretë.

Njëra, më e shëndosha, mezi m'i shkëputi duart nga gjoksi i tjetrës, e treta më lidhi në krahët e hekurt të karrocës jeshile, ndërsa diçka më shpoi në krah duke më vënë në qetësi të plotë.

Një errësirë e lehtë më bëri ta humbisja veten.

Kohë më pas erdhën të më vizitonin të tjerë njerëz, ndër ata mësuese Beatris Kotbell, e cila më mbante pranë në shkollë si një bijë të saj, ca kushërinj të nënës, të cilët jetonin në Orenj Kaunti dhe disa shoqe dhe shokë të tjerë të shoqëruar nga prindërit e tyre.

Të gjithë ndaheshin nga unë, duke kafshuar buzët, duke i rënë kokës me duar ose me sy të përлотur.

Nga ana ime, unë komunikoj me të gjithë në mënyrën më normale, por askush s'arrinte të më kuptonte. As me mësues Xhakelinin me të cilin kuptohesha gjithmonë s'arrita t'i bëja të ditur shumë gjëra. Ai në mënyrën më të përkryer, me butësinë e tij dhe me shikimin e ngrohtë keqardhës arriti të më thoshte së fundmi, se Zoti do të më ndihmonte. Dhe se unë njëlloj, një tjetër kohë, do të bëhesha e famshme e merituar. Unë e përgëzova nga ana ime duke i thënë:

- Nuk dua t'ia di për asgjë!

Dallova në sytë e tij diçka të tmerrshme e trishtuese dhe, kur u nda nga unë, duke qarë m'u krijua një bindje e zezë që s'do ta shihja më kurrën e kurrës.

Jeta brenda mureve të spitalit ish skëterrë. Gjithnjë e më shumë mësohesha me fytyra të rrënuara e të vrara nga dhimbjet kronike dhe me gojë, të cilat, kur ish për të qeshur, preferonin më shumë të shtrembëroheshin.

Njerëz të ndryshëm, që vinin të më vizitonin shpeshherë preferonin të më shihnin vetëm nga larg në mënyrë që të mos besonin gjendjen e keqe timen dhe kështu t'ia zbonin lëngimin vetvetes. Dhimbjet e atyre që më vizitonin dhe keqardhja ishte bërë si një sëmundje me plagë që nuk shëroheshin. Të gjithë qanin burra, gra dhe fëmijë.

Kur ata qanin, unë qeshja, dhe kjo i lëndonte dhe i bënte më shumë të qanin. Askush s'e kuptonte që unë qeshja për t'ju bërë atyre të ditur që ata të qeshnin, për t'ju treguar se unë mund të qeshja dhe për t'i dhënë kuptim më njerëzor keqardhjes dhe dhimbjes së gjithkujt

Ditët ishin të gjata, kurrë s'kisha uri. Dhe, kur më sillnin të haja, lija mënjanojë gjithçka dhe largohesha duke klithur:

- Dua të ha gjer sa të pëlças, - u bërtisja.

Kish kaluar s'di sa kohë, kur më në fund, pashë fytyrën e mirë të Xhek Shellit. Ai ish ulur në një stol të drunjtë jashtë në lulishten e spitalit.

Me ta parë iu kërcënova infermieres.

- Ai është njeriu më i mirë që kam parë në këtë botë. Dua të shkoj dhe ta shoh. Është njeriu më i pastër, - dhe bëra ta shtyj që të më kthente pas për në dhomën time.

Ajo vazhdonte të më shtynte.

- Sigurisht që është i mirë, - më tha, - është babai juaj.

- Ai është i bukur, - i thashë. - Ai është gjithçka për mua. - Me këtë doja t'i bëja të ditur se për mua ai s'ish asgjë.

Kur u gjenda pranë tij Xhek Shell gjeti forcën naive e shtirëse të më përqafonte, të më përkëdhelte dhe të më tregonte një dhuratë të mbështjellë me një letër të kuqe.

- E dua dhuratën, - iu drejtova me fytyrën e qeshur, - dhe tërhoqa duart që të mos e merrja.

- Për ty e kam sjellë, - ai u mundua të qeshte.

Ish i vetëm. Tha se nëna ime do të vinte të më vizitonte në darkë. Ndër të tjera u justifikua duke u shfajësuar për kohën e shkuar, që kish munguar në vizita, duke thënë se kish qenë në lundrim.

Diçka të zezë dhe të gënjeshtërt me prezantonte portretin e tij. S'e di, se sa e urreva dhe se ç'doja të bëja me të.

- Jeni shumë i mirë, - iu shtrembërova. - duke e bindur se ish një i poshtër. - Jeni, s'jeni, ju jeni me brirë, - i thashë, - me flatra si kafshët dhe hunde të bukur si shpendi. Ju jeni si mali i ftohtë dhe si mortaja e qytetit. Ju jeni si ujku që ha dhe dhelpra, që fshihet. Ju jeni peshkaqen, derr dhe qen. Ju jeni ujk i vërtetë, që ha dhe helmon. Ju jeni gjarpër i mirë dhe i drejtë. Ju jeni shpend i një deti të murrmë dhe të ndyrë. Ju jeni mikpritës dhe mikprishës. Për këtë ju dua pa masë, - S'kisha si të mos i thosha, se e urreja gjer në fund. - Unë do t'ju dua gjer në fund të botës dhe të jetës. Unë s'dua të ngjallej në këtë vend të kristaltë, Unë dua diell, Unë dua dritë dhe hapësirë, që të mposht ndyrësinë tuaj.

Ai kafshoi buzët me dhëmbë.

- Mos u qeshni, - ia thashë hapur. - Ju e dini që jeni i pastër si nata.

Ai hidhte sytë vjedhurazi nga infermierja, e cila na shikonte tek flisnim dhe qeshte.

- Ju lutem, kujdesuni për të! - i tha Xhek Shelli.

- Ne gjithnjë me gjithkë bëjmë detyrën tonë për së miri, - e mori përgjigjen nga ajo.

E pashë tek u tërhoq si një i humbur. Ish një betejë e hapur që unë ia bëra me qëllim, që ai të kuptonte se unë s'isha një fëmijë i çmendur, apo se kisha harruar. Ai duhet të dinte, se lufta ime kundër tij do të ish e gjallë, aq e gjallë sa vetë vdekja.

Ai më dha në dorë plaçkën që ma kish sjellë për dhuratë dhe u ngrit në këmbë.

Unë me të dy duart e mora dhe e përplasa për tokë. Një krismë e thatë kristali theu heshtjen tek u bë copë edhe vetë.

- Unë e dua dhuratën tuaj, - i bëra të ditur që asgjë e tija s'më interesante më.

- Sot s'ka qenë shumë e rehatshme, - i shpjegoi infermierja me një ton të çiltër në mënyrë që të mos e shqetësonte.

- E shoh që s'është në rregull, - këtë Xhek Shell,ia tha ndër hundë. Ai mund të ishte i vetmi njeri që më kuptonte dhe e dinte sëmundjen time.

- Ju jeni tepër i pastër dhe hipokrit, - i thashë. - Ju jeni babai im i vërtetë, - doja që infermierja ta dinte që ai s'ish im at dhe asgjë imi.

- Vizita mbaroj, duhet ta kthej, për të nxjerrë pacientin tjetër, - i tha infermierja Xhek Shellit, duke më tërhequr lehtë dhe duke më rrotulluar për nga hyrja.

- Dua t'ju shoh prapë ndyrësirë. Dua t'ju shoh praaaaaaaaapë ndyrësiiiiiiiiiiiiiirë, - këlthita enkas, që të mos ia shihja më fytyrën dhe pështyva mbi dhuratën e qelqtë që ish shpërndarë mbi tokë rreth e rreth stolit të lulishtes, ku po rrinim.

E pashë tek u zverdh i tëri edhe pse zuri të qeshte.

- Mbajeni me kujdes qenka në gjendje shumë të rëndë, - i tha infermieres dhe na shoqëroi gjer në shtrembërimin e plotë të syve.

Një dorë e butë dhe e ftohtë, më sollli në jetë. Fytyrat e tyre ishin të çuditshme, sytë e ënjtur me shikime të vrara. Ish dora e Lizbethit që tërhiqej frikshëm nga balli im, duke më lejuar të shquaja drejtpërdrejt frikën e gjithkujt.

I pashë si nëpër mjegull fytyrat e tyre që morën ngjyra jete para syve të mi. Ime më tek fshinte lotët, m'u vërsul duke më puthur si e çmendur.

- Vogëlushja ime, ç'ndodhi, ç'ndodhi?

Mësues Xhakelini dridhej nga mosbesimi ndërsa Lizbeth s'arrinte të fshinte lotët që i rridhnin rrëke.

Pak më përtej kish njerëz të tjerë, ca të veshur me të bardha dhe të tjerë veshur ende me kostumet e zeza të koncertit.

Zërat e shoqeve të mia përtej formonin melodinë e një kori funebër, ndërsa doktori iu lut të gjithëve të më linin të qetë.

I vetmi që ish zhdukur nga ajo skenë ish Xhek Shelli. Ai, me sa dukej, kish nuhatur subjektin e shuarjes sime dhe ish larguar, për të mos qenë i pranishëm në skandalin që mund të vinte më tej.

- Ishit aq e bukur atë natë, - më tha Lizbethi, kur unë shtriva dorën të fshij lotët e saj. E kish fjalën për natën e koncertit.

- Ajo s'ka qenë mirë gjithë këto kohët e fundit, - dëgjova zërin e mësues Xhakelinit, që iu drejtua Lizbethit. - vazhdimisht fshihej pas ca emocioneve të trishtuara, që unë gjithnjë i shumëzoja me mungesën tuaj.

- Mbase është faji im, - ndërhyri nëna. - Mbase nuk duhej të largohesha prej saj në këto ditë kaq të rëndësishme.

Lizbeth vazhdonte të kujdesej për mua, duke më dhënë ca kos prej luleshtrydheje, që vetë doktori ma kish rekomanduar.

Arrija t'i shihja të gjithë, por s'arrija të flisja asgjë. Njerëzit e pranishëm më silleshin vërdallë si të ulur mbi një kupole, ndërsa

figura e Xhek Shellit kish ende formën e rrumbullaket të kapelës së mësues Xhakelinit.

Një peshë e rëndë sikur më shkelte mbi kokë dhe s'arrija të ngrihesha.

Zëri i doktorit erdhi i ashpër dhe i vendosur:

- Ju lutem, të gjithë duhet ta lini dhomën, vetëm një njeri mund të qëndrojë që t'i shërbejë, një njeri i afërt, ajo ka nevojë për qetësi.

- Si do shkojë shëndeti i saj, - zëri i nënës ish i plogësht.

- Duhet të marrim përgjigjen e analizave që ia bëmë urgjentisht. Ka të ngjarë të ketë pësuar një sklerozë të lehtë, e cila mendohet të ketë ardhur si pasojë e ca emocioneve të fuqishme, ose të një traume mendore që ka pësuar, diçkaje që i është përfytyruar papritmas dhe truri i saj s'ka qenë i përgatitur ta përballojë, si një goditje e befte. Janë raste që shfaqen shumë rrallë tek fëmijë e kësaj moshe.

- Por ka shërim ama? - nëna e shqetësuar po kërkonte të dinte diçka më shumë.

Doktori iu afrua edhe më pranë nënës, në mënyrë që të mos e dëgjonin të tjerët.

- Këtë duhet t'ia lëmë kohës, zonjë. - Nëna çakërdisi sytë me mosbesim. - S'duket edhe aq e rëndë në reaksionet e para. Faleminderit Zotit, ajo s'i ka prekur qelizat nervore të gjymtyrëve, dhe kështu i ka shpëtuar për bukuri ndonjë paralizë të pjesshme, - e qetësoi doktori.

- Domethënë...? - nëna e zuri për krahu.

- Domethënë është jashtë rreziqeve me pasoja të mëdha ose që kanë të bëjnë me humbjen e jetës. - Doktori hodhi sytë rreth e rrotull dhe pa që dhoma ndërkohë ish boshatisur. Më vuri dorën në ballë dhe e hoqi atë pas disa sekondash.

- Dhe si mund të kurohet kjo sëmundje, doktor? - nëna po insistonte e preokupuar.

- Për kurimin e saj te plotë mund të dimë vetëm pas analizave. - përsëriti doktori pasi i la në dorë infermieres shiringën.

- Ju lutem doktor, bëni të pamundurën. Është vajza ime e vetme.

- Shpresojmë të shkojë mbarë shërimi i saj. - Doktori fërkoj shuplakat me një krem të verdhë që e hodhi nga një shishe e vogël dhe me to zuri të bënte masazh mbi ballin tim.

Puthje të njëpasnjëshme ndieja tek më lehtësonin. Përshëndetjet e gjithkujt ishin të ngrohta.

Mësues Xhakelini, shoqet e mia dhe, së fundi, ime më.

Një qetësi e thellë u krijua përreth meje, ndërsa zëri i qetë i Lizbethit kërkonte të më vinte në gjumë.

- Fli vogëlushe, ke nevojë të pushosh.

Ditët e mia do rëndoheshin nga marramendje të njëpasnjëshme.

Lizbeth do më shërbente gjithnjë me shpresë, për të më parë një ditë të ngritur në këmbë. Gjendja ime sipas doktorit po keqësohej, meqë pjesa e trurit e dëmtuar nga trauma s'arrinte të reagoje me gjithë mjekimet e përditshme. S'kisha uri ndërsa i vetmi ushqim i imi ishin serumet e njëpasnjëshme.

Nëna më vizitonte përditë, për të më tregonte Lizbeth kur zgjohesha nga gjumi. Gjumi im ish i gjatë, pak orë në ditë rrija zgjuar dhe, me vështirësi, hulumtoja fjalët e radha të Lizbethit.

Kur për një çast, ajo më përmendi emrin e Xhek Shellit u drodha e tëra dhe ndjesia më humbi. Lizbeth klithi me një zë të ashpër e alarmant dhe, menjëherë, i ra sinjalit të infermieres, e cila sakaq do më bënte dy gjilpëra njëra pas tjetrës. Ato do më vinin në gjumë për njëzet e katër orë radhazi.

Kur do ngrihesha do ndihesha më mirë se asnjëherë tjetër, do arrija të kuptoja mirë gjetet dhe fjalët e Lizbethit dhe do të arrija t'i shqiptoja të rregullta fjalët e mia të para.

- Jeni e mrekullueshme!

Lizbeth e lumturuar do më mbushte me të puthura. Ajo do thërriste doktorin e turnit dhe do i tregonte, pa u mbushur me frymë, për reagimin tim të suksesshëm.

- Doktor, ajo sapo foli. Foli me zërin e saj, doktor, foli me të vërtetë.

- Kjo është shenjë pozitive, - tha doktori tek më prekte në tëmtha, - çka do të thotë që pjesa e trurit të paralizuar ka filluar të reagojë.

- Domethënë do të shërohet.

- Duhet të presim edhe ca kohë për ta ditur të vërtetën. Megjithatë nesër do të jemi në komision me dy mjeke të tjerë të universitetit të San Franciskos doktorin Berkamp dhe profesor doktorin Gabana, me të cilët do të nënshkruajmë kurën e saj përfundimtare. Është një kurë e re e eksperimentuar dhe që ka dhënë rezultate të larta tek shumë paciente adulte. Meqenëse kjo është fëmijë, duhet të shohim, se si do të reagojë, duke zvogëluar dozat. Kemi shpresë të madhe.

Doktori zuri të më përkiste në pjesën e pasme të qafës duke më shtrënguar paksa me dy gishta.

- Keni dhimbje? - zëri i tij më erdhi si lëngues.

- Po, - s'e di nëse më dëgjuan tek e thashë atë pohim që unë vetë s'arrita ta dëgjoja.

- Reagimi i saj është pozitiv.

Doktori u largua ndërsa Lizbeth, si një fëmijë i lumtur, po hidhej nëpër dhomë nga gëzimi. Ajo fërkonte shuplakat.

- Dëgjuat, vogëlushe? Dëgjuat, Margaret? Do të shëroheni dhe përsëri do jeni më e bukura dhe më e lumtura.

U ndjeva e lodhur ato çaste ndaj dhe s'arrita të dëgjoj gjer në fund fjalët e saj plot emocion.

Doktori i dorëzoi nënës dosjen e diagnozës dhe listën e mjekimeve të mia.

- Duhet të keni kujdes, ajo ka nevojë për qetësi dhe mjekimet t'i jepen në kohë, - kjo ish porosia e fundit e doktorit.

Aty ishin të pranishëm mësues Xhakelini, nëna, Lizbeth dhe i ndyri Xhek Shell.

Mbylla sytë sepse s'e përballova dot figurën e tij. Prita të shuhesha edhe njëherë, mbylla sytë dhe u përgatita për goditjen fatale. Asgjë s'arriti të ndodhte nga ato që imagjinata arriti të më sillte si dhuratë. E mbajta veten, hapa sytë dhe ndoqa me shikim lëvizjet e çdonjërit.

Infermierja dhe Lizbeth me ndihmuan të ulesha në karrocën e hekurt. Nëna më fshinte djersët në ballë.

Bënte ngrohtë. Jashtë ish kohë vere dhe avujt e bregdetit gufonin me një afsh lagështie. S'e di se sa kohë kishin kaluar, sa kohë kisha jetuar e mbyllur dhe e veçuar nga jeta e lirë.

Më ngjante sikur të gjithë kishin ndryshuar. Aktualiteti i të gjithëve më ish trajtësuar si një fantazmë më vete; nëna ish shëndoshur dhe plakur ndërsa barku i fryrë i kish ardhur gjer tek hunda, Lizbeth ish dobësuar, mësues Xhakelinit i kishin hyrë sytë thellë në kockat e tyre duke i dhënë pamjen e një kufome të vërtetë.

I vetmi që s'kish pësuar asnjë ndryshim ish Xhek Shelli, i cili ruante gjithë ashpërsinë e tipareve të tij, intuitën e tij të prerë, pamjen prej xhelati, shikimin prej djalli, me të qeshurën e tij të bastarduar.



Ishte e vetmja fantazmë e gjallë që jetonte akoma me ritmin e tij moskokëçarës. Dukej që ish i vetmi njeri që s'e kish vuajtur sëmundjen time.

Të gjithë së bashku më përcollën gjer në shtëpi. Mësues Xhakelini dhe Lizbeth erdhën në ambulancë me mua.

Shtëpia s'kish ndryshuar nga pamja e zakonit. U trishtova ngaqë për herë të parë ndjeva që nuk më pëlqente më ajo shtëpi. Dhoma ime sikur kish marrë përmasat e një varri. Xhek Shelli rrinte në këmbë në të hyrë të dhomës dhe priste reagimin e nënës, e cila po më ndihmonte të shtrihesha në krevatin tim.

- Duhet të përshëndetesh me Lizbethin, - më tha nëna lehtë në anën e veshit të djathtë.

- Përse duhet të përshëndetem? - ia ktheva me ndrojtje, duke shikur figurën e tmerrshme të Xhek Shellit.

- Ajo duhet të shkojë. Kështu e kemi vendosur. Për ty do të kujdesem unë.

Një shkujdesje reagimesh na i mbushi sytë me lot. Duart e ftohta të Lizbethit me përkëdhelën dhe as ajo as unë s'arritëm të nxjerrim fjetet e zërit tek u përshëndetëm.

Lizbeth s'arrinte të kuptonte arsyen e tanishme të këmbënguljes së largimit, ndërsa unë s'arrija të gjeja forcë, që të hiqja nga shpirti mallkimin tim ndaj Xhek Shellit. Qetësia ime ish e rëndë. Rebelimi ndaj asaj figure ish i ashpër, hapësira drejt dhimbjes ish e qartë. Urrejtja ime ndaj tij ish e hapur, e dukshme.

Mësues Xhakelini mori leje dhe u largua duke më puthur në ballë.

Kështu, atë natë, për të parën herë nuk fjeta, duke përjetuar mes dritëhijeve disa herë, sensacionin e rrëzimit nga krevati.

Momentet e mia të dobëta, gjenin friken sa herë që Xhek Shelli sillej pranë meje qoftë edhe në prezencën e nënës. Figura e tij e djallosur më kallte datën. Nëna, ditën e kthimit, më kish premtuar për kujdesin e saj. Premtimi i saj do të zgjaste vetëm një kohë të përcaktuar, pastaj, prezenca ime si e sëmure do të bëhej si një lojë e përditshme, diçka e zakonshme në jetën tonë të përditshme, si një dhimbje normale dhe e përhershme, si një sens me të cilin duhet të jetosh si me çdo aspekt tjetër të një jete të zakonshme. Shpejt të dy

u pajtuan me normalitetin e gjendjes sime. “Një e sëmurë kronike, e cila duhet ta gjeje shërimin tek shpresat e një dore të shenjtë...”

Sido të ishte unë arrija të kuptoja jetën e nënës sime. Ajo ish shtatzënë me motërzënë time, ky ishte një shkak real të cilin arrija ta kuptoja. Dhe ndjehesha e keqardhur për nënën. Nga ana tjetër, Xhek Shelli e shtynte çdo ditë të dilte në punë. Unë dëgjoja diskutimet e tyre çdo darkë, në praninë time. Ata flisnin hapur, duke menduar, që unë isha një gjysmë e çmendur dhe s’arrija t’i kuptoja.

Unë dalloja që ime më ish e dashuruar marrëzisht pas tij dhe se ajo, nga ajo dashuri që ruante për të, do ish në gjendje edhe të më braktiste, po t’i thoshte Xhek Shelli.

Ajo do të largohej për orë të tëra dhe herë-herë do ndjehesha e lumtur me vetminë time, por nga ana tjetër, do isha e tmerruar nga prezenca e Xhek Shellit. Gjithnjë prania e tij do më ndrydhte në vete dhe s’do të arrija të nxirrja fijen e zërit.

Fillimisht e pata të vështirë, por më vonë arrita të luaja pjesën e të çmendurës.

Arrita t’i neveritem me gjestet e mia prej të çmendure. Kur ai më shikonte me ngulm dhe mendohej të më buzëqeshte unë i nxjerrja jashtë gjuhën, shtrembëroja sytë, shkulja flokët, belbëzoja duke pështyrë përballë tij, klithja duke folur përçart, improvizoja sipas “çmendurisë sime” skenën e tmerrshme, duke mërmëritur fjalë e fraza të shkëputura të ngarkuara me plot aludime për atë që kishte ndodhur, natyrisht duke ia zënë në gojë edhe emrin e tij të veshur enkas me një tmerr prej meje, gjersa ai largohej duke psherëtitur. Ndërsa kur përballëj me nënën në sallën e ngrënies, i thosh:

- Ajo është çmendur fare.

Të kundërtën beja kur nëna ishte e pranishme. Sillesha mirë, flisja qetë dhe qartë, qeshja kur ish për të qeshur dhe e mbushja kësisoj me shpresën e rehabilitimit tim të shpejtë.

Kështu besimi i Xhek Shellit binte në kundërshtim me atë të nënës. Kësisoj unë iu jepja një monedhë, sit ë thuash, që sekush e shihte nga ana e tij.

Nëna ishte e bindur që unë shkoja drejt përmirësimit, ndërsa Xhek Shelli besonte që unë shkoja drejt çmendjes.

Mësues Xhakelini po vdiste. Lajmi erdhi nga nëna ime, e cila më zgjoi me ngutje. Më solli rrobat për t'u ndërruar dhe, sapo ajo zbriti poshtë dhe u kthye, unë isha veshur. Arriti të qeshte kur më pa të veshur dhe besoi edhe njëherë që unë isha në rregull.

- Mësues Xhakelini është në gradë të fundit, ai do të të shohë, ka kërkuar të vijë këtu për të të vizituar.

Ish hera e parë që dilja jashtë dhe zbrisja shkallët e shtëpisë pa ndihmën e askujt.

Xhek Shelli sapo erdhi me makinë dhe s'u besonte syve tek më shihte. As që e mora mundimin ta përshëndesja vetëm se, nxora gjuhën, duke shikuar pjerrtas fytyrën e tij që shprehte habi.

Rrugës besova që jeta gjithandej gumëzhinte edhe pa praninë time. Ndjeva që kisha humbur shumë, shumë, nga e gjithë jeta, sido të ishte s'doja të besoja që mësues Xhakelini po merrte fund. Doja akoma të ktheheshin ditët e kaluara; të ndieja ngrohtësinë e fjalëve të tij me aq vlerë; të këndoja dhe të jetoja me krenarinë e fitores.

Kur arritëm tek shtëpia e mësues Xhakelinit, dy zëra të ngjashëm femrash kishin vënë kujën, njëra ish e shoqja e tij, Alisa, ndërsa tjetra ish e bija e tij Klaudia.

Mësues Xhakelini kish vdekur.

Kur nëna mësoi të vërtetën u mundua të më tërhiqte në mënyrë që të mos hyja brenda që ta shihja. S'e di se si gjeta forcë ta shtyja dhe ta shmangia. Doja ta shihja për të fundit herë njeriun më të mrekullueshëm të botës, meqë si ai kurrë më, asnjëherë në jetë, s'do arrija të njihja.

Mësues Xhakelini kish kryqëzuara duart dhe flinte. Sytë e tij të mavijosur ishin shteruar. U ula në gjunjë pranë tij, putha duart e akullta dhe qava me ngashërim, për një kohë të gjatë.

Kur pashë përreth isha e vetme, unë dhe mësues Xhakelini. S'arrija të kuptoja nëse ai ndiente dhimbjen time. Ai vazhdonte të flinte i qetë në ftohtësinë e tij. Ende s'e kish humbur sensin e durimit, natyra e tij e qetë ende ekzistonte.

Ai kish qenë fenomeni i triumfeve, kish qenë forca ime, mësuesi im i parë dhe i fundit. Ai që më kish mësuar muzikën dhe kuptimin e të jetuarit.

Dhimbja ish e pafund, lotët të pashtershëm.

Qëndrova pranë tij gjer në çastet e fundit. Kur e përcollën dhe kur u zhduk e kuptova se ai kish shkuar për në qetësinë e përjetshme, kishte shkuar në amshim.